Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 10 (162) / 2019. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË.

Bigmarket
DI ÇFARË ZGJEDH!
NË PESHKOPI
Çdo muaj me
SUPER OFERTA

DËSHMI

Si më vodhi Radio Tirana kangën "Bulqizakeja"


Nga **MUNIR SHEHU**



BOTIME

Vlerat dhe veçoritë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare

Nga **BERNARD ZOTAJ**



PROFIL

Talentet që "shpëtuan" nga riatdhesimi familjen Tonuzi

Nga **OSMAN XHILI**



EKSKLUZIVE

RRUGËS SË RE TË ARBRIT

Në gjurmët arbërore

Nga **BINAK ULAJ**



Lugina e lumit të Tiranës, të cilës i bën roje Dajti kryelartë, na ofronte pamje të mrekullueshme. Trajtat e shkëmbinjve laroshë dhe të gurëve, të krijuara me shekuj, kombinimi i shumë elementeve të ndryshme që përbënin një tërësi harmonike, dukeshin si t'i kishte formësuar dora e skulptorit.

Fatbardhësisht perla të tilla natyrore ka shumë gjithandej Atdheut tonë, ndaj edhe rrugëtimin tonë e konsideronim si një ftesë qytetarëve, veçmas të rinjve, për t'i vizituar e shijuar ato, për të jetuar me natyrën e virgjër dhe të pastër. Për fat të keq, bukuritë e të mirat që sjell natyra, shumica e të rinjve tanë nuk përpiqen t'i shijojnë fare apo, thënë ndryshe, mjerisht, "i shijojnë" në Facebook.

Këto dy ura sikur shënonin dy epoka, atë të kaluarën dhe epokën e re të sotme. Vendi dhe konstruksioni i urës së re që lidhte dy anët shkëmbore të luginës së Matit, na mrekullojnë, ndaj nuk mund ta përballonim kureshtjen për ta parë nga afër dhe kaluar nëpër të.

REFLEKSIONE PAS NJË EKSPOZITE

Si e humbëm Lurën



Nga **MARSEL LELA / politiko.al**

— Faqe 5

NË BRENDËSI:

■ "Qytetar Nderi i Dibrës" sipas shijes partiake ■ Molla "Diamant i Zi" nxjerr frutat e para në Dibër ■ Rinia, hapa përpara për ruajtjen e traditave ■ Një natë poetike në Dibër të Madhe ■ Skënder Cala, "Mjeshtër i Madh",në gjerdanin e artë të kulturës kombëtare ■ Dibrani që desh të blinte një kuintal me gjilpëra! ■ "Zonja asnjeri dhe zoti askurrkush" shpreh pamundësinë për të asimiluar përvojat tona ■ Poezia e Barie Çupit në vëllimin poetik "Vargonjtë e fatit" ■ "Kushëriri i ëngjëjve" ■ Naim Berisha, profil i një krijuesi të veçantë… ■ Gjurmë të mençurisë ■ ■ Origjina dhe gjeneza e fisit Murrja, në Luzni, të DibrësFestFolk Klosi 2019, veprimtari e rëndësishme e trashëgimisë shpirtërore ■ Nazif Bodini, mësuesi dhe veprimtari i kulturës së brezave ■ Dr. Filip Cfarku, themelues i reanimacionit pediatrik bashkëkohor në Spitalin Rajonal të Dibrës ■ Përkujtohet 76 vjetori i rënies së dëshmorit Ahmet Cami

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 10 (162). Tetor 2019
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit Nëntor 2019.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Binak ULAJ
Osman XHILI
Xhafer MARTINI
Arif MURRJA
Bernard ZOTAJ
Mevlud BUCI
Hamdi HYSUKA
Zabit LLESHI
Ramazan BUCI
Dukagjin HATA
Gezim VODA
Sakip CAMI
Halil TEODORI
Marsel LELA

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin
069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Rrugës së re të

Nga **BINAK ULAJ**



Fotesës së mikut dhe shokut tim, Dori Bulkut, për të bërë një rrugëtim në këmbë nga Tirana deri në Peshkopi, Rrugës së Arbrit, 75 km të gjatë, së bashku me të dhe shokët e tij, e kisha pritur me kënaqësi të veçantë. Doja të ndaja gëzimin tim me ta për ndërtimin e kësaj rruge, e cila e lidhë vendlindjen e tyre, Peshkopinë, me kryeqytetin , Tiranën, por edhe me Iliridën. Dhe s’ kishte si të mos u bashkohem sepse, shumë, tepër shumë, i kemi përjetuar ndarazi gëzimet dhe pikëllimet tona. Përveç kësaj, hapësirat gjeografike të atdheut tonë kurdoherë i kam ndier e vlerësuar si hapësira shpirtërore.

Do të ecja andej nga kishin udhëtuar paraardhësit tanë, arbërorët, do të shihja nga afër shumë vise e vendbanime të Qarkut të Tiranës dhe të krahinës së Dibrës heroike, vende këto të njërit krah të Atdheut tonë - dashurisë sonë të ndaluar për më se një shekull, të cilin jo vetëm që s’guxonim ta donim haptazi por, për më tepër, çdo manifestim publik i atdhedashurisë ndodhte të paguhej edhe me jetë. Këtë fakt, për fat të keq, sikur e kemi harruar fare, ndaj nuk po i shfrytëzojmë mundësitë e shumta që na janë krijuar falë sakrificave të brezave e brezave, për t’u njohur, bashkuar e vepruar si pjesëtarë të një kombi dhe të atdheut të përbashkët. Për këtë arsye, si punonjës shumëvjeçar i arsimit, më brengos fakti i mos angazhimit të të rinjve në këtë drejtim. Përveç kësaj, unë dhe bashkudhëtarët këtë udhëtim e vlerësonim dhe e vlerësojmë si shpërfaqje të gëzimit tonë për ndërtimin e kësaj arterieje të rëndësishme rrugore, e cila duke e lehtësuar e shkurtuar komunikacionin, i afron njerëzit, bënë të njihen e duhen më shumë, i bashkon viset e Atdheut tonë ende të ndarë me kufij, ndarje kjo nga e cila ka pësuar më së shumti populli ynë e, njëkohësisht, edhe si shpërfaqje të mirënjohjes sonë individuale e grupore ndaj Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për ndërtimin e saj. E theksojmë këtë për arsye se ne, si popull, duke parë kryesisht veprimet joracionale të institucioneve tona shtetërore, si të Tiranës ashtu edhe të Prishtinës, nganjëherë s’ duam t’i shohim edhe sukseset.


> Lugina e lumit të Tiranës, të cilës i bën roje Dajti kryelartë, na ofronte pamje të mrekullueshme. Trajtat e shkëmbinjve laroshë dhe të gurëve, të krijuara me shekuj, kombinimi i shumë elementeve të ndryshme që përbënin një tërësi harmonike, dukeshin si t’i kishte formësuar dora e skulptorit.



Ditën e premte, më datë 11 tetor, pasi i ngarkojmë gjërat e nevojshme në “Landroverin’’ e Dori Bulkut, babai i tij, Bimi, Dori Cani, Nerti Jova, Dori Bulku, Belin Zeneli dhe unë, nisem drejt pikënisjes së paraparë, drejt fshatit skajor të Tiranës, fshatit Ferraj. Bukurinë e Tiranës na e zbehte ca periferia e saj, por kthjellimi i qiellit na shtonte shpresën për ditë të mbarë e me diell. Në orën 7:30 arrijmë në vendin e caktuar prej ku do të fillonim udhëtimin në këmbë. Aty na priste ekipi i “TV Klanit’’, gazetarja fytyrëqeshur dhe zëëmbël, Brunilda Cami dhe kameramani, Klodian Keqi. Ata do t’na përcjellin me makinën e tyre deri në Qafë të Murrizit. Prania e tyre s’kishte si të mos na e shtojë vullnetin për misionin që kishim marrë.

Lugina e lumit të Tiranës, të cilës i bën roje Dajti kryelartë, na ofronte pamje të mrekullueshme. Trajtat e shkëmbinjve laroshë dhe të gurëve, të krijuara me shekuj, kombinimi i shumë elementeve të ndryshme që përbënin një tërësi harmonike, dukeshin si t’i kishte formësuar dora e skulptorit. Por, ajo që më bënte përshtypje të veçantë, ishte interesimi i bashkudhëtarëve për Kosovën, për arsimin shqip gjatë okupimit klasik të Kosovës e, veçmas, për Luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Si më të rinj që ishin, kisha kënaqësinë t’u flisja për atë periudhë të lavdishme, t’u tregoja se kisha pasur fatin dhe nderin t’i njihja disa prej atyre vajzave e djemve që ishin nga të gjitha viset e Atdheut tonë, të cilët shkonin në luftë pa ua vënë veshin atyre që propagandonin se nuk mund të luftohej kundër pushtuesve serbë e malazez, që propagandonin se vetëm për disa orë ushtria serbe e malaziase mund ta bënin shkrumb gjithë Kosovën, por trimat e trimëreshat, të vendosur t’i dilnin zot Atdheut, përgjigjeshin se askush nuk mund t’i ndalonte të vdisnin për Kosovën, t’u tregoja se nuk e kisha lehtë të ndahesha me ndonjërin prej nxënësve të gjimnazit “Xhevdet Doda” kur më njoftonte se po shkonte t’u bashkohej luftëtarëve të lirisë, t’u flisja për nxënësit të cilët, duke rrezikuar edhe jetën, shkonin në zonat e luftës, veçmas në Drenicë, për të parë gjendjen reale dhe përgatitur artikuj për të vërtetën e luftës çlirimtare, që i botonin pastaj në

Arbrit, në gjurmët arbërore



Fatbardhësisht perla të tilla natyrore ka shumë gjithandej Atdheut tonë, ndaj edhe rrugëtimin tonë e konsideronim si një ftesë qytetarëve, veçmas të rinjve, për t'i vizituar e shijuar ato, për të jetuar me natyrën e virgjër dhe të pastër. Për fat të keq, bukuritë e të mirat që sjell natyra, shumica e të rinjve tanë nuk përpiqen t'i shijojnë fare apo, thënë ndryshe, mjerisht, "i shijojnë" në Facebook.



"Gjimnazisti", revistën e xhevdetdodasve, e cila në vitet 1998 e '99 ishte shndërruar në tribunë publike të UÇK-së, jo vetëm për rininë kryeqytetase. Gjatë bisedës nuk mund të mos u flisja edhe për epopenë e Prekazit, të datës 5, 6 e 7 mars 1998, luftën e familjes dhe vëllazërisë Jashari, e cila e ka lartësuar historinë tonë të luftës për çlirim e bashkim kombëtar. Ndaj, edhe sot, si punonjës shumëvjeçar i arsimit, më brengos fakti se shkollat shqipe, jo vetëm nga Shqipëria, por edhe nga Maqedonia, Kosova Lindore, Mali i Zi, madje edhe nga Kosova, nuk organizojnë ekskursione për ta vizituar Prekazin dhe vendet ku është shkruar historia jonë më e re.

Kështu, bisedë pas bisede, përgjigje pas pyetjeve, do t'i lëmë pas kilometrat e trasesë së rrugës nëpër luginë dhe do të arrijmë rrëzë fshatit Murriz i cili, ashtu sikundër edhe fshatrat tjera fqinje, dukeshin si dekor i asaj shpatine mali. Ecja nëpër dhiare për të shkurtuar rrugën, dhe dielli përvëlues, kishte bërë të lodheshim ca, por pushimi dhe dreka me djathë e domate vendi, çfarë s'i kisha shijuar më parë, do t'na këndellin për të vazhduar tutje. Fshati Murriz, siç do t'më tregojnë, ishte vend i domateve, të cilat rriteshin pa pasur nevojë të spërkateshin me preparate mbrojtëse. Me domate të tilla furnizohej edhe tregu i Tiranës.

Qafa e Murrizit, ku do të arrijmë në orën 13:30, ishte mrekulli e vërtetë. Ajo ma shkonte mallin e Qafës së Borit, të vendlindjes time, fshatit Vuthaj të Plavës e Gucisë. Bredhat erëkëndshëm, ahishta e dendur e cila, fatbardhësisht, nuk ishin prerë e djegur siç më kishte rënë t'i shihja gjetiu, uji i ftohtë dhe i pastër, e bënin këtë vend perlë të bukur turistike çfarë do të shihnim edhe tjera në vazhdim.

Fatbardhësisht perla të tilla natyrore ka shumë gjithandej Atdheut tonë, ndaj edhe rrugëtimin tonë e konsideronim si një ftesë qytetarëve, veçmas të rinjve, për t'i vizituar e shijuar ato, për të jetuar me natyrën e virgjër dhe të pastër. Për fat të keq, bukurit e të mirat që sjellë natyra, shumica e të rinjve tanë nuk përpiqen t'i shijojnë fare, apo thënë ndryshe, mjerisht, "i shijojnë" në Facebook.

Aty, në Qafë të Murrizit, pasi përshëndetemi me Brunildën dhe Klodianin, detyrën e kameramanit, herë me dron e herë me aparat fotografik, do e merr Belino. Duke vazhduar rrugën mrekulloheshim nga pamjet që shtriheshin para nesh, kodra dhe lugina gjelbëroshe të pafund. Dhe, s'kishte si të mos bindesha për të satën herë se pjesët më fushore e pjellore i janë shkëputur e lënë jashtë kufijve të Shqipërisë shtetërore. Rrugës tatëpjetë ecnim ca më shpejt. Para se të arrinim në fshatin Guri i Bardhë të Pjetër Budit, njërit prej poetëve të parë shqiptar dhe luftëtarit me pendë e pushkë kundër okupimit turk, e takojmë gurabardhasin, Tahir Stafën dhe bashkëshorten e tij, dikur mësuese e tani në pension. Ai tregon se në sistemin komunist kishte siguri të plotë, mbrojtje shëndetësore... e sot, pa lekë s'ke mjekim. "Të rinjtë kanë ikur e po ikin jashtë", shton ai. Meqë koha s'na premtonte, s'arritëm të mësojmë diç për Budin dhe truallin ku ishte lindur. Këtë dëshirë shpresoj ta plotësoj ndonjëherë tjetër. Duke ecur rrugicave të fshatit e më pas dhiares malore, arrijmë te shtëpia e Medi Sinës, pranë lumit Mat. Pasi na pret me përzemërsi, na tregon kopshtin ku mund t'i ngrinim tendat, por kur e pyesim për pagesë, hidhërohet. "Mos e përmendni edhe një herë atë punë", shton prerazi. Më pas na tregon se aty ishin vendosur para afro dy shekujsh, sa jeton me prindër, bashkëshorten dhe dy fëmijët e tij. Kur e pyes se "a mërzitën që jetonin fare vetëm, pa pasur asnjë shtëpi afër", thotë se "s'e lë puna të mërzitet". Kjo shihej edhe nga arat, kopshti, pemët, hurdha e peshqve ... Ai merrej edhe me mbledhjen dhe kultivimin e bimëve mjekuese.

Pasi e kalojmë natën të përcjellë nga ushtima e lumit Mat, në mëngjesin e datës 12 tetor shkojmë ta shohim Urën e vjetër të Vashës e, më pas, të përcjellë nga Mediu, ngjitemi të ura e re, po me të njëjtin emër. Këto dy ura sikur shënonin dy epoka, atë të kaluarën dhe epokën e re të sotme. Vendi dhe konstruksioni i urës së re që lidhte dy anët shkëmbore të luginës së Matit, na mrekullojnë, ndaj nuk mund ta përballonim kureshtjen për ta parë nga afër dhe kaluar nëpër të. Donim të ishim udhëtarët e parë që kalonim nëpër këtë vepër madhore arkitekturore, ndaj, falë ndërmjetësimit të deputetes së Qarkut të Dibrës, znj. Almira Xhembulla, dhe mirëkuptimit të kompanisë "Gjoka Konstruksion", realizuese e projektit ndërtimor, kalojmë nëpër trarët e urës të përcjellë nga inxhinieri zbatues, Halil Bushi, i cili na tregon se konstruksioni metalik i urës është 316 m. i gjatë, ndërsa lartësia nga sipërfaqja e lumit Mat, 152 m. Ndonëse isha i mësuar me lartësitë e majave, shikimin poshtë urës, drejt greminës, e përjetoja ca si me ndrojtje. Pasi zbresim në luginën e Qafës së Buallit, vazhdojmë deri në qytetin e minatorëve, në Bulqizën e njohur për minierat e kromit, nga të cilat nxjerrin fitime jo të pakta kompanitë e huaja. Duke ecur fshatrave të Bulqizës, hasim në monumentin kushtuar viktimave të krimeve të ushtrisë serbe të bëra në vitin 1918. Lodhjes, të cilën kishim filluar ta ndienim, tani i shtohet edhe biseda jo e këndshme për krimet serbe. Krime, krime, që nga viti 1878 e këndej. O Zot! Si s'u ngopen me krime kurrë.

Arritja në Fushën e Gjoricës, Logun e Kuvendit të burrave të Dibrës, që shkatërruan ushtrinë pushtuese të Hajredin Pashës, në logun e luftëtarëve të paepur kundër pushtuesve sllavë, të prirë nga heroi dibranë, Elez Isufi, na bën të harrojmë fare lodhjen. Dhe, në orën 21:23, të datës 12 tetor, të dy Dorët, Dori Bulku dhe Dori Cami dhe unë, arrijmë aty ku përfundonte traseja e Rrugës së Arbrit, në fshatin Majtar të Dibrës. Urimet dhe përqafimet me njëri- tjetrin për arritjen e qëllimit, na lumturonin pa masë.

Këto dy ura sikur shënonin dy epoka, atë të kaluarën dhe epokën e re të sotme. Vendi dhe konstruksioni i urës së re që lidhte dy anët shkëmbore të luginës së Matit, na mrekullojnë, ndaj nuk mund ta përballonim kureshtjen për ta parë nga afër dhe kaluar nëpër të.

Ky udhë përshkrim do të ishte i paplotë sikur të mos përmendnim darkën me specialitete dibrane, të cilën na e kishte përgatitur nëna e Dorit, zonja Servete. Jufkat e shijshme, mishi i qengjit i përgatitu sipas traditës shumëvjeçare, djathi i dhive, domatet dhe trangujt e freskët, ëmbëlsira... të përcjella me raki të ndenjur me thana, na shijonin sikur të mos kishim ngrënë sa e sa kohë.

Të dielën, më datë 13 tetor, Dori, nismëtari i rrugëtimit që kishim bërë, duke ditur dëshirën time për të parë sa më shumë vende, do t'na shpie rrugës nëpër Gollobordë, nëpër Parkun kombëtar Shebenik- Jabllanicë, kuptohet, tani më makinë. Toponimi sllav, Gollobordë, Jabllanicë... m'i kujtonte emërtimet e tilla të shumta që i kisha vërejtur anekënd Shqipërisë, gjë që s'e kisha kuptuar asnjëherë pse nuk ishin zëvendësuar me emra shqip. Ndonëse, çështje shumë personale, por s'e kupton njeriu se si dhe pse, edhe sot e kësaj dite, shumë prindër më parë parapëlqejnë t'i emërojnë fëmijët e tyre me emra të huaj se me emra shqip. Veprimi i tillë është edhe më i pakuptimtë kur dihet se edhe emrat vetjakë janë pjesë e kulturës dhe identitetit kombëtar.

Pasi kalojmë Librazhdin, Elbasanin, në mbrëmje arrijmë në Tiranë. Takimi dhe pushimi me Bonën, mikën tonë të përbashkët, prania e të cilës na bënte të ndihemi mirë si kurdoherë më parë, ishte si një shpërblim për misionin tonë të realizuar me sukses.

Eksperimenti del me sukses

Molla “Diamant i Zi” nxjerr frutat e para në Dibër

Eksperimenti i fermerit dibran, Zija Keshi me kulvitimin e mollës unike “Diamant i Zi” ka rezultuar i suksesshëm duke dhënë frutat e para.

Molla “Diamant i Zi” shumë e rrallë në botë për varitetin e saj ashtu si edhe vlerat e larta ushqyese mund të kultivohet dhe rritet edhe në Shqipëri, përveç vendit të origjinës së saj, Tibetit të Largët.

Fermeri Zija Keshi në muajin maj të këtij vitit eksperimentoi kultivimin e këtij varieteti duke kultivuar vetëm 10 fidanë të porositur nga Tibeti, i vetmi vend në botë ku rriten këto mollë.

Gjatë këtij muaji, ai thotë për AgroWeb.org se fidanët kanë dhënë frutat e parë duke iu përshtatur më së miri kushteve dhe klimës.

“Në muajin maj erdhën fidanët e parë, të cilët i porosita në Tibet, Kinë. Qëllimi im ishte të testoja nëse ky varitetet do t’i përshtatej kushteve klimatike dhe strukturës së tokës këtu.

Gjatë gjithë kohës që nga momenti i mbjelljes dhe në vijim janë ambjentuar shumë mirë dhe këtë vit dhanë frutat e para” shprehet Keshi.

Pas fazës së parë eksperimentale, e cila rezultoi e suksesshme tashmë fermeri dibran, i njohur për kultivimin e variteteve të rralla si Ariona, apo Manat Goxhi, do të nisë kultivimin e mollës “Diamant i Zi” në një parcelë më të zgjeruar prej 300 fidanësh.

> Fermeri Zija Keshi në muajin maj të këtij vitit eksperimentoi kultivimin e këtij varieteti duke kultivuar vetëm 10 fidanë.

“Tashmë jam gati të bëj një plantacion pavarësisht që ende jam duke parë 100 % përshtatjen me klimën sepse akoma duhet një vit kohë për të parë rezultatin e duhur por jam i bindur se kjo kulturë do përparojë në vendin tonë.

Në muajin dhjetor pres që nga Tibeti i Kinës të më vijë një ngarkesë prej 100 fidanësh, të cilat do t’i kultivoj në fermën tonë” thotë Zija Keshi.

DETAJET QË E BËJNË MOLLËN ‘DIAMANTI I ZI’ TË MBETET E VEÇANTË

Kjo mollë është krejt ndryshe nga të tjerat. Ngjyra e saj është vjollcë shumë e errët që i përafrohet të zezës, sidomos në agim.

Kjo mollë është shumë larg llojeve të tjera të këtij fruti.



Foto: Flickr

Ndryshimi i parë qëndron tek ngjyra e cila vjen si pasojë e ekspozimit të tejzgjatur të frutit në rrezet e diellit.

Çdo kafshatë e këtij fruti unik është kërce, dhe ndryshe nga mollët e tjera.

Ashpërsia e tulit të frutit i atribuohet kushteve të rënda klimatike në majë të malit ku temperaturat bien ndjeshëm.

Kur errësohet, bie ngrica duke ndikuar edhe tek fruti.

Këto temperatura ndikojnë fort tek lëkura e frutit.

Mollës së zezë i duhet të mbijetojë në këto kushte dhe formon një lëkurë më të trashë për t’u mbrojtur nga ngrica.

Kjo lëkurë e mbron dhe e ruan shijen e brendshme të mollës e cila përshkruhet si e jashtëzakonshme. Molla e zezë është një frut shumë i ëmbël që nuk ka të dytë por për fat të keq është e paarritshme.

Për t’u furnizuar me këtë diamant të vërtetë, njeriut i duhet një avion dhe shumë para.

Mbledhja e frutit me duar është krejt e pamundur për njerëzit e thjeshtë, përveç atyre që janë të krimbur në para.

Njerëzit në Tibet, thonë se është më e lehtë të ngjitesh në Malin Everest se sa të këpusësh një mollë si kjo.

Megjitatë, variante të kësaj molle janë parë të shiten në Azi, por vetëm me disa kokrra.

Kjo për arsye të vështirësive që hasin fermerët për mbjelljen, rritjen dhe kultivimin e kësaj molle.

Arsyeja kryesore është temperatura e ulët që mundëson rritjen e kësaj molle të çmuar e elitare ***(AgroWeb.org)***

OPINION

“Qytetar Nderi i Dibrës” sipas shijes partiake

Nga **PETRIT FETAHU**

Ndarja dhe shpallja e personave “Qytetar Nderi” për kontribute të veçanta në interes të qytetit të Dibrës dhe ata kombëtare nga fushat e ndryshme, është një ide e mirë, por atëherë kur ata shkojnë tek individë meritues. Mirëpo, kur forcat politike të komunës nga papërgjegjësia e shfrytëzojnë për interesa partiake dhe politike krijojnë ndasi tek personalitetet e figurat e mirëfillta, ngase shpërblimet nuk kanë shkuar tek më të merituarit. Kjo ndodh ngase seleksionimet nuk bëhen nga persona kompetent, por nga individë pa përgatitje arsimore adekuate që nuk arsyetojnë shpalljen e tyre. Ndaj është mirë të organizohen debate nga intelektualë dhe të formohen komisione nga profesionistë të njohurive e degëve që do të arsyetojnë shpalljen e tyre.

Së fundi, zgjedhja e Tefik Jegenit, Molnar Kolanecit dhe Saimir Shatkun, si ekspert të hidrologjisë, që u bënë zëngritur në protestat e shoqërive civile kundër devijimit të lumit Radika, duke trajtuar edhe shkencërisht pasojat që sjell ky devijim, meritojnë mirënjohje. Por, kjo duket si hipokrizi e funksionarëve komunalë të BDI-së, që ish-ministri i kësaj partie në pushtetin e Gruevskit nënshkroi dokumentin për këtë devijim. Kjo i ngjan shprehjes popullore: ”Të vrasin natën dhe të qajnë ditën!” Mirëpo, në këtë rast rol funksional dhe themelor luajtën qytetarët dibranë, të cilët bashkë me shoqatat jo qeveritare të Dibrës, ngritën fuqishëm e masivisht protestat, duke treguar vendosmëri, qëndrim të palëkundshëm gjer në vetëflijim, që zbrapsi nismën e qeverisë.

Dibra ka pasur shumë figura që meritojnë të zgjidheshin e të shpërbleheshin, sidomos ata që ngritën revoltën kundër shovenizmit sllav, rezistuan kundër politikës antishqiptare, kundër copëtimit të trojeve shqiptare,

> Të gjitha këto argument dëshmojnë se zgjedhja për shpallje “Qytetar Nderi të Dibrës” kërkon një analizë të thukët dhe një përgjegjësi morale, etike, njohëse dhe kombëtare, të argumentuar, duke shmangur interesat personale dhe politike, ngas kjo është në dëm të seleksionimit të drejtë. Së pari duhet të çmohet kontributi qytetar, gjithëkombëtar e pastaj ai territorial.

përkrahën pluralizmin politik menjëherë pas luftës antifashiste dhe zhvilluan veprimtari atdhetare kombëtare ndaj “hëngrën” shumë vite burg dhe përjetuan terror të paparë. Ndër ta ishte Xhafer Kodra, nënkryetar i RM, po që s’e joshi kolltukun, por mbrojti idealet nacionale, ndaj u akuzua “për veprimtari kundër shtetit”. Por, në realitet ai iu kundërvu shovinizmit maqedonas, që ishte shumë agresiv dhe i padrejtë. Dhuna e egër e çmendi.

Nexhat Agolli, ministër i shëndetësisë, i cili kërkonte barazi dhe të drejta të barabarta, për të cilat kishin luftuar shqiptarët. Ai u akuzua se gjoja donte të shkatërronte vëllazërim-bashkimin. Dhe u vra duke iu shpifur se donte të kalonte kufirin.

Burhan Pasholli, atdhetar i paepur për liri dhe bashkim kombëtar, anëtar i Organizatës Demokratike Shqiptare, nismëtar dhe ideolog i pluralizmit. Ai kërkonte përmirësimin e gabimeve historike të Konferencës së Lodrës, kundër shpërnguljeve në Turqi, hapjen e shkollave, përdorimit të flamurit kombëtar etj.

Kemi edhe shumë të tjerë që qëndruan në krye të demonstrave anti-jugosllave, që u futën nëpër birucat dhe u torturuan, por mbetën besnik të idealeve të tyre, s’u bënë “oligarkë” të partive, nuk lakmuan postet qeveritare, ashtu siç vepruan shumë të tjerë.

Edhe Moisi Murra e Fatos Daci, të shpallur “Qytetar Nderi të Dibrës”, të cilët kanë dhënë kontribut në ndriçimin e shumë ngjarje historike, sidomos të periudhës të sundimit osman dhe të figurave të dalluara të kësaj kohe, përmes portretizimeve apo edhe të zhvillimit të arsimit në tërë rejonin e Dibrës’. Por, në këto studime, ka edhe trajtime komerciale me performanca glorifikuese atdhetare, por edhe arsimtarë që nuk kanë dhënë asnjë meritë gjatë zhvillimit të arsimit në Dibër. Andaj, për të bërë një analizë shkencore të veprave dhe të veprimtarive të tyre, duhej të caktoheshin studiues kompetent që do të bënin analizën dhe zbërthimin e vlerave dhe jo vlerave dhe të mos bëhej përcaktimi nga individë që s’kanë asnjë përgatitje të tillë, apo për shije individuale e politike.

Unë do të propozoja që disa prej tyre, të harruar, të shiheshin me pozitivitet në të ardhmen. Njëri prej tyre është Kristo Frashëri, i cili bëri gjithëpërfshirjen historike të Dibrës nga lashtësia e hershme deri në ditët tona, te shkrimet e të cilit do të gjejnë mbështetje të gjithë studiuesit të tjerë të ardhshëm.

Hulumtues dhe shkencëtar i njohur në rang kombëtar që zë një vend të denjë si historian i letërsisë është dr. prof. Mahmud Hysa, profesor universitar, botues i më se 50 studime të veprave të shkrimtarëve të periudhës së letërsisë së vjetër, alamiadës, të romantizmi, të realizmit gjer te ato të modernes, pjesëmarrës në shumë simpoziume, të ballafaqimit eseist dhe polimizues me shovenistë sllavofilë etj., që e bëjnë ndër më të merituarit për shpalljen qytetar nderi të Dibrës.

Një ndër hulumtuesit e dalluara të trevës dibrane është Adem Bunguri, i cili përmes gjurmime arkeologjike zbuloi lashtësinë e Dibrës, por edhe studiuesit e trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore, si Nam Plaku, Xhafer Martini, Hazis Ndreu, që pothuajse nuk veçohen nga të tjerët.

Në kohën kur në Dibër papunësia është e madhe dhe mërgimi i shtueshëm nga një politikë e keqe dhe e padrejtë sociale dhe të zhvillimit e të investimit, sadopak për ta zbutur, bënë emigrantët dibranë në SHBA, gjegjësisht ne Alaskë, Abib Sela me të birin e tij, Ilirin, dhe Zudi Dobrova, të cilët hapën call-centar-in për porosi të picave të shtetasve të tyre, duke punësuar qindra vajza dhe gra, të cilat mbajnë familjet e tyre, dhe në një masë, penguan zbrazjen e qytetit. Edhe këta të dy duhej të ishin ndër të merituarit për t’u shpallur Qytetar Nderi.

Të gjitha këto argument dëshmojnë se zgjedhja për shpallje “Qytetar Nderi të Dibrës” kërkon një analizë të thukët dhe një përgjegjësi morale, etike, njohëse dhe kombëtare, të argumentuar, duke shmangur interesat personale dhe politike, ngas kjo është në dëm të seleksionimit të drejtë. Së pari duhet të çmohet kontributi qytetar, gjithëkombëtar e pastaj ai territorial.

NJOFTIM PËR BASHKËPUNËTORËT!

Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët dhe korrespondentët tanë se shkrimet duhet t’i sjellin në redaksi para datës 20 të muajit.
Për çdo rast, komunikoni me redaksinë!

vëzhgim


Ekocidi i parkut madhështor të Shqipërisë përmes fotove

Si e humbëm Lurën

Nga **MARSEL LELA** / *Politoko.al*

Ndërsa ecim rrugëve të Tiranës, te 'Komuna e Parisit', Sevin Serjani, një mik dhe aktivist i shoqërisë civile, më tregon një histori sa komike aq edhe tragjike. Një ndodhi që i kishte ngjarë disa aktivistëve për mbrojtjen e natyrës, të cilët ishin nisur drejt Parkut të Lurës për të mbjellë disa pisha. Mjeti me të cilin ata udhëtonin që nga Tirana nuk e përballonte dot rrugën deri te Parku dhe aktivistët vendosin të gjejnë një makinë më të madhe, që mund të ecte nëpër rrugën e keqe.

Një banor i zonës, që ishte aty i pranishëm, u vjen në ndihmë duke u thënë se do të përpiqej të gjente një makinë të përshtatshme, që të mund t'i nxinte të gjithë. Ndërkohë ai nxjerr telefonin dhe merr dikë, të cilit i drejton këtë pyetje: 'Ben, a do të shkosh sot lart për të prerë pemë se kanë ardhur ca nga Tirana për të mbjellë?'

Këtë histori Sevini ma tregon ndërsa shkojmë tek 'Galeri E. Rira', ku artisti Ajet Rira ka zhvilluar një ekspozitë me titull 'Si e humbëm Lurën'. Ekspozita përmban foto të masakrës ekologjike që i është bërë jo vetëm asaj zone, por gjithë Shqipërisë. Një prej parqeve përrallore, i njohur edhe jashtë Shqipërisë për bukuritë, sidomos për shtatë liqenet idilike, Parku i Lurës ka qenë kurora e lavdisë së peizazhit malor shqiptar.

Por sot kjo Lurë ka mbetur vetëm në kartolina apo intervalet e dikurshme të TVSh-së. Kush nuk ka mundur ta vizitojë përpara ekocidit që dora e njeriut bëri ndaj këtij Parku, nuk do mund të thotë kurrë se e ka shijuar plotësisht madhështinë e tij. Fotografitë e Ajet Rirës janë plagët e Lurës që kullojnë gjak në sytë e të gjithë atyre që janë të dashuruar me natyrën, e që janë mirënjohës ndaj bujarisë së saj. Në to shihen hektarë të tërë pyjesh të shkretuar pa mëshirë nga motosharrat që nuk kanë kursyer as drurët qindravjeçarë.

"Unë jam nga Rrajca, që ka Shebenik-Jabllanicën që është pjesë e UNESCO-s. Jam i apasionuar që në vogëlinë time me pyjet." Kështu e nis rrëfimin e tij artisti Ajet Rira, duke shtuar se Rrajca ka një madhështi tjetër në raport me Lurën që është sot. Ai tregon për Politiko.al se nuk ka pasur mundësi ta vizitojë Lurën në atë periudhë, por ai e shijonte atë gjithmonë nëpërmjet një hapësire televizive te TVSh-ja. Bëhet fjalë për një interval muzikor ku në sfond ishte Parku i Lurës. Rira shprehet se ato pamje i ngjasonin me Pyllin e Zi në Gjermani, i cili e ka marrë këtë emër nga dendësia e madhe e pemëve në të. Këto pamje ngulitën në mendjen e Ajet Rirës dëshirën për të parë Lurën.

"Unë shkova në Lurë për ditëlindjen time dhe në momentin që arrita atje u përballa me gjithë këtë masakër që në të gjithë udhëtimin tim turistik dhe në të gjitha daljet e mia në Evropë dhe Perëndim, unë nuk kam arritur të gjej dot arsyen se çfarë mund ta shtyjë njeriun që të shkaktojë një kasaphanë të tillë", shprehet Rira.

Ishte pikërisht kjo ajo që i dha atij spunton për të bërë një projekt të mbështetur nga Fondi Zviceran për Kulturën në Shqipëri, të cilin ai e përktheu në një ekspozitë fotografike rreth gjithë asaj masakre që i kanë bërë Lurës.

Ai shton se do ta mirëkuptonte prerjen e pemëve nëse kjo do të bëhej për interesa të vogla, siç është shfrytëzimi i druve për zjarr. Por sipas tij, pas kësaj kasaphane ka edhe një realitet tjetër të hidhur që lidhet me prerjen në masë të këtij pylli, jo thjeshtë të disa pemëve. Me keqardhje, Ajeti shprehet se dëmi që i është bërë Shqipërisë me prerjen e pemëve në Lurë është disa miliard dollarë. Për të kjo histori mund të kuptohet vetëm nga disa që kanë njëfarë kulture, ndërsa pjesa tjetër e shohin, siç thotë ai, si 'fshati në festë'.

"Nëse e shikon me vëmendje te fotot që kam paraqitur në ekspozitë, gjithçka këtu është prerë me dora e njeriut."

Rira e hedh poshtë idenë se kjo masakër është bërë nga vendasit, apo barinjtë, pasi ai shikon pas këtij ekocidi dorën e shtetit dhe përfituesve që kanë lidhje të ngushta me të. Këtu ai përmend disa statistika të frikshme, sipas të cilave ajo zonë është shpopulluar thuajse tërësisht.

"Ka një statistikë, nëse shkojmë sot në Lurë, ose në harkun kohor të 5-6 viteve të fundit nuk gjen dot më shumë se 5-6 njerëz. Njerëzit kanë ikur. Prandaj me disa terma abuzohet, pasi nëse marrim deklaratat që ia vuri zjarrin bariu, apo i prenë barinjtë, aty nuk ka më barinj. Nëse shkojmë bashkë do të shohim që ata njerëz që banojnë aty edhe kosin që përdorin e blejnë në dyqan."

Përtej kësaj, dimensioni i liqeneve të Lurës ka një shtrirje shumë të mdhe gjeografike. Artisti shpjegon se për të shkuar nga liqeni i luleve tek liqeni i madh, aty ku vdiq ish-ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, Joseph Limprecht, është një distancë kilometrike sa nga Kodra e Diellit te Mali me Gropa.

"Mund të jenë përdorur disa banorë të zonës në atë periudhë, por për të bërë punën e krahut dhe pjesa tjetër pastaj ka pasur një klan të mirëfilltë trafiku për gjithë këtë masakër që është bërë këtu."

Rira shpjegon se ata nuk kanë treguar as interes për të folur, madje në dy apo tre raste kanë tentuar të humbasin edhe gjurmët duke i vënë zjarrin, por ka qenë një lëvizje jo e menduar sepse këta janë drurë që nuk marrin kollaj flakë e të zhduken si bari. Siç shikohet edhe në fotot e ekspozitës, zjarri nuk ka mundur t'u bëjë gjë trungjeve dhe ato kanë mbetur sërish aty si një provë e gjallë e masakrës shumëvjeçare që i është bërë Lurës.

Disa nga pemët e prera, trungjet e stërmëdha të të cilëve duken në foto janë mbi 300 vjeçare sipas ekspertëve. "Një sasi e tillë lënde drusore e çuar jashtë përkthehet në miliarda dollarë. Dhe po të shohësh sipërfaqet për metra katrorë që janë shpyllëzuar



në atë vend do të kuptosh që shifra është marramendëse", rrëfen Rira.

Ai shprehet se ka dëshirë ta zhvillojë këtë projekt për të shkuar edhe në vende të tjera ku natyrës shqiptare i janë bërë masakra të tilla. Artisti shpjegon se ky është një projekt relativisht i kushtueshëm në dy aspekte. Së pati në aspektin financiar, e së dyti është edhe aspekti tjetër ku, sipas tij, duhet të jesh i zgjuar për të gjetur kohën që mos të krijosh tensione, sepse ka disa njerëz të cilëve mund t'u preken interesat nga kjo dhe ai është personi që duhet të përballet direkt me këtë.

Më tej ai shton se i ka kërkuar ndihmë shtetit që të mund të sillte në ekspozitë disa trungje që të ishin prezentë aty, pasi sipas tij, kjo është mënyra e vetme që njeriu të identifikohet me madhështinë e tyre. Kjo ndodh për shkak se në natyrë objektet humbasin pasi janë në habitatin e tyre, në hapësirën e tyre dhe pamja duket krejtësisht normale. Por duke i parë në një ambjent tjetër, arrin ta dallosh më mirë përmasën që ato kanë.

Sipas artistit Ajet Rira, në më pak se 20 vjet kemi humbur mbi 380 km2 sipërfaqe pyjore. Thënë më qartë, kemi humbur sipërfaqen e Bashkisë Durrës dhe Sarandë të marra së bashku. Krahas pyjeve, kemi humbur vlera të pallogaritshme në oksigjen, biodiversitet dhe përjetime natyrore dhe sociale. Nëse vazhdohet me këtë ritëm, shumë shpejt hapësira pyjore e Shqipërisë do të reduktohet në trungje cung, hapësira djerrë, përmbytje masive të përsëritura e të tjera katastrofa ekologjike.

Marrë nga politiko.al.Shkrimin origjinal e gjeni në lidhjen: https://politiko.al/si-e-humbem-luren-ekocidi-i-parkut-madheshtor-te-shqiperise-permes-fotove/?fbclid=IwAR1U-fy6NONvviOUTGbswOMX0YL13JIY0-qWJbzF0jWYzhu-DaehmuEV_0c3g







Dibranët kanë kërkuar gjithmonë mirëkuptimin e brezave, përkushtimin e këtyre djelmoshave për të ecur në gjurmët e të parëve.

Rinia, *hapa përpara* **për ruajtjen e traditave**

Nga **HALIL TEODORI**



Në foto: Dhoma e pritjes në Bujtinën Hupi, Bulqizë. (foto ilustruese)

Ndërsa shoh të rinjtë sot, tek rriten dhe të ardhmen e tyre, që hapet si një horizont i qartë, pafund e paanë, më vjen ndër mend e kaluara e brezave tonë. Një proverb thotë se kush lexon qartë të kaluarën, shkruan saktë të ardhmen. Kjo është shumë e rëndësishme dhe mendoj se është një çast shumë domethënës në jetën e njeriut. Madje, psikologjia shkon më tej se kaq, ajo është e mendimit, se te fëmijëria, te çdo hollësi, sado e parëndësishme qoftë, ndodhen të fshehtat e të sotmes sonë. Në çdo hollësi të moshës së pavetëdijes, të asaj moshe që kujtojmë me mallëngjim janë të vendosura themelet e personalitetit tonë.

Njëkohësisht, jo më pak e rëndësishme është mbajtja e lidhjeve me brezat prej nga rrjedhim, si hallka e një zinxhiri me tjetrën që përbëjnë një të tërë. Ky zinxhir sa më i fortë të jetë dhe hallkat e tij sa më të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën të jenë, aq më kryelartë e pret të sotmen, aq me krenari ua pason brezave atë. Literatura filozofike dhe shumë teori përcaktuese të mendjeve të mëdha nga Frojdi e deri më sot mbështesin te prejardhja themelin kryesor, ku për çdo brez ngrihen shtyllat e qëndresës. As më shumë e as më pak, në një farë mënyre jemi një riciklim i atij brezi, një prirje përsosmërie në strukturimin e të sotmes dhe garanci për atë brez, që do të çojë përpara gjithë këtë bazë gjenetike, të cilën e kemi të trashëguar dhe që do ta pasojmë deri në përjetësi.

Megjithëse koha dhe njerëzit nuk kanë qenë të kujdesshëm për të plazmuar epokat, ngjarjet apo personazhet, ata kanë mundur të kapërcejnë gjithë këtë harresë për të ardhur si personazhe të plota. Të gjithë ata burra që sakrifikuan në historinë e vendlindjes sonë, janë personifikuar si atdhetar të flaktë, njerzë me mendje të ndritur, me zemër të artë.

Dëshmitë e kohës dhe gjithçka kujtojnë rreth tyre nga bisedat e ndryshme, rrëfejnë, se ata ka qenë pothuajse të rrallë në atë zonë. Kjo cilësi, që karakterizonte gjeneratën tonë, natyrisht që do të kishte një rrugë të gjatë për të bërë dhe sigurisht që do të kishte edhe koston e saj.

- Ka qenë burrë!

Ky përcaktim që në etimologjinë e sotme të termave dhe shprehjeve frazeologjike nuk merr ndonjë qartësim dhe përcaktim shumë domethënës, asokohe e sidomos në anët tona, ishte një nga vlerësimet më të rëndësishme. Ky term nënkuptonte: burrërinë, trimërinë, besën, nderin, bujarinë, pasurinë..., e natyrisht edhe atdhetarizmin, si një nga cilësitë kulmore.

Treva jonë i përket një zone atdhetarësh dhe patriotësh që sakrifikuan gjithçka në shërbim të atdheut, në shërbim të lirisë, pa të cilat gjithçka është asgjë. Elez Isufi, Haxhi Lleshi, Cen Elezi,Riza Navaku, Myslim Shehu, Cen Puca, Bajram Zeneli, Selim Alliu, Asllan Zeneli, Selman Qylhani, Hasan Muglica, Mois Cami... kan bërë të pa mundurën për të ndihmuar luftën nacionalçlirimtare. Këtë veprim e ndeshim shpesh nëpër faqet e historisë, ku njerëz të përkushtuar për idealet e shenjta të atdheut e të popullit kanë dhënë gjithçka, që ata kishin në këmbim të lirisë dhe të mëvetësisë. Ata, pra paraardhësit tanë, nuk kanë kursyer as jetën për këto ideale. A nuk ishte një nga këto dhe Mustafa Shehu i Zerqanit që zbrapsi Hajredin Pashën dhe si rezultat sakrifikoi jetën për idealet tona kombëtare?.

Hallet dhe luftërat e shumta, përplasjet me armikun kanë bërë që Dibra të ketë gjuhën e folur karakteristik të vetën gjuhë që veç dibranëve është vështirë ta kuptojnë çdo kush. Është gjuhë që është folur nga nevoja, ajo e ka origjinën shumë më herët se ne e njohim historinë.

Dëshmi historike të bashkëkohësve, gjithashtu tregojnë se Dibranët kanë marrë pjesë në të gjitha luftërat për mbrojtjen e vendit, duke dëshmuar trimëri dhe vetëmohim.

Dibra jonë është një trevë e lashtë Dardane, me histori Pellazgo-Ilire, që njihej, jo vetëm për patriotizëm, por edhe për mikpritje e bujari. Ajo vjen deri në ditët e sotme nga ai vend, ai realitet tregues ku ka fillesat e saj edhe vetë historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve.

Në Dibër, faktet e dokumentuara historikisht dëshmojnë se lindi dhe u rrit heroi ynë kombëtar, Gjergj Kastrioti (Skënderbeu). Aty, ai mblodhi ushtarë për t'i bërë ballë pushtimit turk, që kërcënonte me një ushtri të shumëfishtë në numër. Në histori njihen nëntëmbëdhjetë beteja, vetëm në Dibër, ku Skënderbeu bëri një luftë të madhe kundër turqve duke i munduar ata dhe hordhitë shfaruese, që po kërcënonin njëkohësisht dhe Evropën, kulturën dhe qytetërimet shekullore.

Dibranët nuk kanë qenë pasanik, varfëria është shtruar vazhdimisht në sofër por pothuajse asgjë nuk ka munguar, bujaria, besa, shtresa e mbulesa... Njerëz që janë kollandisur me fukarallëk, por atë pak që kanë pas, me shpirt e me zemër ja kanë nxjerr mikut në sofër. Kohët kanë lëvizur përpara dhe ky ovulim është pozitiv por dua të them se dikur,edhe pse kishin më pak ishim më të lumtur dhe jetonim më afër me njeri tjetrin, respektonim njëri-tjetrin dhe dashuria ishte e pranishme kudo.

Çdo pasuri e venë ndër dibranët ka brenda shijen e mundit dhe djersës së atyre njerëzve punëtorë e të pa lodhur, që e bëjnë natën ditë. Po kështu edhe pozitat e vështira natyrore e gjeografike, kanë bërë, që, sakrificat për jetën kanë qenë ma të mundimshme se kudo.

Padasht me e mbrojt vendlindjen time dua të them se qysh sa e njoh unë historinë e Dibrës, ma shumë se çdo gjë tjetër vetëm luftëra kam dëgjuar.

Të gjithë ata që kanë lindur në Dibër dhe ata qe e kanë prejardhjen nga Dibra nuk e kanë bezdi ta quajnë veten dibranë.

Dibranët kudo që punojnë e jetojnë, kanë dëshmu njeriun e mirë, qytetarin e botës, njerëz të thjesht dhe larg krekosjes.

Hallet dhe luftërat e shumta, përplasjet me armikun kanë bërë që Dibra të ketë gjuhën e folur karakteristik të vetën gjuhë që veç dibranëve është vështirë ta kuptojnë çdo kush. Është gjuhë që është folur nga nevoja, ajo e ka origjinën shumë më herët se ne e njohim historinë.

Është pikërisht Dibra, ky vend i shenjtë, që ka qenë dëshmitar i luftërave nëpër të cilat ka rendur kalvari i gjatë i qenësisë sonë kombëtare, që nga luftërat në kohën e Ilirëve, kohën e Skënderbeut, luftën e Dibrës kundër Hajredin Pashës, për të vijuar më pas me Elez Isufin dhe luftëtarëve të tij kundër serbëve. Kjo tokë është vaditur me gjak, ngritur mbi sakrificat e panumërta, mbi vetëmohimin dhe devotshmërinë atdhetare, që gjallon në ato anë si rrallëkund më e flaktë.

Një tjetër çast shumë domethënës, me tipare të veçanta dhe me një mesazh që kalëron nëpër të gjitha kohërat që nga antikiteti Pellazgo Ilir, në letërsinë latine, në rrëfenjat magjike ballkanike e deri në realitetin e prekshëm të asaj ane është atdhedashuria.

Ajo, që quhet pozitive është se janë ruajtur me saktësi dhe origjinalitet të gjitha elementet e traditave tona kombëtare dhe janë pasuar në forma nga më të ndryshmet të shkruara dhe gojore dhe më e rëndësishmja është se vazhdojnë të ruhen e të pasurohen dhe sot.

Prova e burrërisë e praktikuar në këtë zonë dhe që ruhet edhe sot e kësaj dite si një visar i çmuar dhe i pashoq i atributeve qytetare, emancipuese dhe traditave të shkëlqyera të zonës është një provë kalorësiake, është një test shumë kuptimplotë. Dëshmi të tilla kaq origjinale, të rralla dhe të qenësishme me gjithë parametrat e një filozofie qëndrese dhe dinjiteti i ndeshim tek-tuk në trevat e Shqipërisë, kryesisht në Veri. Atë e ndeshim shumëkund në përvojat historike të popujve të tjerë, si tipar përcaktues për forcën e gjenerimit të brezit, përjetësinë e produktit gjenetik, për forcën gjeneruese të rezistencës.

Prova, besa,trimërie,atdhedashurie, burrërie...., kanë lindur dhe bashkëjetuar me këtë komunitet si nevojë organike, si domosdoshmëri e praktikimit të formave dhe filozofive të vazhdimësisë në kushtet e një realiteti të ashpër natyror dhe të një jete tejet të mbartur me ashpërsi.

Dibranët kanë kërkuar gjithmonë mirëkuptimin e brezave, përkushtimin e këtyre djelmoshave për të ecur në gjurmët e të parëve. Kjo ka bërë që rinia dibrane të hedh hapa të rëndësishëm kryesisht në atë të lindjes së traditës, që natyrisht ka ardhur dhe është formuar përmes përvojash të vështira dhe pësimeve që i bënë mësime.

** Titulli është redaksisë. Botuar për herë të parë në faqen personale në Facebook të autorit me titullin "Dibra ime".*



Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit

ose ndiq linkun: goo.gl/1bq2r6

letër

Letër e Munir Shehut drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës, Seksionit të Muzikës. 20.1.1960

Munir Shehu: Si më vodhi Radio Tirana kangën "Bulqizakeja"


Ministrisë s'Arsimit dhe të Kulturës - Seksionit të Muzikës -Tiranë

I nënshkruemi, Mynir Shehu, mësues muzike pranë Shkollës Pedagogjike "8 Nëntori" në Peshkopi, kam nderin të ju parashtroj sa vijon.

Si çdo punonjës i kulturës në vendin tonë, që kryen nji aktivitet për të zgjanue thesarin kultural të popullit, ashtu edhe unë, mbrenda këtyne tre-katër vjetëve të fundit, për sa më kanë lejue dhe aftësitë, kam mundë me krye nji diçka të vogël, që asht pritë mirë nga populli i ynë, nga Partija dhe nga Pushteti në rreth. Unë kam kompozue disa kangë e valle, tue u-bazue ma fort në dialektin dibran. Për të mos thanë aspak, mue më duket se përpara festivalit të vitit 1957 fort pak vlerësohej motivi folkloristik i muzikës dibrane. Kangët dhe vallet, që hodha unë në këthough festival, u-përhapën shumë në popull, dhe vetë fakti që tani shumë të tjerë kërkojnë të kompozojnë e të përpunojnë melodi, tue u-bazue në këto motiv, më ban të besoj se unë, atëherë, kam krye nji punë të mirë.

Unë nuk kam ndër mend këtu që të çfaq vlerën e këtyne kompozimeve dhe as kërkesën time për shpërblime, sepse shpërblimi ma i math për mue ka qenë vlerësimi, që u ka ba atyne populli. Por nuk mund të qëndroj indiferent kundrejt qëndrimit të padrejtë që po mban Radio-Tirana e, ndoshta, edhe ai Seksion kundrejt këtyne kompozimeve. Unë nuk jam kursye që kompozimet e mija t'ia jap Shtëpisë së Kulturës këtu në Peshkopi, Radio-Tiranës dhe kujtdo, që m'i kërkue. Këtë e kam ba që të popullarizohet kanga dhe valleja dibrane; por nuk më shkoi ndër mend që njerës të ndryshëm do të gjejnë terren për të abuzue në këto sinqeritet.

Qysh tani në fillim e shoh se më duhet të zgjatem pak. Unë nuk e kam drejtue asaj Ministrije asnji herë asnji kërkesë. Kjo çashtje ka rëndësi për mue dhe më duhet të shpjegohem për hir të punës. Në vitin 1956 të dërguemit e Radio-Tiranës, me rasë të ngritjes së nji montazhi informativ këtu në Peshkopi (me muzikë të dhanun krejt prej meje), u-përpoqën me inçizue kangën time për tekst e melodi "Bulqizakeja" me solit Besim Çutrën. Atëherë dritat nuk punonin në rregull, dhe incizimi nuk doli edhe aqë i mirë. Por, me gjithë atë, Radio-Tirana pat dhanë n'emisionet e saj disa strofa të kësaj kange, e, sidomos, kur kishte për të dhanë ndonji lajm për minierën e kromit "Fitore" të Bulqizës. Këtë kangë Shtëpija e Kulturës këtu në Peshkopi e ka shfrytëzue në shfaqjet e saj, e, prandej, ajo asht përhapë mjaft në popull. Kështu ata të Radio-Tiranës e kanë gjetë diku në Burrel e e kanë inçizue; por jo vetëm kaqë, ata e kanë gjetë në Shkodër e e kanë inçizue. I pari incizim i bamë në Burrel neverit çdo njeri që e ndigjon. Solisti llomotit disa fjalë pa kurrfarë kuptimi, ndjenje e humori tue prishë krejt përmbajtjen e shëndoshë të saj. Melodija asht krejt e bastardhueme. Për incizimin e dytë të bamë në Shkodër solistët janë të mirë, e unë i falënderoj për interesin, që kanë tregue për kangën time. Mirë më thonë (këtë ma tha tash së fundi në Tiranë shoku Tish Daija) se ata e kanë marrë prej gojës së nji ushtari, që ka qenë me shërbim në Bulqizë. Si ç'dihet kanga, tue kalue gojë më gojë, deformohet. E, pra, edhe në këto rasë, fatkeqësisht, incizimi i bamë në Shkodër ka defektete tij, e, sidomos, teksti nuk asht aspak ai, që kam ba unë. Unë i kam këndue asaj bulqizakeje, që, me dollamën e kuqe, gjoksin plot me xhingra, cfurkun në dorë tue tjerrë "tirët", tufën e dhive përpara, nget si nji dhi e egër shkrep më shkrep. Unë i kam këndue asaj bulqizakeje, që, përkrah minatorëve të Bulqizës, po e transformon krahinën e saj të ashpër në nji vend të lulëzueshëm. Unë e kam paraqitë bulqizaken e ashpër, ashtu, si ç'janë të ashpra edhe vendet, ku ajo jeton. Bulqizakes sime nuk i ban zemra ""rik-e-take", shprehje kjo, që përdoret në shumë kangë të Shqipënisë së Mesme, por zhduket nëpër dushqe. Vetëm, kur vjen në minierë, asaj i pëlqen puna, gjenë nji burr e martohet. Kanga, që kam ba unë për



të asht e motivit dibran, dhe, a ka mundësi, pra, që t'i ipet ky interpretim? Por, mbi të gjitha, po të durohen shtrembërime të tilla, atëherë, ku mbetet puna e autorit me vlera artistike e veprës së tij? Asnji kompozitor, as edhe ata të Radio-Tiranës, nuk do të duronin që të shtrembërohen kompozimet e tyne, dhe kjo asht nji e drejtë e padiskutueshme. Mos vallë, sepse në Tiranë, në Shkodër e në Korçë ndodhen kompozitorët tonë ma të mëdhej, që kanë në dispozicion orqestrat edhe solistët ma të mirë, këta kanë të drejtë që të mos i marrin a por të mos i quejnë edhe aqë serioze punët tona të vogla? Me kangën puna vete kështu që shumë herë ato bajnë nji jetë fare të shkurtë, nji ose dy vjetë, edhe, pastaj mund edhe të harrohen, sepse ua zanë vendin kangë të tjera ma të reja ose ma të bukura. Unë kam të drejtë të dëshpërohem, kur shoh se "Bulqizakeja" e ime po ban nji jetë shumë të keqe. Këtu në Peshkopi këtë e shohin të gjithë, dhe, sa vetë që takoj në rrugë, më pyesin: Përse nuk protestoni? Dhe pastaj asht e imja a por asht e popullit? Të gjithë kompozitorët kompozojnë kangë për popullin, por në fund ruhet e drejta e autorit. Kuptimi i kësaj shprehjeje parimore dihet, por vallë Radio-Tirana a e ka vu në zbatim? Unë vuna pikëpyetje në fund të kësaj fraze, por edhe në të vërtetë duhet vu kjo pikëpyetje. Nuk due ta shtroj këtë çashtje në nji analizë të përgjithshëme, por unë due të shtroj që, për sa u përket krijimeve të mija, ky parim nuk asht ruejtë. Natyrisht këtu nuk baj fjalë se dikush vodhi krijimet e mija, ato nuk i ka vjedhë asnjeri; ato i këndon populli, i këndon Radio-Tirana, e unë jam krenar që këto kangë janë futë në thesarin e popullit. Por nuk pranoj që të quhen "kangë popullore", si ç'i quen Radio-Tirana, kur i jep n'emisionet e saj, sepse, t'i quejshë kështu, don të thotë t'i varrosish në varrezat e ushtarëvet të panjoftun, don të thotë të humbasish punën time. Ato kanë nji autor, ky autor jam unë.

Kangën "Katundare në Katund të Ri", t'inçizueme dy herë këtu në Peshkopi dhe nji herë në selinë e Radio-Tiranës, me soliste Sehadete Miftarin, ajo e ka futë në listën e kangëve popullore me autor të panjoftun. Për ma keq, ai Seksion ka lejua botimin e saj në "Kangë për Masa" (v. 1958) tue i vu vizë emnit tim pa të drejtë. Për kangën "Mirditoreja", t'inçizueme këtu në Peshkopi me nxanësit e Shkollës Pedagogjike, nuk përmendet asnji herë emni im. Për vallen e Vashave (suitë vallesh popullore dasme dibrane për gra) të kërcyeme, të këndueme e t'inçizueme për herë të parë me vajzat e Shkollës Pedagogjike në Peshkopi, veprohet po kështu. Valleja asht inçizue tue përdorë si instrumente qetelitë, por kjo nuk don të thotë se mund të gjejshë në popull, tek ata, që u bijën qetelive, një valle kaqë të qëndisun e të gjatë (afër 10 minuta). Ajo asht e imja, e këtë ua kam tregue inçizuesëve.


Po kështu veprohet për kangën time kushtue dëshmorit Nazmi Rushiti. Kjo e fundit u-këndue për herë të parë në vitin 1957. Nji pionier i Shkollës Shtatëvjeçare në Peshkopi, i quejtun Hasan Hajdari, që banonte në konviktin e Shkollës Pedagogjike, e ndigjoi këtë kangë, kur unë po e përgatitshe me grupin folkloristik të shkollës, e kopjoi dhe ia dërgoi gazetës "Pionieri" për të marrë pjesë në nji konkurs të shpallun prej saj. Pionieri fitoi çmimin e parë në konkurs dhe e stolisi dorën me një orë të bukur. Redaksija e botoi kangën në nr. 22, dt. 1 Qershor 1957, natyrisht me shumë gabime e cungime. Seksioni për botimin e kangës, ndërsa unë e urova nxanësin tim për orën e bukur, që ai e mbante me krenari.


Mos vallë nji urim të tillë presin prej meje edhe ata të Radio-Tiranës për kontributin, që u jap unë, sado që, unë e dij, ky kontribut asht shumë i vogël? Sa herë vijnë në Peshkopi incizuesit e Radio-Tiranës kërkojnë muzikë për montazhet e tyne. Nga muzika, që u kam dhanë për montazhet dhe nga kangët që kanë inçizue, ata vetë mund ta kenë stolisë dorën e tyne me ndonjë orë të bukur, ndërsa, (këtë më vjen turp ta them, ndonëse mbas shumë vjetësh), mue nuk më kanë dërgue as edhe nji lapës sa për të shkrue nota. Tani ka kalue mjaft kohë, dhe unë e thashë edhe ma sipër se nuk e ve aspak në diskutim çështjen e pagesës, me gjithë se, si mbas vendimit të Këshillit të Ministrave, që u përket krijimeve, Radio-Tirana më mbetet borxh. Por desha me thanë se, sikur e marrin me shumë lehtësi punën tonë incizuesit e Radio-Tiranës, ashtu edhe duhet të përgjigjen me shumë lehtësi, por jo hiç fare. Kur vijnë këtu në Peshkopi, ata premtojnë, betohen deri në "për ideal" dhe lidhin kështu nji kontratë të bukur, por pastaj ... harrojnë. Përse të mos e them se, ndoshta, ndonji, porsi nxanësi Hasan Hajdari, mund të përfitojë dhe të abuzojë në kurrizin e punës sime?

Unë kam tani plot kangë të tjera; por në kondita të tilla kaqë të papranueshme për mue, nuk kam se si ia jap Radio-Tiranës. Dhe jo vetëm kaqë, por nuk mundem me ia dhanë as Shtëpisë së Kulturës e të Krijimtarisë Popullore këtu në Peshkopi, sepse kam frikë se përhapen (!), shtrembërohen e pastaj, kështu të shtrembëruame bijën në "vesh" të Radio-Tiranës. Sikur të veproja kështu, nji punë e dillë do t'ishte e damshëme për mue, për punën e Shtëpisë së Kulturës dhe për punën kulturale në rrethin ku punoj unë. Veprime të tilla mue më duket se janë në kundërshtim me ato, që na tha shoqja Liri Belishova në konferencën e amatorëve dhe të lëvizjes amatore në rrethe. Nji amator i tillë më duket se jam edhe unë dhe kam qenë i mirë për Radio-Tiranën. Unë i kam dhanë Radio-Tiranës edhe shumë kangë të tjera të bukura, si Cuca katundare, Kanga e kurbetit etj. etj., që i kam mbledhë në popull nga pleq të vjetër dhe u kam ba ndonji rregullim të vogël si mbas nevojës. Këto nuk janë të mijat, janë me të vërtetë të popullit, sepse autori i tyne nuk dihet, mbasi janë shumë të vjetra. Por edhe këtu duhet të ruhet e drejta e mbledhësit, e atij, që i gjeti dhe i mblodhi për herë të parë.

Tani se deri në ç'pikë kam unë të drejtë le të vendosë ajo Ministri. Dëshira e ime asht që Radio-Tirana të ndalojë dhanëjen e kangës "Bulqizakeja" n'emisionet e saj për të dy incizimet, dhe të më njohë të drejtën e autorit për kangët origjinale të mijat dhe të mbledhësit për të tjerat. Në pastë mundësi lutem për nji përgjegje. Me nderime.

MYNIR SHEHU
Mësues Muzike në Shkollën Pedagogjike
"8 Nëntori", Peshkopi, më 20.I.1960





Faksimile e letrës së Munir Shehut, drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës.

Rruga e Arbërit nr. 162

***Profesor Karadaku*: Libri i zbut zemrat dhe i ndriçon shpirtërat njerëzorë.**

reportazh

Një natë poetike në Dibër të Madhe

Nga **OSMAN XHILI**

Është takimi i përvitshëm i klubit letrar "Dibra art", por këtë vit një jubile i veçantë i tij. Është 35 vjetori i formimit të këtij klubi letrar, që tashmë ka hyrë në histori dhe po bën histori. Kanë ardhur artistë nga Maqedonia e Veriut, nga Shqipëria dhe Kosova. Si zor të gjesh qytete të trevave shqiptare, që të mos kenë të paktën një përfaqësues në këtë tubim krijuesish e publicistësh. Të paktën Shkupi, Tirana dhe Prishtina i kishin përfaqësuesit aty.

Kryetari i klubit letrar, Nebi Samarxhiu dhe koordinatorët e kudogjendur Hysen Kosovrasti dhe Burhan Skikuli kishin bërë përgatitje maksimale, që mysafirët të ndiheshin sa më komodë dhe aktiviteti ti kapte kulmet e pritshmërisë. Nuk u habitëm shumë dhe nuk ishte befasi për ne. Dibra e Madhe është mësuar me kongrese, me takime historike kombëtare, ku janë marrë vendime të mëdha në të mirë të kombit dhe ja tek jemi këtu në vazhdën e tyre.

Takimin e përshëndeti kryetari i komunës së Dibrës së Madhe, Hekuran Duka, që kishte lënë angazhimet e shumta, për të nderuar miqtë. Ai u shpreh se ishte një mik i librit dhe i letërsisë, ashtu si dikur babai i tij dhe do të ndihmonte maksimalisht krijuesit letrarë.

Merrte pjesë në këtë takim Kalosh Çeliku, kryetar i lidhjes së shkrimtarëve të Maqedonisë së Veriut, autor i shumë librave dhe fitues i disa çmimeve letrarë.

DIBRAN FYLLI, ARTISTI NGA DRENICA

Një sallë komode në pallatin e Kulturës ishte për këtë veprimtari. U mbajt fjala hyrëse nga kryetari, u bënë dhe përshëndetjet e rastit. Sakaq, diku nga mesi i njerëzve u shkëput një burrë trupgjatë e me mjekër të dendur. Pa u prezantuar fare, ai filloi të recitojë një poezi, një baladë që titullohej "Amanetet e kullës së lashtë".

Mu duk se ai ishte një kreshnik i malësisë, që këndonte eposin e dikurshëm, që lëshonte kushtrim e kërkonte besëlidhje. "Kokën leje peng e tokën kurrë mos e shit!" - ishte një varg nga balada e kullës së lashtë. Amanet i kullës së lashtë, amanet i të parëve, amanet i trimave që dhanë jetën për liri. Përmbajtja e baladës dhe deklamimi plot finesë i artistit me ngjethën mishin për një moment. Kujtoja heronjtë e dikurshëm që nuk tuteshin nga vdekja dhe i ballafaqoja me politikanët e paskrupullt të kohëve moderne, që tradhtuan amanetet e kullës së lashtë.

Pak orë më vonë, kur po darkonim në mjediset e rregulluara bukur të hotel Venecit, u njoha me të . Quhej Dibran Fylli dhe ishte nga Drenica e Kosovës. Kishte studiuar në Akademinë e Arteve të Bukura në Lubjanë dhe kishte luajtur në 87 role të ndryshme në teatër e në film. Kishte qenë anëtar i U.Ç.K-së që në formimin e celulave të para. Ishte plagosur tre herë dhe më shtroi pak vendin e plagës së tretë.

Herën e fundit kishte mbuluar me trupin e tij, trupin e shokut që po rrezikohej fatalisht. Një pjesë e roleve të tija ishin luajtur më parë në skenën e luftës me bomba, granata e fishekë realë e më pas në skenën e teatrit. Ata mbanin akoma aromën e barotit, aromën e vërtetësisë.

KONKURSI "AQIF BEGU"

Nebi Samarxhiu, kryetari i klubit letrar të Dibrës, na tregoi për një projekt, që tashmë kishte marrë udhë. Aqif Begu ka qenë një intelektual i shquar i Dibrës, ekonomist me profesion, por me dashuri e pasion për letërsinë. Ka pak vite, që ai ka ndërruar jetë. Në përvjetorin e parë të vdekjes, e shoqja e tij, Flora Brovina, një veprimtare e shquar e politikës dhe e gruas në mënyrë të veçantë, u shpreh se për të nderuar kujtimin e të shoqit, familja e saj do të inicionte e do të financonte një konkurs për krijuesit e rinj në letërsi. Kështu lindi e vazhdon konkursi "Aqif Begu". Mbi 20 –25 konkurrentë marrin pjesë çdo vit nga gjimnazi dhe shkollat



nëntëvjeçare të këtij qyteti. Të gjitha janë punë cilësore dhe është shumë e vështirë të përcaktosh fituesit.

Në takim u shpallën dhe tre fituesit e vendeve të para dhe që të treja ishin vajza. Juria nderoi me vendin e parë poeteshën e re Arba Qoku, për poezinë me titull "Vështirësitë e jetës". Vendin e dytë e fitoi poezia me titull "Varka ime" dhe të tretin një poezi që i kushtohej nënës. Për fituesit kishte dhe vlera monetare, që do të jepeshin në ditët në vazhdim, duke organizuar takime në shkollat përkatëse.

PËRSHËNDETJE KRIJUESISH

Në takime të tilla thyhen kornizat e protokollet zyrtare. Dikush nga të ftuarit falënderon organizatorët, të tjerë dëshirojnë të recitojnë me ndjenjë e finesë ndonjë poezi të shkurtër të tyre. Disa janë të rinj e të reja si vajzat fituese që përmendëm më parë. Të tjera vajza të talentuara si Arbëresha Turkeshi dhe Rudina Batku, i takojnë një plejade me pak më shumë vite mbi supe. Ka dhe të tjerë që kanë mbi shtatëdhjetë vite mbi supe e sërish vijnë si zogjtë shtegëtarë, sapo dëgjojnë për vargun, poezinë dhe artin. Vitet i kanë lodhur trupat e tyre, dikush mban një shkop e një tjetër ndoshta dhe patericë, por shpirtin dhe mendjen i kanë të freskëta. Mustafa Spahiu dhe Rrahim Ganiu ka qenë për mbi tridhjetë vite në radion e Shkupit, me lajme dhe emisione të ndryshme për fëmijë e të rritur. Kanë shkruar e botuar shumë libra me poezi e sërish kanë plot të tjerë, që i nxjerrin me kujdes nga sirtaret e kujtesës për lexuesit e shumtë.

Aty, përballë, në tavolinën që shërben si një presidium, është ulur një burrë i fisëm dhe ky me mbi shtatëdhjetë vite mbi supe. Është Alush Kamberi nga Tetova, por që gjithë jetën e tij ja kushtoi emisioneve televizive në T.V Shkupi. Shokët e tij e quajnë si gazetarin legjendë të kohrave. Nuk ka etni shqiptare kudo në botë dhe ai të mos e ketë shkelur e të mos ketë bërë një dokumentar. Ka shkruar poezi, prozë, roman, kurse për Dibrën ka shkruar një reportazh me titull "Një zemër e ndarë".

Të tjera përshëndetje nga anë të ndryshme



të trojeve shqiptare. Profesor Astrit Gjunkshi, rrënjët e hershme i ka këtu, në Dibër të Madhe, është lindur në Peshkopi e tani banon në Tiranë. Ka studiuar për matematikë, më vonë për politikë, duke shkuar deri në sferat e larta të saj dhe tani ka gjetur prehje me krijimet poetike, duke botuar pesë libra të tillë deri tani. Shkrimtari tjetër me mbi tridhjetë libra të botuara, Shefki Karadaku, ka ardhur nga Tirana, në përgjigje të ftesës. Ai i përgëzon organizatorët dhe do të donte që kjo atmosferë e bukur për librin të ishte dhe në Tiranë, apo në Elbasan, qytetin e tij të lindjes. Libri,

Si klub letrar po punojnë për një almanak vjetor me punimet më të mira dhe do të përpiqen të ndihmojnë dhe financiarisht botimet e anëtarëve të klubit letrar. Po punojnë me nxënësit e shkollave nëntëvjeçare dhe gjimnazin, duke i parë ato si një fidanishte që prodhon vazhdimisht talente.

thotë profesor Karadaku, i zbut zemrat dhe i ndriçon shpirtërat njerëzorë.

***

Pas një darke bujare e një hallve tradicionale dibrane, pushuam disa orë të natës në mjediset e bukura të hotel "Venecit". Familja Capa kishte ditur t'ja kthejë shkëlqimin e dikurshëm këtij hoteli. Në mëngjes një kafe, një ushqim i ngrohtë dhe një bisedë e tillë mes krijuesish. Nuk e kuptonim se si në ato pak orë qëndrimi bashkë, ishim bërë shumë miq e nuk donim të shqiteshim. Shkëmbyem telefona, adresat dhe ndonjë libër që kishim marrë me vete dhe u ngushëlluam se do të takohemi sërish në evente të ndryshme. Ndoshta, shumë shpejt do të ftoj një pjesë prej tyre në promovimin e librit tim të ri "Tulipanët e bujqësisë dibrane", që është në botim.

E pyesim dhe njëherë kryetar Nebiun për projektet e së ardhmes dhe ai shprehet optimist, se arti dhe letërsia do të mbushin sadopak boshllëkun që koha le ndonjëherë. Si klub letrar po punojnë për një almanak vjetor me punimet më të mira dhe do të përpiqen të ndihmojnë dhe financiarisht botimet e anëtarëve të klubit letrar. Po punojnë me nxënësit e shkollave nëntëvjeçare dhe gjimnazin, duke i parë ato si një fidanishte që prodhon vazhdimisht talente. Specifikisht do të shtojnë përpjekjet për lidhje të reja me gjysmën tjetër të Dibrës, duke shpresuar se rruga e Arbrit do të jetë një lidhje fizike dhe shpirtërore për shqiptarët në të dy anët e kufirit.

Gazeta "Rruga e Arbërit"
Aty ku fjalët nuk i merr era...
Bëj një abonim online ose në print...
Kushton vetëm 600 lekë në vit...
email: rrugaearberit@gmail.com

profil

Tri vajzat dibrane që po shkëlqejnë
me ekipet e moshave të Lionit

Talentet që "shpëtuan" nga riatdhesimi familjen Tonuzi

Nga **OSMAN XHILI**

FAMILJA TONUZI

Olsi Tonuzi, vjen nga një fis jo pak i dëgjuar në Allajbegi. Ndoshta atëherë kur jo vetëm fshati, por dhe Dibra i kishte me pikatore njerëzit që dinin shkrim e këndim, ky fis kishte nxjerrë njerëz të shquar, që kishin mbaruar akademinë ushtarake në Itali, Spanjë, apo diku tjetër. Të ditur, krenarë e nacionalistë deri në fund, ata nuk mund të bashkëjetonin me sistemin e ri komunist, që u instalua në Shqipëri. Një valë kërcënimesh, presionesh, goditjesh, pse jo dhe eliminimesh fizike filluan të shfaqen në sfond, për ta zhdukur që në rrënjë këtë fis me vlera. Shumica e tyre u larguan. Në Jugosllavinë e dikurshme, në Belgjikë, në Francë e në Amerikë. Ata mbijetuan, hodhën rrënjë e u shumuan, duke e përcjellë stafetën e punës dhe të diturisë, nga njeri brez te tjetri. Bota i donte dhe i do njerëzit e ditur, Shqipëria jo. Shehat Tonuzi, Abazi, Hajdari, Ganiu, plot vëllezër e kushërinj me njëri-tjetrin, nderuan veten, fisin, fshatin, por dhe më shumë akoma. Sapo u hap demokracia, ata erdhën në Shqipëri, u çmallën me tokën ku kishin lindur dhe rindërtuan një pjesë të xhamisë 500 vjeçare të Allajbegisë.

OLSI, PROVA E DASHURISË SË MADHE

Vetëm dy shtëpi mbetën në fshat prej tyre, Feriti dhe Izeti. Feriti bëri dhe shumë vite burgim politik dhe u kthye në familje në një moshë gati të thyer. Të paktë në numër, të lodhur, vazhdimisht të kërcënuar, të burgosur, ata mbijetuan deri në kufijtë e viteve nëntëdhjetë. Hulsi Tonuzi, më i vogli i djemve të Izetit, mbaroi shkollimin e lartë dhe filloi punë për disa vite si mësues. Por nuk qe e thënë që gjërat të shkonin sikur ëndërronte djaloshi i ri. Këmbët filluan ti enjten dhe shëndeti ti rrezikohej. Bëhej fjalë për një sëmundje të veshkave, që asokohe vetëm pak njihej e vështirë se mund të kurohej. U vizitua nëpër spitale dhe mjekët i thanë se vetëm pak ditë jetë kishte. Pasi u mjekua pak kohë në Tiranë, u nis për në Greqi. Dhe orët tashmë ishin të shtrenjta, jo më ditët e javët. I thanë se duhej bërë detyrimisht një transplant i veshkës. Babai e nëna e tij, xha Izeti me të shoqen, afruan trupat e tyre për të dhuruar njërën veshkë. E kush do të vraponte më shumë se ata, në këtë betejë me vdekjen të djalit të tyre? U afrua dhe një shok i ngushtë i tij, Eduart Rama. Do ti jepte një veshkë të tij, thjeshtë dhuratë, pa asnjë lloj interesi e përfitimi. Por rregulli mjekësor e donte që dhuruesi të ishte mbi 30 vjeç dhe ai u refuzua. Analizat e mëtejshme zbuluan se veshka e nënës ngjante me të djalit në masën 70 %, kurse e babait vetëm 30 %, kështuqë u zgjodh varianti i parë. Olsi kujton momente prekëse, tronditëse, kur nëna u afrua të hiqte veshkën. Para se të kryhej operacioni i nënës, ajo iu drejtua kirurgut grek: – Dëgjo, doktor! Ta heqësh veshkën time, atë më të mirën. Nëse nuk bën punë ajo, hiqe dhe tjetrën e provoje! Nuk ka problem për mua, nëse vdes, vetëm djali të bëhet më mirë e të jetojë. Fjalët ishin në shqip e doktori grek nuk kuptonte. Kur përkthyesi i tregoi kuptimin e tyre, doktori vuri duart në kokë, lotët i shpërthyen vetiu e kërkoi ndjesë, se për momentin ishte i pamundur nga emocionet, që i kishte dhuruar ajo grua burrneshë nga Shqipëria. Jo, në Greqi për njërën veshkë dhe do të mendoheshin, për të dyja, as që bëhej fjalë. As greku, as shumë të tjerë nuk e dinin se ajo ishte nga fisi i Ndreut, të shquar për trimëri, besë e dituri. Tashmë ajo nuk jeton më, por ajo jeton në gjakun e trupin e të birit, në kujtimet tona dhe Zoti ta ketë çuar në parajsë. Vetëm pas një ore kirurgu grek e mori veten dhe e kaloi me sukses veshkën e nënës në trupin e djalit. Shumë shokë e miq të Hulsiut, që kishin ardhur enkas për të nga shumë qytete të Greqisë shpërthyen në brohorima, për një jetë të fituar. Zoti ia kishte falur jetën, ndoshta për hir të prindërve, që aq shumë ishin përpjekur e stresuar, ndoshta për hir të nuses së tij, që atëherë ishte shtatzënë me vajzën e parë dhe ajo të mos rritej jetime, apo për shumë gjëra të tjera sëbashku.



NGA ALLAJBEGIA NË FRANCË: VENDIME TË VËSHTIRA

Hulsiu kthehet në Shqipëri, në vendlindjen e tij, me një aktivitet pothuaj normal. Zgjidhet për një mandat dhe kryetar i këshillit në Allajbegi, fshatin e tij, duke u angazhuar maksimalisht në projekte për të mbështetur e zbukuruar atë fshat me kulturë e me histori të madhe. Në krye të disa viteve niset për të banuar në Tiranë. Sëmundja që do ishte gjithnjë prezente, ishte një arsye më shumë. Më pranë spitaleve të mëdha do të ndjehej pak më i sigurtë në vizitat dhe analizat e shpeshta që do të bënte më vonë. Familja e tij tani ishte shtuar ndjeshëm. Kishte lindur vajza e parë, Marsida dhe tre të tjera më pas, Hidia, Daniela dhe Njovi, më e vogla. Po rriteshin, ashtu pak nga pak, duke belbëzuar, duke hedhur hapat e para, duke recituar vjersha fëminore e duke shtuar gëzimin në familje. Por krahas vështirësive, shpesh dhe ekonomike, sëmundja nuk e linte të qetë.

Një ditë, krejt rastësisht, teksa bisedonte me një mik të tij, ndodhet pranë dhe profesor Lekë Dodani. Ai që kishte shërbyer vite e vite si mësues në Shqipërinë e veriut, ai njeri që ishte gatuar me mëshirën dhe nacionalizmin, u prek. – Ti djalë, i tha Olsit, duhet të shkosh dhe do të shkosh në Francë. - Atje do të kesh trajtim më të mirë mjekësor dhe të ardhme për familjen tënde. Hulsiu uli kokën mendueshëm. Shumë e madhe ishte oferta për ta besuar. Si do të shkonte? Ku do ti gjente paratë? Kush do ta priste atje? Këto e një sërë pyetjesh të tjera u ngritën në mendjen e tij, pa mundur dot të marrin përgjigje. Olsi ishte rrahur shumë me jetën. Kishte takuar në këtë lumë njerëzor që rridhte pa pushim njerëz të mirë e të këqinj. Po ky, ky profesori, që po i afron magjitë e Francës a është një shenjt, apo një mashtrues? Do të donte të besonte të parën, por vetëm Zoti e dinte të vërtetën. Koha do ta tregonte më vonë.

Ishte mbrëmja e po asaj dite, kur një zile telefoni e shkëputi për pak. Emri i profesor Lekë Dodanit në ekran. – Olsi, e diskutova dhe njëherë atë problemin dhe gati janë gjërat. Do ta kesh ndihmën time deri në fund.

Atë natë Olsi diskutoi gjatë me familjen, të nisej apo jo, një nga vendimet më të vështira që ishin diskutuar në familjen e tij.

Pak ditë më vonë gjendej në aeroportin e Rinasit, me bileta të prera. Katër vajzat, nëna e tyre dhe ai, gjashtë veta gjithsej. Ç'farë surprizash i prisnin në tokën e huaj? Në fund të fundit, le ta provonte njëherë fatin. Ai nuk ishte Tonuzi i parë që do të shkelte në tokën franceze. Mbi gjysëm shekulli para tij kishin studiuar e punuar në Francë dy xhaxhallarë të tij, dy intelektualë të shquar, Bajram dhe Hajdar Tonuzi. Ktheu kokën pas në shenjë lamtumire për vendin e tij, që dhe pse nuk kishte bërë shumë për të, do ta donte e do ta mbante në zemër përherë.

FUTBOLLI "SHPËTOI" FAMILJEN TONUZI

Kaluan gjashtë muaj në azil, në Francë. Peshorja e fatit të familjes Tonuzi akoma lëkundej mes po-së dhe jo-së, mes pozitives e negatives, mes qëndrimit në Francë dhe largimit prej saj. Largimi prej saj tingëllonte gati si një vetvrasje. Ndërkohë vajzat ishin adaptuar më shpejt në shtetin e ri. Kishin mësuar perfekt gjuhën franceze, ishin regjistruar në klube të ndryshme sporti dhe pse jo kishin bërë dhe emër në aq pak kohë.

Por të gjitha këto nuk kishin qenë të mjafta për një përgjigje pozitive. Familja Tonuzi duhej të kthehej përfundimisht në atdheun e saj, bile në fare pak ditë, pas të cilave ajo mund të ndiqej dhe penalisht. Një dramë e re për familjen. Miq e dashamirës u mblodhën në shërbim të tyre. Miqtë francezë Zhani, Odetta, Zhan Poli, Mari Poli dhe shumë të tjerë u bënë mbështetje e fortë për familjen, që i rrezikohej qëndrimi. Dashamirës të tjerë erdhën në ndihmë të familjes Tonuzi. Trajneri i ekipit të futbollit të qytetit do të deklaronte se Daniela Tonuzi, vajza e tretë e familjes, është kapitene e ekipit dhe Franca nuk duhet të humbasë talente të tillë.

Duke kujtuar ato ditë të vështira, Olsi thotë se u hodh në gjyq prefektura dhe pas 13 ditësh i thirrën në Lion, ku shkoi e shoqja e tij dhe njëra nga vajzat. Gjyqtari, pasi u njoh me gjithë dosjen, sjelljen e familjes Tonuzi, talentet që ajo kishte, i tha Elidës, gruas së tij: Të jeni krenarë për këto fëmijë që keni. Qëndrimin në Francë e keni prej tyre.

MARSIDA, DANIELA DHE NJOVI, VAJZAT E TALENTUARA FUTBOLLISTE

Ato, që të katërta janë njëra më e talentuar se tjetra. Ajo që kanë të përbashkët janë katër gjuhët e huaja që i flasin rrjedhshëm, dashuria për librat dhe të qenurit nxënëse modele në sjellje dhe në mësime.

Marsida është më e madhja. Ka fituar për inxhinieri farmaceutike dhe është në vitin e dytë. Futbolli, karateja dhe baleti janë pjesë e aktivitetit të saj të përditshëm. Vajza e dytë Hidia është po kaq e talentuar në mësime, por dhe në sporte. Këtë vit shkon në shkollën e lartë dhe mes shumë degëve të preferuara mendon të zgjedhë arkitekturën. Daniela ka një lidhje akoma më të fuqishme me futbollin. Që e vogël, kur ishte në Tiranë, luante me skuadrën e djemve të moshës, meqë nuk kishte klasa futbolli për vajza. Ishte java e parë e qëndrimit në Francë, kur ajo u paraqit pranë klubit të futbollit, me shpresën e inkuadrimit pranë tij. Me pak gjeste, me pak shprehje të anglishtes, vajza i tregoi qëllimin e ardhjes. Trainerja e futi mes vajzave që luanin.

Teknika, forca, shkathtësia e Danielës ranë përnjëherë në sy. Kur vajza goditi një top gati nga mesi i fushës dhe e ktheu në gol, trainerja nuk u përmbajt më. E përqafoi Danielën dhe i tha, që ti tani je vajza ime. Kanë kaluar tre vjet që atëherë. Daniela është rritur në moshë, është rritur në popullaritet. Tre vjet rresht është shpallur sportistja më e mirë e qytetit. Sot, ajo është 15 vjeç, por luan me 21 vjeçaret dhe për më tepër mban dhe shiritin e kapitenes së ekipit të qytetit. Ndoshta, shumë shpejt do të jetë dhe kapitenia e ekipit kombëtar francez të futbollit për vajza.

Njovi është më e vogla e familjes Tonuzi, por po kaq e talentuar sa dhe motrat. Nuk e dimë pse kaq shumë e paskan talent futbollin. Ndoshta nga babai, Olsi, që në rininë e tij luajti pak kohë me Korabin, por pasi theu kaviljen nuk u mor më me sportin. Trajneri i Njovit e provoi vajzën në disa pozicione dhe tashmë e ka fiksuar atë në mbrojtje të portës. Është vetëm 13 vjeç dhe premton shumë në të ardhmen, ashtu si motra e saj, Daniela, që ka bërë shumë emër. Familja Tonuzi po bën çdo ditë hapin e radhës në ngritjen e identitetit të saj. Ajo përkulet me nderim e respekt ndaj atyre që e ngritën deri në këtë shkallë dhe i kthyen buzëqeshjen.





Promovimi, me datë 10 nëntor 2019
0ra 10.00 në sallën e Muzeut Historik Kombëtar

Skënder Cala, "Mjeshtër i Madh", në gjerdanin e artë të kulturës kombëtare

Nga **SAKIP CAMI**

Për artistin e mirënjohur Skënder Cala, regjizor, këngëtar, aktor , që ka interpretuar përkrah të mëdhenjve Sandër Prosi, Marie Logoreci, Stavri Shkurti, Rajmonda Bulku, etj, në filmat e ish-Kinostudio "Shqiperia e Re", "Skënderbeu", "Çeta e Vogël", "Bardhësi", "Përballimi", "Kërcënimi", etj., që ka themeluar Teatrin Profesionist të Peshkopisë ku ka vënë me sukses dhjetra premiera si regjisor dhe akto), në kuadrin e 80-vjetorit të lindjes , autori Halil Rama ka shkruar librin monografik me titull: "Skënder Cala, "Mjeshtër i Madh", në gjerdanin e artë të kulturës kombëtare", botim i Shtëpisë Botuese M & B.


Me këtë rast shfaqet edhe dokumentari me të njejtin titull i autorit Halil Rama. Ky eveniment organizohet nga Shoqata "Bashkësia Dibrane" dhe Shtëpia Botuese "M& B", ditën e diel me datë 10 Nëntor, ora 11.00 në Muzeun Historik Kombëtar.

Presidenti i Republikës Bujar Nishani, në ditën e dekorimit të Skënderit, ndërsa po i dorzonte dekoratën e lartë të "Mjeshtrit të Madh" ju drejtua atij:

Zoti Cala! Aftësitë tuaja artistike dhe jo vetëm, por edhe ato njerëzore, janë shijuar edhe vlerësuar si brenda edhe jashtë vendit. Dashuria juaj e madhe ndaj artit ka mundur ti tejkalojë të gjitha vështirësitë dhe ta përhapë këtë pasion gjerësisht, duke kontribuar në organizimin e jetës artistike të rrethit të Dibrës si regjisor, këngëtar, prezantues, publicist dhe në krijimin e koncerteve të ndryshme.

Ju keni dhënë nga vetja juaj gjithçka mundet të japë një artist: kohën, mundin përkushtimin, pasionin, talentin për të mundësuar kënaqësinë e artit të vërtetë si dhe për të bërë të mundur që kjo formë e të shprehurit artistik të mund të shijohet

Bujar Nishani: Aftësitë tuaja artistike dhe jo vetëm, por edhe ato njerëzore, janë shijuar edhe vlerësuar si brenda edhe jashtë vendit. Ju keni dhënë nga vetja juaj gjithçka mundet të japë një artist: kohën, mundin përkushtimin, pasionin, talentin për të mundësuar kënaqësinë e artit të vërtetë... Ai mbi të gjitha kontribuoj në zbulimin e artistëve të rinj, i cili i përgatiti duke ju dhënë shumë nga vetja e tij, në mënyrë që ato të ishin të përgatitur për të konkuruar në skenën e artit shqiptar por edhe më gjerë. Dhe sot ata, duke ecur në hapat e mjeshtrit të tyre, profesorit të tyre kanë një emër në jetën artistike si brenda ashtu edhe jashtë vendit.



Ftesë

Te nderuar miq,

Artisti dibran SKENDER CALA, regjisor, këngëtar, aktor (që ka interpretuar përkrah të mëdhenjve Sandër Prosi, Marie Logoreci, Stavri Shkurti, Rajmonda Bulku, etj, në filmat e ish-Kinostudio 'Shqiperia e Re', "Skënderbeu", "Çeta e Vogël", "Bardhësi", "Përballimi", "Kërcënimi", etj – që ka themeluar Teatrin Profesionist të Peshkopisë ku ka vënë me sukses dhjetra premiera si regjisor dhe aktor), feston 80-vjetorin e ditëlindjes.

Me këtë rast ju përcjellim lajmin e aktivitetit promovues të librit monografik me titull: "SKENDER CALA - "Mjeshtër i Madh' , në gjerdanin e artë të kulturës kombëtare", si dhe dokumentarit me të njejtin titull, të autorit Halil Rama, organizuar nga Shoqata "Bashkësia Dibrane" dhe Shtëpia Botuese "M&B" ditën e diel me date 10 Nëntor, ora 11.^{00} në Muzeun Historik Kombëtar.

Jeni i ftuar të na nderoni me pjesëmarrjen tuaj.

Kryesia dhe "Këshilli i të Urtëve"
"Bashkësia dibrane"
Shtëpia Botuese "M&B"



Skënder Cala në filmin "Kërcënimi".

PREMIERAT E TEATRIT KU KA INTERPRETUAR SKENDER CALA

1-Flakë Kashte	-1969	19-Kështu të dua	-1982
2-Drita	-1969	20-Pas provimit	-1982
3-Rrënjët	-1971	21-Suksese nëpremierë	-1983
4-Cuca e Maleve	-1971	22-Përballë vehtes	-1984
5-Ai vdiq në këmbë	-1972	23-Moshë e ngarkuar me provime	-1984
6-Një dimër i shkurtër	-1972	24- Qyteti i akuzuar	-1985
7-Ethet e Olimpiadës	-1973	25- Pallati 176	-1986
8-Cifti i lumtur	-1974	26- Pranvera që s`vonoi	-1986
9-Gjëmimi i atij dimri	-1974	27- Ankohen personazhet	-1987
10-Përmbytja e Madhe	-1975	28- Nesër është vonë	-1989
11-Duke u gdhirë viti 45-së	-1975	29- Përshëndetje minatori	-1989.
12-Përse mendohen këto male	-1975	30-Bidermani dhe Zjarrvënësit	
13-Ah kjo traktoristja	-1976	31- Maturant	
14-Shpartallimi	-1976	32- Me fal baba	
15-Doktori pacient	-1979	33-Shënomeni dhe mua	
16-Shoku Niqifor	-1980	34-Hija e tjetrit	
17-Natë pa gjumë	-1981	35-Rri urtë Kristofor !	
18-Tokë e ndezur	-1981	36- Marrëzia e Madhështisë	

dhe të ndikojë te jeta sociale e gjithkujt.

Vlerat e Skënder Calës shkojnë përtej kontributit të artit shqiptar. Ai mbi të gjitha kontribuoj në zbulimin e artistëve të rinj, i cili i përgatiti duke ju dhënë shumë nga vetja e tij, në mënyrë që ato të ishin të përgatitur për të konkuruar në skenën e artit shqiptar por edhe më gjerë. Dhe sot ata, duke ecur në hapat e mjeshtrit të tyre, profesorit të tyre kanë një emër në jetën artistike si brenda ashtu edhe jashtë vendit."

Impresionet e tij për Dibrën dhe për jetën artistike të tij Skënderi i ka shpalosur në librin "Magjia e Dibrës".

-Në listën e mëposhtme nuk renditen mbi 100 premiera të estradës profesioniste të regjisorëve Tef Krroqi e Inajet Shehu nga të cilët 20 premiera janë me regjinë e S.Calës. Jashtë kësaj liste janë edhe mbi 50 premiera të lëvizjes amatore të qytetit dhe fshatit. Shfaqjet plot humor e ngjyra të tyre gjallëronin në ato vite jetën e një qyteti dhe të një rrethi të varfër në pasuri por të madh në shpirtin e tij artistik e njerëzor.

Mjeshtri i madh Bujar Kapexhiu shkruan për Skënderin: "Mund të shkruaj shumë faqe për Skënderin. Ndoshta më tepër se cilido tjetër mik apo i afërm i tij, sepse ka lënë shumë mbresa në jetën time studentore, si i rrallë e i veçantë në grumbullin e sa e sa studentëve.

Duke e çmuar për vlerat si njeri e artist që ka zënë një vend të sigurt në krye të listës së miqve të mi më të mirë. Si njeri me karakter të fortë, të paepur, që nuk lëviz për asnjë çast nga kreu i listës. E them këtë se në jetë shumë shokë, të njohur, familjarë e farefis, në pistën e vrapimit miqësor, në pistën e jetës e të miqësisë, herë të afrohen e herë të largohen. Ka nga ata që largohen edhe nga pista, e braktisin vrapin miqësor, humbasin e harrohen gjatë rrugës, ashtu siç ka edhe ndonjë që të afrohet, e do të të vërë stërkëmbësin për të të rrëzuar. Skënderi ka vrapuar gjithmonë në krah, pranë meje, në këtë vrapim të përbashkët në të njëjtën korsi, në pistën pa fund të stadiumit të artit."

Dhe me këtë vlerësim të mjeshtrit për mjeshtrin po e mbyll këtë ftesë për promovim, këtë ftesë për ta patur dhe për ta lexuar këtë libër për një vlerë të paçmuar të artit tonë shqiptar.

libri i ri

"Zonja asnjeri dhe zoti askurrkush" shpreh pamundësinë për të asimiluar përvojat tona

Poeti Agron Tufa vjen në këtë vjeshtë me vëllimin e ri poetik "Zonja asnjeri dhe zoti askurrkush". Për të folur rreth këtij libri, ai është ftuar në disa studio dhe emisione letrare, ndërsa ne për lexuesin e gazetës kemi zgjedhur të botojmë intervistën e tij në emisionin e mëngjesit në Top Channel. -Redaksia

AGRON TUFA: Procesi i krijimit është i thjeshtë: shkarkon energji nga vetja jote dhe e ekspozon. Libri poetik është akumulimi i kësaj energjie artistike. Imazhet, metaforat dhe mishërimi i ideve me një veshje të tillë ligjërimore përbëjnë poezinë. Ajo ka jetën e vet të pavarur, të cilës ti nuk i ndërhyn pas botimit të librit. Dhe ajo jetë e pavarur e librit është tashmë (gjendet) tek lexuesit. Çdo lexues për fat të mirë përfaqëson relacionin e vet, me librin, prandaj dhe ka shumë lexime. Me poezitë e mira ka vetëm fillim komunikimi, është ashtu siç marrëdhënia me një pikturë dhe nuk mund të thuash për një libër me poezi "e kam lexuar", siç mund ta themi këtë për një tregim apo roman. Me poezinë ndërton relacione të ndryshme, kemi zhvendosje ose shtegtime diskursive. E lexon në fillim, siç kemi poetët e mirë qoftë edhe të traditës sonë, le të themi Mjedën, Lasgushin, etj. Ne zbulojmë gjithmonë raportet tona të tjera me poezinë, raporte gjithëherë të reja në çdo akt leximi. Nëse poezia zotëron njëfarë misteri apo enigme, lexuesin e mban mbërthyer, e bën bashkautor, përderisa lexuesi vetëm se i afrohet misterit, pa e deshifruar atë deri në fund. Kjo është gjendja më e shëndetshme e marrëdhënieve të një lexuesi të kultivuar ndaj një poezie të mirë.

Lirika ime është një prirje, që në fillim, që në librin e parë "Aty te portat Skée" (Onufri, 1996) - një prirje për një lirikë filozofike, lirike meditave, diskursive; një lirikë që nuk ngazëllehet nga momenti, nga një pamje, d.m.th., nuk shkruhet nga ato lloj impresionesh të çastit, por është padyshim një trajektore meditave me raportet, fenomenet, gjësendet... është diskursive dhe "Zonja asnjeri dhe zoti askurrkush" siç e ilustrojnë një varg poezish në libër, shpreh pamundësinë për të asimiluar përvojat tona. Mos asimilimi i këtyre përvojave, ajo që na bën ne të kemi një identitet (sepse identiteti na mban në kornizë), na hedh në erë, na shpërfytyron, na bën që të mos dimë se kush jemi. D.m.th. identiteti ynë është si puna e nivelës, që i ka shkarë flluska nga qendra, na bën të jemi njerëz pa fytyrë. Kjo ka lidhje me kujtesën, kjo ka lidhje me identitetin dhe ka lidhje dhe me idealet, dobitë tona. Por nëse i heqim të gjithë këto..... Shpesh ne themi si nuk zumë mend, si nuk mësuam nga historia, por zhdukja e kësaj përvoje na bën tabula rasa.

Është reale, që çdokush që gjendet në atë rreth adresatësh, ushqen një specifikë të caktuar poezie. Poezia nuk është letërsi e drejtëpërsëdrejti për një person, madje edhe në rastin kur ne adresojmë poezinë. Një person bëhet shkak për meditimin dhe për një ndjeshmëri që shtjellohet, në përputhje me domethënien që ka ky person në jetën tënde. Madje edhe lirikën e dashurisë kur ia adresojmë një personi, ne kemi parasysh diçka shumë më të gjerë, pa u kufizuar me personin vetë. Pra, kemi parasysh një koncept shumë më të gjerë.


> Libri poetik është akumulimi i kësaj energjie artistike. Imazhet, metaforat dhe mishërimi i ideve me një veshje të tillë ligjërimore përbëjnë poezinë. Ajo ka jetën e vet të pavarur, të cilës ti nuk i ndërhyn pas botimit të librit. Dhe ajo jetë e pavarur e librit është tashmë (gjendet) tek lexuesit. Çdo lexues për fat të mirë përfaqëson relacionin e vet, me librin, prandaj dhe ka shumë lexime

Vëllimi poetik është një arkitekturë e mirëmenduar, i cili, e cila nuk kushtëzohet nga poezitë e fundit që ti ke shkruar, as për poezitë e 2-3 vitet të fundit, ndonëse pjesa më e madhe e tyre përfshihen në vëllimin ri. Çdo poezi zgjidhet e mund të përfshihet si element arkitekturor, që ta durojë arkitektura e vëllimeve, ndryshe del pak jashtë strukturës. Kështu që shumë poezi gjykohen nga vendi që zënë ato në çdo libër. Në vëllimin e ri gjejmë poezi të hershme dhe poezi fare të vona, por mjaft poezi të vona nuk janë përfshirë, për shkak se dhe nuk rrinë mirë në arkitekturën e vëllimit. Poezitë janë si gurët në mur. Nëse nuk harmonizojnë strukturën, ato të prishin atë fasadë që ti ke në kokë. Ka poezi të hershme që, përsëri, vazhdimisht, janë marrë në çdo vëllim, sepse në librat e mëparshëm nuk e kanë gjetur vendin në arkitekturat e vëllimeve. Poezia që keni zgjedhur ju për lexim është e hershme.

Është fillimi i vitit 1990, d.m.th. është koha më e hershme, kur unë e kisha marrë tepër seriozisht artin e poezisë. Sikur të gjithë shqisat e tjera mos të ekzistonin, vetëm dëgjimi, identifikimi i saktë i çdo poezie me një rrethanë të caktuar do të ishte i menjëhershëm. D.m.th. si kjo poezi, që është shkruar në Shkodër, me që ra fjala. Unë isha në Shkodër në këtë kohë. Kuptohet, poezitë më të mira shkruhen në situata të ngarkuara pasioni. Pikërisht për këtë poezitë e dashurisë janë më të rrezikshme prandaj dhe marzhi i gabimit më të madh, janë lirikat e dashurisë. Sigurisht ka qenë një ndjenjë shumë e fortë për bazën e kësaj poezie. Poezitë e këtilla janë dhe kundërpërgjigja e çdo lloj ndjenje, e çdo lloj fuqie ose pafuqie. Kjo është poezia e krijimit. Pikëllimi, dëshpërimi ekstrem të çon në përjetim intensiv, të cilit s'ke me çfarë të përgjigjesh. Reagimi nuk dihet kur je i përfshirë, por nuk mund të reagosh ndryshe në situata pafuqie, përveçse me krijimin. Prandaj dhe lirikat e dashurisë janë prodhuar në të tilla gjendje ekstremi. Unë mendoj se poezia që lexuat nuk është as poezia më e mirë, as më e dobët. Unë mendoj që ajo përfaqëson mesataren e natyrshme të shkrimit tim të asaj kohe...

Kohë nuk ka, kam ëndërr që të kishte, por me kohë e kam kuptuar që kohë s'do të ketë më. Diçka duhet bërë, kështu që unë kam përshtatur mënyrën time të sjelljes, që ta ruaj motivin. Nëse nuk ia dal, nja 10 a 15 gjëra shkatërrohen në kokë. Mungesa e kohës më ka imponuar që të jem më shumë i vëmendshëm, d.m.th. si fillim me imazhin e parë, qoftë me një varg apo me dy vargje. Nëse kam fatin dhe nuk kam të papritura të pakëndshme (në përditshmërinë tonë ato i kemi gratis, nga mëngjesi deri në mbrëmje) atëherë gjej një moment të lirë të ditës dhe e shkruaj. Ka mundësi që motivi të mbijetojë deri në fund të ditës. Atëherë shkrimi ecshumë shpejt. Unë kohë nuk kam, axhendat janë shumë të ngjeshura. Me mbet e vetmja mënyrë që e ushtroj, të cilën e kam quajtur dhe dikur "penallti në ecje".

Vëllimi "Zonja asnjeri dhe zoti askurrkush" është ndarë në katër cikle, sipas këtij rendi: "Askush nuk e do mëkatin"; "Gardërobë gramatike (nokturne)"; "Gëzhoja të zbrazëta netësh" dhe "E dashura qau ndaj të gdhirë". Është vëllimi i shtatë me poezi (pa llogaritur përzgjedhjen "Fryma mbi ujëra", Fjala, 2007).




> Vëllimi "Zonja asnjeri dhe zoti askurrkush" është ndarë në katër cikle, sipas këtij rendi: "Askush nuk e do mëkatin"; "Gardërobë gramatike (nokturne)"; "Gëzhoja të zbrazëta netësh" dhe "E dashura qau ndaj të gdhirë". Është vëllimi i shtatë me poezi (pa llogaritur përzgjedhjen "Fryma mbi ujëra", Fjala, 2007).


Rruga e Arbërit nr. 162

BOTIME TË REJA NË PANAIRIN E LIBRIT

13-17 Nëntor 2019










































Më shumë botime me çmime të ulura nga 20-30%

BOTIMET M&B

Librat e Botimeve M&B Mund t'i porosisni edhe online përmes platformës

www.bukinist.al

cyan magenta yelloë black

printime dixhitale

me ngjyra dhe bardh e zi

shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme
libra | broshura | revista | fletëpalosje
katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.
duke filluar nga 1 kopje e vetme
për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603

Kërkohen korrespondentë në Peshkopi dhe Dibër të Madhe

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE.

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë.

Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing.

Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.


Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.




SHITET

1 200 m² katror sipërfaqe e përdorshme për biznes dhe banim.
300 m² lokal, bar kafe dhe restorant, i përshtatshëm për dasma, 100 m² kuzhina.
4 apartamente, me dy dhoma të mëdha gjumi dhe 2 të tjera me një dhomë.
Restoranti ka katër banjo moderne dhe një dhomë ndërrimi.
Lokali në katin e parë është 200 m² + magazinë, qilari është 30 m².
Bari - 30 m² brenda dhe 140 m² ambienti i jashtëm.

Për një vizitë në pronë, kontakto: ***068 65 08 441*** ***ramizgjini@yahoo.com***









www.rrugaearberit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: **info@rrugaearberit.com**

Informacioni për versionin e printuar: **rrugaearberit@gmail.com**

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Ëebsite është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

Mund të na ndiqni edhe në Facebook duke kërkuar me emrin "Rruga e Arbërit" ose përmes lidhjes:

https://tinyurl.com/lcc3e2f

Foto Majtas tregon pamjen e parë të faqes zyrtare në Facebook të gazetës *Rruga e Arbërit*

NE jemi gazetë e lirë dhe pavarësia dhe liria jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...

BËJ PAJTIMIN TËND!

Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: **600 lekë.** Në Europë: **10 Euro.** Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD**.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Dibrani që **desh të blinte** një kuintal me **gjilpëra!**

Në Shkodër ishte hapur fjala se në Dibër, një tregtar me emrin Perviz, ishte shumë i zoti. Thuhej se ai kishte pasuri të madhe, që askush nuk matej me të jo vetëm në Dibër, por edhe gjetkë. Mirëpo, kurioziteti dhe njëherazi zilia që përcillej nga lajme të tilla, e nxiti një nga tregtarët më me emër në Shkodër, që ta ftonte tregtarin dibran në qytetin e tij, për t'u njohur nga afër çfarë njeriu ishte ky Pervizi i shumëpërfolur. Ishte një ftesë sa për të shkuar radhën, se tregtari shkodran ishte më se i sigurt që Pervizit të Dibrës duhej t'i kish dalë nami kot. Ai nuk besonte se ndonjë tregtar gjetiu, e aq më tepër në Dibër, që sipas tij nuk krahasohej me Shkodrën për punë tregtie, të kish një tregtar më të zotin se ai.

Dhe një ditë Pervizi ia shaloi mushkës dhe mori rrugën për në Shkodër, i veshur me tirqe e xhamadan leshi dhe kapuç të bardhë mbi krye, siç visheshin dibranët zakonisht. Mbas nja 2-3 ditë rrugë, mbërrin tek ai që e kish ftuar. Tregtarit shkodran, qysh në paraqitjen e parë të Pervizit, nuk ia mbushi syrin për zotësinë e përfolur. I kish bërë përshtypje veç veshjes edhe shtati mesatar, që sipas shkodranit nuk binte shumë "era tregtar". Le pastaj të matej me atë që e kish ftuar. Dhe për këto arsye, nuk i kushtoi aq vëmendje. U duk një farë shpërfillje e tij për të. Megjithatë, për të mos ulur veten, tregtari shkodran filloi t'i fliste për pasurinë e tij, për llojshmërinë e mallrave, magazinat e shumta, famën e madhe që kish në Shkodër e gjetkë, etj.

-Nuk mungon asgjë në dyqanet e mia, - kish thënë ai. Edhe "qumësht dallëndysheje" gjendet te unë.

Dhe po i ndriste nuri, ngaqë i numëroi tërë ato pasuri që ai kish në Shkodër. Ishte një karshillëk i dukshëm që shkodrani po i bënte tregtarit dibran, ndërkohë që ky i fundit dëgjonte dhe rrinte si i hutuar. Të paktën, kështu ta jepte përshtypjen. Kjo i ra në sy edhe shkodranit , i cili për një çast mendoi se, "ky më duket se nuk marka vesh nga tregtia, si na qenka tregtari më i madh në Dibër...?!" Mbasi dëgjoi gjatë ato që i tregoi tregtari shkodran, më në fund Pervizi tha:

-Të lumtë! Qenke tregtar i zoti. Paske vërtetë shumë gjëra që unë nuk i kam. Por unë jam që jam këtu, desha të bëja një pazar tek ti...

-Urdhëro e fol! – i tha tregtari shkodran dhe u çel në fytyrë nga kënaqësia që më në fund tregtari dibran po e pranonte që nuk matej dot me të.

Ndonëse ende nuk e kish marrë vesh se për çfarë "pazari" e kish fjalën dibrani që do të bënte tek ai, ky fakt, sipas tregtarit shkodran, e bindi atë që nuk paskam gabuar kur kam menduar që dibranit i mungoka zotësia për t'u marrë me tregti...

-Me t'thanë të drejtën, - tha dibrani, - më duheshin një kuintal me gjilpëra, se kam kërkesa, por ky mall më mungon. Dhe meqë ti paske çdo gjë, m'i bëj gati gjilpërat t'i marr tani... Ndërkohë, futi dorën në xhepin e brendshëm të xhamadanit dhe nxori që andej një qese prej së cilës po numëronte monedhat e floririt.

-Çfarë...?! - tha tregtari shkodran. Dhe bëri sikur nuk e kish dëgjuar mirë kërkesën e dibranit, i cili ia përsëriti edhe një herë:

-Një kuintal me gjilpëra desha, për të cilat të paguaj tani në dorë.


-Ky mall nuk më ndodhet,- u përgjigj shkodrani. Por kërko diçka tjetër dhe me siguri e gjen.

Ndërkaq, shkodrani rrudhi buzët me këtë kërkesë të befasishme, mbas së cilës vuri në dyshim mendimet e tij të deriatëhershme për "pazotësinë" e dibranit. Ca më shumë ai shqeu sytë kur pa qesen me flori të tij dhe mërmëriti nëpër dhëmbë:

-Ku dreqin i vajti mëndja këtij fshatari të pagdhendur, që të më zinte ngushtë me atë punën e gjilpërave?! Po gjithë atë qese me flori, si e ka navasur ky njeri që nuk të jep përshtypjen për zotësi? Ndërkohë po priste prej dibranit të kërkonte ndonjë mall tjetër.

-Jo, jo,- tha Previzi,- këto më duheshin, po ti meqë nuk i paske, po largohem pa gjë...

Dhe ia hipi mushkës e doli nga Shkodra, krenar që ia kish hedhur shkodranit. Ndërsa tregtari shkodran mbeti kokëvarur dhe pa fjalë në atë çast.



NGJESH E QESH
Rrëfime me realitete dhe qesëndi
GËZIM VODA

Botimet M&B
ISBN 978-9928-307-06-4
Faqe: 312
Çmimi: 700 lekë

Poezia e Barie Çupit në vëllimin poetik "Vargonjtë e fatit"

KRONIKË

Tetori, muaji i letërsisë, u kujtua me aktivitete edhe në shkollën 9 vjeçare Shefqet Tançi në qytetin e Bulqizës, një nga shkollat me numër më të madh të nxënësve. Poetë nga Tirana si Kozeta Zavalani, Ilmi Dervishi, Anila Kodra iu bashkua dhe poetët bulqizakë Barie Çupi e Arben Alliu të cilët u priten në Bibliotekën e shkollës nga drejtori i shkollës zoti Gazmir Sejdi. Krijuesit dhuruan librat e tyre por edhe 200 libra të tjerë të dhuruar për këtë shkollë nga poeti dhe këngëtari Naim Berisha e Nexhi Baushi, e të tjerë.

Në ceremoninë e dhurimit të librave përshëndeti dhe falënderoi kryetari i Bashkisë Bulqizë zoti Lefter Alla, drejtori i shkollës zoti Gazmir Sejdi.

Më pas në hollin e shkollës u promovua libri "Vargonjtë e fatit" i poetes Barie Çupi, një herësh mësuese e gjuhës frënge po në këtë shkollë. Libri është botuar nga Shtëpia Botuese M&B dhe redaktor i saj është poeti Ilmi Dervishi.

Për poezinë dhe vlerat artistike, tematikën e këtij libri më gjerë foli mësuesja e letërsisë Nafije Jella. Me interes u prit dhe diskutimi i poetes Kozeta Zavalani si dhe i mësuesve Gazmir Sejdi, Sami Cara, Vjollca Gjimi.



VARGONJTË E FATIT
Poezi
BARIE ÇUPI

Botimet M&B
ISBN 978-9928-307-00-2
Faqe: 312 /Çmimi: 500 lekë



Nga **NAFIJE JELLA**

Duke lexuar poezitë e këtij vëllimi, gjen aty pjalmin poetik, ku fjala dhe vargu shpërthejnë fuqishëm bashke me ndjenjat e poetes.

Libri përbëhet nga 70 poezi, tematika dhe motivet janë kryesisht të planit shpirtëror, por ajo nuk le pa hedhur në vargje për vendlindjen, kujtimeve të fëmijërisë, qytetit minator, mallit për nënën si dhe tema sociale e shoqërore.

Titulli i librit është metaforik. Aty është rrëfim i vetë poetes në rrugëtimin e saj të përditshëm. Të kërkosh nëpër shpirt , të kërkosh brenda heshtjes dhe zërit tënd, t'i japësh jetë shpirt dhe zë poezisë në lidhjet e pazgjidhshme me të, do të thotë të japësh dhe të transmetosh dashuri në emër të jetës, përmes dallgëve, përjetimeve, tallazeve shpirtërore, brengave, maktheve

Në këtë vëllim poetik, Barie Çupi shpalos dhe transmeton vlerat dhe shpirtin e saj krijues, dimensionin femëror...

Fjala e saj ka hapësirë në poezi, ajo është dashuri, ajo e shenjtëron atë, e ruan si vlerë, në këto germa e fjalë, që janë aq të fuqishme, këput hallkat, fijet e dukshme dhe të padukshme të vargonjve të fatit jetësor. Ajo thyen heshtjen. Ajo është zëri plot dritë, energji dhe jetë një luftëtare e fjalës së lirë...

Me një energji të brendshme shpirtërore ajo shpërthen, mallkon tokën metaforikisht, njerëzit si bartës të së keqes, padrejtësive, gënjeshtrave , hipokrizisë, dyfytyrësisë. Ajo kërkon një botë që të triumfojë drejtësia, e mira e dinjiteti njerëzor, humanizmi, se vetëm dashuria mes njerëzve është ilaçi që rregullon botën në realitetin ku ne jetojmë sot.

Në disa poezi si "Rënie", "Radiografi në sy të njerëzisë" ajo gjen forcën e arsyes që të ngrejë zërin të godasë në emër të të qenurit nënë, grua, motër, shoqe, femër tek kjo plagë që kullon në trup të njerëzimit, dhuna ndaj femrës, një dimension i egër klithmës ndaj krijese më të mrekullueshme të gjithësisë...

Ajo i shkruan vendlindjes me të njëjtin mall që nuk i ndahet shpirti në gjithçka që ajo ka jetuar e përjetuar , por edhe përballë mentalitetit, egoizmit. E sheh veten ngushtësisht të lidhur me të, frymon me të dhe është bekimi i saj.

Malli dhe dashuria për nënën është e pashuar, është e shenjtë, ngren zemrën peshë.

Sado larg të jesh, ajo është dashuri mbi dashuritë, të shoqëron, kudo lëviz dhe shkon, është e vetmja qenie që të shpëton edhe në detin me dallgë...

Dashuria për poeten është një betejë në tërë qenien e saj si grua, si femër. Ajo e do atë të pastër, i qëndron besnike, ajo e gjeneron me forcën e shpirtit edhe kur ka dallgë edhe dhimbje brenda shpirtit të saj të trazuar e bën atë të bukur, të fuqishme.

Poezia e saj nuk i fsheh ndjenjat dhe emocionet, i shpreh bukur përmes përjetimit, bukurisë së shpirtit, madje edhe kur ka lot...

Loti, kjo ndjenjë e fuqishme si kristali! Sa mall, dashuri, ëndrra, lumturi, brenga, pengje, gëzime enden brenda tij, ku poetja e finalizon me mesazhin "se në çdo pikë loti do të thurë melodi, në atë lot ka dritë, ka jetë, ka shpresë ka gëzim".

Kopertina e librit e përçon dhe e përcakton më së miri në retinën e syve të dritës, ku ajo sheh qartë botën ku ecën duke sfiduar pengesat; se pa dashuri s'ka jetë.

Një pasuri tjetër e veçantë e këtij vëllimi është figurshmëria poetike, që është mjaft e pasur në universin e poezisë së saj, ku dominojnë figurat e kuptimit dhe të shprehjes, si metafora, metonimia, antiteza, krahasimi, anafora, përsëritja, enumeracioni e të tjera figura që i japin kolorit vargut të saj.

(Botohet me shkurtime)

studim

Proza e Kadaresë është në formën e rrathëve koncentrikë që, duke nisur nga qendra, vinë duke u zgjeruar.

"Kushëriri i ëngjëjve"

Nga **XHAFER MARTINI**



Valle dibrane. Pikturë nga Bajram Mata (ilustruese)

"Kushëriri i ëngjëjve" është nga librat më tërheqës që ka shkruar Kadareja. I kushtohet baletmaestrit të madh shqiptar që jeton e punon në Francë, Angjelin Preljocajt. Por Kadareja si siguron bazën e nisjes, nga ajo bazë, bombardon me artin e tij, edhe skajet më të largëta të globit. Mjetet artistike që përdor shkrimtari janë të shumta. Është veti e këtij shkrimtari që të mos ketë troje të ngulitura rreptësisht. Lëvizja, fluturimi, kalimi nga një situatë në një tjetër, nga një dukuri në një tjetër, nga një vend në një tjetër, është oksigjeni që ushqen veprën e tij. Në këtë vepër Kadare synon lehtësinë e qenies, çlirimi I saj nga pesha dhe rëndesa, nga tërhqja e tokës. Lehtësia e qenies ka të bëjë me lehtësinë e shkëputjes së njeriut nga toka, me idenë e fluturimit. Vepra I kushtohet një baletmaestri dhe sipas synimit filozofik të Kadresë vallja më mirë se çdo gjë tjetër në jetën e njeriut e siguron lehtësinë e qenies. Duke shfletuar Shekspirin, ka një cast kur Merkuti hynë në skenë thotë: "Ti je dashnor, I merr Kupidit krahët dhe kapërce kufijtë e zakonshëm. Këto fjalë atij ia ka thënë Romeo, por ky e kundërshton Romeon duke I thënë: " E kam shpirtin plumb, sa s'lëviz dot". Mënyra e të lëvizurit të Mërkutit nëpër botë përcaktohet nga foljet e para që përdor : to dance, to soar, to prickle (të vallëzosh, kapërce, shpëto). (Italo Kalvini: 2011: 63). Filozofikisht përcillet ideja se kërcimi, vallja, lehtësia të shpëtojnë edhe nga rreziqet. Si shikohet, raporti trupit me shpirtin, qenies me mendimin shikohet në një plan universial. Kadareja u vë rëndësi dhe është në gjendje të gjejë edhe mjetet për të shprehur lehtësinë e qenies. Kjo mënyrë për të gjetur mjetet e çlirimit nga rëndesa dhe për të provuar lehtësinë e qneies kanë ngacmuar vazhdimisht njerëzimin. Mbretëresha Mab, zonja e ëndërrave sipas mitologjisë, shfaqet në një karrocë të ndërtuar me një lëvozhgë lajthie:

"Karroca e saj prej këmbësh merimange,
Mbuluar lart me krahë karkalecash,
Ka ca pajisje kali prej pezhishke
Dhe një qafore rrezesh hëne endur
Kmzhik I saj është prej membrame filmi"
(Italo Kalvino: 20011: 64)

Figurat bazike të tij janë përfytyrimi, shoqërimi I ideve, planet retrospektive, shembëlltyrat e mjete të tjera artistike përmes të cilave ai zgjeron shumë këndin e projeksionit, por duke ruajtur në të njejtën kohë harmoninë e ekuilibrin e nevojshëm. Kadareja ka një imagjinatë të fuqishme. Baza krijuse e çdo shkrimtari të madh është imagjinata. Estetë të shquar, ndër ta edhe Italo Kalvino, I kushtojnë një rëndësi shumë të madhe imagjinatës. Danteja, duke riprodhur idetë e filozofëve të kohës së vetë, thërret: " O imagjinatë, që ke fuqi të imponohesh vullnetit tonë e të na rrëmbesh në një botë të brendshme, duke na shkëputur nga bota e jashtme, aq sa edhe sikur të binin një mijë bori nuk do t'I vinim re.." (Italo Kalvino: 2011: 116) Kadareja në mënyrën e vet e realizon idenë e fluturimit. Në most ë fluturimit tamam, të kapërcimit epokal. Ai ngrihet në fluturim menjëherë si ato aeroplanët gjuejtës dhe bombardues që shpejtësinë dhe befasinë kanë një pjesë të suksesit. Kadareja të del "atje ku nuk e pret", nëse shprehemi me këtë gjuhë popullore. A nuk është ky fluturim ose kapërcim, nga gjendje e qetë, "e rehatshme", në një gjndje tjetër krejt e ndryshme nga ajo e para. Mënyra për arritjene kësaj është befasia. Në këtë kuptim, befasia nuk është pritë kaçakësh, por kurth artistik, është mjeti më i mirë për të kapur lexuesin në pikën më të lartë të emocioneve dhe të ndjenjave. "Midis këshillave që u japin grave gjatë kohës së shtatzanisë është harmonia e lëvizjeve, shmangia e zhvendosjeve brutale, e lodhjes, e kapërcimit, si dhe paqja shpirtërore që lidhet, siç thonë mjekët, me shëndetin shpirtëror të fëmijës së ardhshëm." (Kadare: "Vepra", 2009: 27) Kjo fjali, marrë veças, është një këshillë e dhënë bukur si të bëhej nga një mjek gjinekolog. Kadareja nuk vazhdon të jap këshilla të tjera për gratë shtatzëna. Befasia e vërtetë vjen më poshtë kur marrim vesh që gruaja që po arratiset bashkë me burrin e saj, në vitin 1965, është nëna e Angjelinit, që të birin e ka në bark. Nuk kishte gjë më të vështirë, më tronditëse sesa të kaloje kufirin në ato kohëra. Kufiri ishte i rrethuar me tela me gjemba, pëllëmbë e rojë. Me sinjalin më të vogël ngrihej në këmbë "populli ushtar" i zonave kufitare, çetat kufitare, dhe, projektorët e dritat të verbonin nga të gjitha anët; ato i prisnin guvat e humnerat si me shpata zjarri. Sa e sa njerëz , burra dhe gra, madje me fëmijë e pleq, kanë dashur të dalin në botën e lirë, matanë telave me gjemba, por janë diktuar nga rojat kufitare, dhe, për të mos rënë në duart e tyre, për të mos provuar burgjet dhe torturat komuniste, janë hedhur nga shkëmbenjt duke i dhënë fund jetës në mënyrën më tragjike. Prandaj nëna e Angjelinit donte të ishte pa peshë, e padukshme, të fluturonte, por, meqë kjo ishte e pamundur, të shkilte sa më lehtë në tokë, të ecte ndryshe. Dëshira e nënës së Angjelinit për të ecur ndryshe, i kaloi të birit si dëshirë, si kumt, si ëndërr.... "Por një ecje ndryshe s'është veç vallja". (Kadare: Vepra: 2009: 28) Angjelin Preljocaj akoma pa lindur, qe përcaktuar nga fati të merrej gjithë jetën me valle, të ecte ndryshe. Kadare di të shfrytëzojë çdo imtësi të jetës të protagonistëve. Një shkrimtar pa përvojë dhe pa talentin e Kadaresë një akti të tillë mund t'i kalonte pa e vënë re siç mund të shkelim me këmbë një perlë.

Proza e Kadaresë është në formën e rrathëve koncentrikë që, duke nisur nga qendra, vinë duke u zgjeruar. Zgjerohet tematika, problematika, këndet e shikimit, shpeshtohen dhe ndërlikohen mesazhet, hollohen dhe konfigurohen filozofitë, gërshetohen dhe alternohen prurjet nga të gjitha fushat, por me mjeshtri, me elegancë, pak nga pak, sa vetëm një lexues i vëmendshëm mund ta vërë re. Proza e Kadaresë është si një kullë shumëkatshe, me arkitekturë të përsosur, ku çdo send apo vegël është në vendin e vet për të kryer funksionin e caktuar. Me pak fjalë, mund të themi se funksionaliteti është një tipar tjetër i artit të Kadaresë. Është një funksionalitet organik, si tek trupi i njeriut, ku nuk ka asgjë të tepër por edhe asgjë të mangët.

Tjetër veçori krijuese e Kadaresë është krijimi hapësirave të reja për veprën që ka nisur. Baza e nisjes mund të jetë e ngushtë, veçse disa metra katrore, por a di të çelë horizonte dhe ta bëjë këtë në mënyrë fare të natyrshme. Edhe këto janë kalime të befasishme, por kalime të mëdha. Kështu, si shembull, ëndërra e fluturimit, që e nënvizoi tek nëna e Angjelinit, e jep më poshtë si një ëndërr universale, si ëndërr e gjithë njerëzimit në të gjitha kohërat. Njeriu e ka realizuar sot këtë ëndër, por jo në formën dhe në mënyrën si e deshi ai. "... ëndërra e fluturimit ka pasur zhvillimin e saj. Ajo ka qenë me dy kahje. E para që njeriu të fluturonte vetë. E dyta, të fluturonte me një mjet. (Kadare: Vepra: 2009: 9) Siç dihet u realizua kjo e dyta, por shumë kohë më vonë. Me rrugën e parë njeriu u mor shumë kohë, sepse në ato shekuj ideja e fluturimit ishte më e gjallë, më e shpeshtë, më këmbëngulëse dhe njeriu më I predispozuar për të besuar se mund të arrinte gjithçka, duke u nisur nga ajo që shikonte në natyrë: "fluturonin hyjnitë, shtrigat, fantazmat, erinitë..., përse të mos fluturonte edhe njeriu?" Dhe ky iu vu ëndërrës së guximshme. Fluturimi ka pionierët e parë, por ata, mjerisht, qenë edhe dëshmorët e parë: Ikari, i biri i Dedalit, vuri krahë prej flatrash që i ngjiti me dyll, dhe, për të fluturuar sa më lart, nga ambicia e madhe iu afrua diellit që ia shkriu dyllin dhe fluturuesi u vra. Lëvizjen dhe rritjen e këndit të projeksionit Kadareja nuk I ka qëllim në vete. Ai do të dalë diku dhe atje ku del, ka rastin për të bërë përgjithësime të natyrave të ndryshe: filozofike, morale, psikologjike etj. Miti I Ikarit qe një paralajmërim që iu bë racës njerëzore: rri tek toka, je lindur tokësore dhe atje do ta kesh fluturimin tënd, bile, po të jesh me arsye të shëndoshë, nuk ke çfarë e do fluturimin se, punët që do të bësh, kërkojnë përqëndrim, rëndesë dhe jo fluturim. Por ideja dhe dëshira e fluturimit nuk mposhtet nga asgjë. "Në shekujt dhe qytetërimet e para, në fshatrat ku gruaja duronte peshën e rëndë të një jete të vështirë, shtrigat fluturonin natën mbi bishtat e fshesave dhe madje edhe mbi mjetet të tjera më të lehta, si kallinj ose fije kashte. Përpara se të kodifikoheshin nga inkuizitorët, këto pamje bënin pjesë në imagjinatën popullore, ose, më saktë, në jetën e përditshme. Besoj se lidhja midis dëshirës për të fluturuar dhe vuajtjes për mosarrtjen e saj është një konstante antrpologjike" (Italo Kalvino: 2011:72). Por meqë njeriu nuk mund të fluturonte vet, se kjo ishte përcaktuar nga ana antroplologjike, ai fluturonte me mjete të tjera" në kurriz të një kali apo të një zogu, mbi një anije fluturuese, mbi një qilim fluturues, mbi shpatullat e një gjigandi apo të një shpirti, në karrocën e djallit etj: " (Italo Kalvino: 2011: 72) Kadare rresht pas rreshti i jep prozës së tij hapësira planetare, e pasuron me ide, me përgjithësime artistike dhe filozofike, me mesazhe, me një sistem të ri të menduari. Pas argumentimeve të logjikshme, në formë të debateve dhe përplasjeve të brendshme dhe të gjitha formave intelegjente që përdor Kadareja në funksion të kthesave të personazheve dhe ndryshimit të situatave, vetvetiu hapen shtigje të reja mendimi. Kadare din të ndez dhe të mbajë gjallë debatin. Debatin filozofik dhe jo fjalët e plakave të mëhallës. Të mëdhenjtë ndihmojnë për të shpjeguar dhe kuptuar njeri-tjetrin. Kur I hyn punës për të zbërthyer Kadarenë këtë nuk mund ta bësh vetëm. Thirren miq të tjeraë nga larg, të gjallë apo të bdekur kjo nuk ka rëndësi. Njeri prej tyre që më ka ndihmuar në këtë punë, siç edhe e keni kuptuar, është Italo Kalvino. Kadareja don ta çlirojë njeriun nga peha e trupit të vet. Kjo, thotë ai, bëhet me anë të valles. Kalvino pranon peshën, por simaptizon shpejtësinë, lehtësimin e qenies ndoshta jo për të fluturuar, por për të ecur shejt, shumë shpejt. Kjo është çështje individuale, thotë ai, nuk mund të bëhet me ndihmën e askujt, dhe del tek mendimi se ana sasiore nuk shpie në ndryshime cilësore. Ana sasiore ndikon vetëm tek sasia, në asgjë tjetër. "...shumë kuaj, thotë ai, do të mbanin më shumë thasë me grurë nga ç'mund të mbajë një kalë I vetëm. Unë do të pranoja se diskutimet e shumta japin më tepër se sa një I vetëm, por diskutimi është si vrapi, jo si mbajtja e peshave, ndaj një kalë berber I vetëm do të vrapojë më shpejt nga njëqind kuaj Frislandi" (Italo Kalvino : 2011: 84) Shfaqja e Kadares për të spjeguar vallen, ose për t'u marrë me jetën e një baletmaestri, është më frytdhënëse se sa dhjetra etnografë qofshin këta akademikë. Kadareja shpjegon dhe I jep kuptim asaj që është ndryshe, sepse, në fund të fundit, funksioni i letërsisë është komunikimi midis asaj që është ndryshe, me atë që është e zakonshme. Nga ajo që është ndryshe nuk shpëtojmë duke e nëvlerësuar ose, ca më keq, duke e zhdukur, por I duhet dhënë kuptimi në raport me atë që është e zakonshme.

Njeriu, më në fund, del sikur pajtohet me idenë se për të është më mirë të mos fluturojë se fluturimi nuk i hyn në punë për qëllimin e jetës së tij. Kjo është ideja e arsyes, e misionit të njeriut në këtë jetë, e kufizimeve që i ka vu atij natyra. Tërthorazi del që njeriu e ka lirinë e kufizuar. Kufizimi I lirisë do të sillte edhe kufizime të tjera që do të bëhen nga vetë njeriu. Nuk është fjala për liri politike, por për liri natyrore që ka të bëjë me mundësinë e jetesës së njeriut, me lirinë që i ka dhënë asaj natyra, krijuesi, si një qenie eprane në shumë drejtime, por edhe e kufizuar në disa drejtime të tjera.

(vijon në numrin e ardhshëm)


Rruga e Arbërit nr. 162

kritikë

Befasia që sjell vargu i Naim Berishës buron nga dy elementë: nga rikonfigurimi i imazhit si kujtesë dhe perceptim dhe nga strukturimi poetik me vargje të rimuara, ku metafora dhe figuracioni letrar ngërthejnë dritëhijet e një bote poetike plot ndjesi dhe emocion.

Naim Berisha, *profil i një krijuesi të veçantë…*

Nga **DUKAGJIN HATA**



Me emrin e Naim Berishës lidhet një krijimtari e gjërë dhe e larmishme letrare, me fokusime emocionale të ngjeshura rreth kujtesës, si bartëse e të ndodhurës dhe mesazhim në kohë. Gjithashtu me emrin e tij lidhet talenti muzikor, si krijues tekstesh e muzike, si interpretues kënge me një profil të veçantë, që përcjell një botë të tejndezur nga pasioni për të bukurën, për traditën dhe risitë e modernitetit.

Në rreth 37 titujt e librave të tij, të botuar në këto dy dekadat e fundit, lëviz një botë e trazuar, në kërkim të një universi në hije, ku gëlojnë nën sipërfaqet e lëmuara të gjërave, qasje, ide, pasione, ëndrra, kauza, verdikte, që vënë në lëvizje gjeneratorët e një krijimtarie shpërthyese, me ndjeshmëri dhe emocion të fortë njerëzor. Dalja e tij në rrugën e artit shkrimor ishte e natyrshme, e paralajmëruar nga ciklet me poezi të botuara në shtypin e kohës, nga ai pasion që e ushqente me flakët e një shpirtit të dashuruar me fjalën e bukur, me magjitë e fshehta të një lënde estetike, që ai e vështronte gjithëkund, si një mundësi potenciale shprehjeje dhe vetërealizimi shpirtëror dhe intelektual.

Në vëllimin e parë me poezi "Ngado sytë e vajzës", botuar më 1993, poeti shpërfaq një botë të pastër dhe fluide, të materializuar në një produkt poetik spontan, me akuarele të befta, me një gjuhë të thjeshtë dhe përcjellje ndjesishë dhe mesazhezh sinqerta njerëzore.

Teksa vazhdon udhëtimin e tij poetik, Berisha bëhet më i menduar, më filozofik, ndërkohë që ndjeshmëria dhe spontaniteti, derdhur në llavën e tij lirike, shoqërohet me struktura të reja të ligjerimit poetik, duke ruajtur në të gjitha rastet muzikalitetin dhe qartësinë e diskursit të "ligjerimit", me qëllim që të jetë i prekshëm nga të gjitha shtresat dhe nivelet e shoqërisë.

Në librat pasues me poezi si "Lejlekët e lumit tim", "Hiq dorë", "Zog i qiellit", "Le të vijnë vajzat", "Njëzet lumenj rrjedhin në klasën time", "Ç'm'i ra vrugu gjethit t'verës" poeti vazhdon t'i qëndrojë besnik lirizmit dhe spontanitetit, ndërkohë që zgjeron rrethin e tematikës dhe të qasjes, pasuron spektrin liriko-emocional.

Befasia që sjell vargu i tij buron nga dy elementë: nga rikonfigurimi i imazhit si kujtesë dhe perceptim dhe nga strukturimi poetik me vargje të rimuara, ku metafora dhe figuracioni letrar ngërthejnë dritëhijet e një bote poetike plot ndjesi dhe emocion.

Teksa lexuesi gjurmon atë plazmim estetik të dendur e të ngjeshur në përfytyrime, imazhe, mesazhe, tekst e nëntekst, që përftohet prej një leximi të kujdesshëm të poezisë së Berishës, gjen të plazmuar një përditshmërinë të thyer në grimicime gjërash të prekshme, të imëta e konkrete, gjen nën të njejtin kulm historinë dhe ardhmërinë, të cilat që të dyja "frymojnë" nga përditshmëria…

Në rreth 37 titujt e librave të tij, të botuar në këto dy dekadat e fundit, lëviz një botë e trazuar, në kërkim të një universi në hije, ku gëlojnë nën sipërfaqet e lëmuara të gjërave, qasje, ide, pasione, ëndrra, kauza, verdikte, që vënë në lëvizje gjeneratorët e një krijimtarie shpërthyese, me ndjeshmëri dhe emocion të fortë njerëzor.

Naim Berisha është i natyrshëm në aktin e tij shkrimor; poeti e tejshtrin botëvështrimin e tij në hullinj të njohur përjetimesh, por mënyra se si ai vështron në këta hullinj është suprizuese; duke sjellë ritme dhe melodi spontane e trillere, që të rrëmbejnë e të bëjnë për vete. Kjo shpalosje e poetit, sjell me vete një aromë të veçantë jete, si një kumt ndjellës drejt përsosmërisë shpirtërore, në kufijtë mes realitetit të rëndomtë, që ushtron presion dhe ëndrrës së kulluar, si produkt i mirëfilltë poetik…

Naim Berisha ka botuar dhe 100 sonete nën titullin "Kashta e Kumtrit", ka botuar edhe përkthimin e 154 soneteve të Shekspirit, pra ka bërë botimin e të gjithë soneteve të tij, duke qenë i pari që i ka përkthyer e botuar këtë vepër të plotë. Gjithashtu ka botuar 1001 hajke, poezi japoneze trevargjeshe, sipas ritmit rrokjesor:5-7-5, si psh: Një llucë është jeta/ Bën të nxjerrësh njërën këmbë/ Fundoset tjetra". Është autor i nëntë poemave me përmbajtje dhe tematikë historike dhe apsekte të përditshmërisë së trazuar shqiptare. Ndër gjashtë romanet e tij, i treti është vargje, me pesë mijë vargje i gjithi: "Gurkeshtjella", dhe i gjashti është romani historik, "Të jetosh në paqe", që është një udhëtim historiko-estetik në kohën e shpirtit njerëzor, të kujtesës dhe të emocionit të fortë të së ndodhurës, si produkt i transfiguruar rrëfimtar. Në librin me tregime "Nata e një lypësi" shkrimtari sjell vjen me proza të shkurtëra të shkruara me një frymë, në mënyrë filmike, imazhiniste, ku përshkrimet e gjalla dhe dialogjet e zhdërvjellët të mbesin gjatë në mendje. Tregimi "Fillim vjeshte", me figuarcion të pasur, përshkrime idilike dhe dialogje impresionues, pasohet nga një tregim tjetër domethënës "Fryma e nënës", nga vetë titulli rikrijohet me frymë dashurie deri në kult portreti njerëzor i nënës. Më tej vijnë me rradhë "Nata e një lypësi", etj, tregime që pulosjnë nën sipërfaqe të qeta ndjesi dhe emocione të forta njerëzore.

Aftësia e tij e pazakontë për të rrëfyer përfundimet e vëzhgimeve, soditjeve, përsiatjeve të mjediseve, njerëzve, ndodhive, por mbi të gjitha të thellësive të unit, e bëjnë romanin tërheqës deri në befasim, duke na zbuluar një botë të pasur shpirtërore dhe një temporitëm të thyer emocional.

Ka në këto rrëfime ka lëng jete, realitete që të gjithë i prekim çdo ditë, por autori i transfiguron në materie estetike; ka nerv, detaje të imëta, zhbirime psiko-analitike, mesazhe që të bëjnë të reflektosh rreth të ndodhurës së pasqyruar në këto tregime. Një element që vazhdon të mbajë në fokus një procedim të lartë rrëfimtar është lirizmi, që ashtu si në poezitë e tij,por tashmë në një mënyrë tjetër, i shërben shkrimtarit si element konceptual dhe organizues i "lëndës së parë" rrëfimtare.

Një kënd qasjeje dhe pasqyrimi artistik të veçantë përcjell autori dhe në poemën fabuleske "Kafshët në kuvend", në librin "Djallëzia e kafshëve" (fabula), ku qasja fokusohet rreth botës së fëmijëve, me një stil të veçantë dhe gjuhë të pasur poetike.

Kulmin shkrimtari e arrin në romanin e tij "Vetëvrasja e shpirtit", ku në qendër të rrëfimit është një histori dashurie, me kurbat ngjitëse dhe rënese, me vrullin e flirtit, erotizmit, dramën e pritjes së pafat, humbjen dhe zhgënjimin.Ana dhe Andi, dy protagonistët e romanit, kryejnë një udhëtim jo vetëm në ndjenat e tyre për njëri-tjetrin, në kujtesën dhe fiskionin, por dhe një ekpslorim në vetë shpirtin njerëzor, ku është vështirë të dallosh fitimtarët dhe të humburit, pasi rrëfimi i Berishës është spontan, pa kahje dhe filtra. Siç thotë me të drejtë kritiku dhe stuiduesi i mirënjohur Fatmir Terziu: "…filozofia e Berishës gjen se në këtë lidhje është konceptualja midis përshkrimit të natyrës njerëzore dhe konceptit se çfarë është mirë për njohjen e kësaj natyre, sipas Almond, është e njëta gjë, që lidhet me disa probleme etike, që shërbejnë për të ngritur konfidencialitetin dhe informuar në mënyrë të plotë atë që është diskutuar. Sipas të dyve, ajo që është kryesore është se lidhjet jetike sjedhin një kuptim më të plotë për kuptimin e ideales në tolerancë".

Ajo që e bën të veçantë, të ngrohtë dhe sugjestive në kuptimin e befjes si lexim dhe reflektim është mënyra poetike e rrëfimit të autorit, procedimi poetik, që strukturon të gjithë elementët romaneskë të formës dhe përmbajtjes.

Personazhet e romanit nuk na përcjellin një dramë sentimentale e melankolike të vuajtjes dhe rënkimit, por një sagë poetike kërkimtare, që merr kuptim në udhëtimin e saj drejt vetvetes, drejt kujtesës, drejt historisë së saj dhe të brezit të saj, në raport me kohën dhe bashkëkohësin.

Romani përshkohet nga një narracion i zhdërvjellët, i çliruar nga "vijat e kuqe", nga rëndomësirat, nga truket dhe recetat, nga moralizimet dhe shtampat agjustive, me të cilat është mbushur dëng romani shqiptar, edhe pse jetojmë në një epokë të çlirimit të madh të estetikës nga jashtëestetika.

Aftësia e tij e pazakontë për të rrëfyer përfundimet e vëzhgimeve, soditjeve, përsiatjeve të mjediseve, njerëzve, ndodhive, por mbi të gjitha të thellësive të unit, e bëjnë romanin tërheqës deri në befasim, duke na zbuluar një botë të pasur shpirtërore dhe një temporitëm të thyer emocional.

Kuadratimi lirik, vëzhgimi i imët, i ndjeshëm, konkret në përshkrime, thellësisht realiste dhe transhendente, duket se janë produkte të një shpirti të ushqyer me dashurinë e madhe për jetën, me frymëzime nga lufta për të triumfuar mbi ndalesat fiktive të dashurisë, mbi harresën dhe zhbërjen si procese regresive, mbi humbjen dhe dhimbjen, mbi rënien dhe zvetënimin, mbi fatin që duket si fatalitet, por që personazhet e romanit, e përjetojnë si çlirim nga çdo dozë pesimizmi dhe fataliteti, si kërkim në shpirtin vetjak dhe universal të plotërimit.

cyan magenta yelloë black

mençuri dibrane

GJURMË TË MENÇURISË

Nga **ZABIT LLESHI**

Dibra gjatë historisë së saj ka nxjerrë prijësa të shquar që kanë udhëhequr luftëra të rëndësishme për mbijetesë, ruajtjen e trojeve, gjuhës, identitetit kombëtar, traditave e zakoneve etj. Besa, trimëria, bujaria e mikpritja janë manifestuar brez pas brezi në trevën e Dibrës. Bashkëudhëtare me këto virtyte të larta morale e patriotike ka qenë edhe zgjuarsia e mençuria, shfaqur në kohë lufte e paqe. Mbartës të mençurisë ishin prijës të maleve, drejtues të kuvendeve, të shtresave të pasura por edhe fshatarë të varfër.

Pjesa më e madhe e tyre ndanin kanune, pajtonin gjaqe, vinin në lojë herë parinë e Dibrës e herë armiqtë e shumtë të saj, kritikonin veset e këqija, parazitët, dembelët, të pabesët etj.

Xhafer Martini, Haziz Ndreu, Mevlud Buci, Shaqir Skarra etj, në studimet e tyre i kanë trajtuar zgjuarsinë, mençurinë e alegorinë e Dibrës që kultivohej gjerësisht në Odën Dibrane. U përpoqa të mbledh pjesë nga mençuria dibrane sidomos nga Gryka e Vogël një pjesë e të cilave botohet për herë të parë.

1- Dy nga fiset më të dëgjuara në Zogje, Markja dhe Leka patën një mosmarrëveshje që çoi mbledhjen e përkrahësve të tyre të armatosur përballë njeri tjetrit, gjendje lufte. Një përrua i ndante ato në fshat. Një plak nga fisi Kaja i lajmëron dy krerët e fiseve se të nesërmen në orën 12 të ditës i kërkonte Tush Lleshi. Asnjeri prej tyre e as Tushi nuk ishin në dijeni për pjesëmarrësit e takimit.

Tushi ishte njeri i zgjuar, ndante kanun e kuptoi se dikush e kishte organizuar këtë takim. Nuk u bë asnjë lloj gjyqi, kush e ka fajin, as u kërkua llogari pse ndodhi kjo. Pinë kafe. Të dy prijësit e fiseve u ngritën, larguan mbështetësit nga pozicionet luftarake që kishin zënë. U bë kështu pajtimi, ishte e vetmja mosmarrëveshje në historinë e fshatit.

2-Ramiz e Iljaz Markja martonin nipin e tyre në Grevë. Si daja që ishin morën edhe dy shokë sipas zakonit midis tyre dhe Xhemail Marken. Në një konak(odë), gjatë bisedës një i afërm i familjes Baruti u përplas me shoqëruesit e dajave . U prish atmosfera dhe u krijua një heshtje. Në konak një prej miqve iu drejtua Xhemail Markes:

-Fol Xhemail se kemi dasëm, kemi gëzim.

-Po, u përgjigj Xhemaili, do të bëjmë muhabet se ky shoqi jem ngarkon vezët në leqe të kalit dhe shkon në Tiranë, ndërsa ai shoqi juaj shika lamën me ferra këmbë zbathur.

3-Në vitin 1942 pas ardhjes së Italisë në Dibër u bombarduan me avion katundet e Epra të Grykës së Vogël. U vra një djalë 12 vjeç në Bllacë. Mblidhen pleqtë e Zogje e Bllacës dhe dërguan Xhemail Marken tek Halil Alia në Çidhën për të ndërhyrë tek italianët të ndaleshin bombardimet. Xhemaili, takon Halilin.

-Jam i dërguar prej pleqve të ndërhyni pranë autoriteteve italiane me të cilat bashkëpunon për të ndaluar bombardimet , po vriten fëmijë, gra e pleq në disa fshatra të Grykës së Vogël. Partizanët janë në mal e jo në fshat.

E vërteta është se Halil Alia ndërhyni tek italianët dhe u ndaluan bombardimet. E mbajti atë natë Xhemailin . Si shumë pari të tjera Halil Alia kishte odë. Kafe e muhabet kishte gjithë ditën e natën deri vonë. Mysafirin nga Gryka e Vogël e respektuan, por Halili kërkoi ti bënte një pyetje. Xhemaili i lutet mos më ngatërroni me pyetje se mund të ketë hatër mbetje e nuk është mirë për mua se jam i vjetër e mik në shtëpinë tuaj.

-Jo, e ndërpret Halili, vetëm të na e ndash kush vnjen (është ma e zonja) Dibra e Poshtëme apo Dibra e Epërme?

-Dibra e Poshtëme or Aga, thotë Xhemaili. Tun e ha, Dibra e Epërme tun e mblidh! Dibra e Poshtëme është drejt shpartallimit, Dibra e Epërme drejt organizmit e fitores. Megjithse Halili u premtoi se nuk do të ketë hatërmbetje, për një kohë të gjatë ra heshtja. Halili nuk foli atë natë.

4-Në konakun e Dine Demës si kudo në Dibër gjatë luftës Nacional-Çlirimtare ziente debati. Musë Izvira nga Çereneci ishte i pranishëm shpesh në konakun e Demës.

Musën një natë e pyet Shaqir Dema se kush do ta fitojë luftën, Nacional-Çlirimtarja apo Paria?

-Nacional-çlirimtarja, përgjigjet Musa, çil e mshil, ndërsa paria hut e dil. Pra luftën do ta fitojë nacional-çlirimtarja.



Kulla e Zunës, Sohodoll © Fation Plaku

5-Fiqiri Dinja në Maqellarë ndërtoi në sarajet e tij shtëpi, objekte shërbimi, furrë buke, reparte artizanati, magazina etj. Në pranverë të vitit 1943 organizoi një darkë ku thirri gjithë parinë e Dibrës, ftoi edhe Xhemail Marken nga Zogjet. Natyrisht erdh Xhemaili, qëndroi me hyzmeqarët e njerëzit e shërbimit. Të nesërmen shtëpitë e reja u vizituan prej të ftuarve. Fiqiriu u shpjegonte objektet. Xhemaili i shoqëronte i distancuar nga paria. Në një çast Fiqiriu shikoi Xhemailin dhe i bën përshtypje. Të gjithë shikonin shtëpitë e reja, Xhemaili shikonte nga e kundërta e tyre. Në një moment shkëputet Fiqiriu dhe pyet Xhemailin se pse po shikon nga e kundërta e të tjerëve?

-Po shikoi or begj se a ke ndonjë fukara afër sepse kur të shemen këto saraje mos i zësh poshtë fukarenjtë.

-Pse, do të shemen? ne sapo i ndërtuam të reja!.

-Nuk i dihet or beg, nuk i dihet, vazhdoi Xhemaili.

Mbas tre muajsh italianët dogjën kullat e Fiqiri Dines gabimisht. Kërkuan falje dhe i dhanë dëmshpërblim. Atë ditë Fiqiri Dinja kujton Xhemailin duke shprehur konsideratën ndaj tij sepse parashikoi shembjen e shtëpive të reja ditën e inagurimit.

6- Gjatë luftës nacional-çlirimtare në Bllacë qëndroi një natë Mehmet Shehu, mik i Rexhep Krosit. Mehmeti ishte i kënaqur nga mikpritja dhe biseda me malsorët. Midis të tjerave Rexhepi i thotë Mehmet Shehut se miqësia me rusët dhe serbët që po bëni nuk është e mirë dhe nuk do të zgjas shumë!.

Kjo këshillë nuk u prit mirë nga mysafiri i lartë dhe muhabeti u ndërpre për një kohë të gjatë. Erdhi koha për të fjetë. Rexhepi i drejtohet Mehmet Shehut:

-Flij i qetë mik se dy rrathë(skalione) shtëpinë e ruaj me djemtë e mi, pastaj vijnë rojet sipas rregullave që ka ushtria.

Në vitet 60 u prishën marrëdhënet me rusët. Mehmet Shehu paska pyetur për plakun e Bllacës Rexhep Krosi rron apo jo?.

7- Dalip Skarra në Shpukth do të martonte djalin por i duheshin para për të blerë rrobat e nuses e shpenzime të tjera. Për ti siguruar ato i drejtohet beut të maqellarës:

-Dua të më japësh borxh për të mbyllur dasmën e djalit, pas një viti do ta kthej borxhin. Beu i drejtohet me të qeshur:

-Kur i siguron lekët pas një viti, pse nuk e bën dasmën atëherë, një vit ma vonë?

-Ja për këtë nuk më paska vajtur mendja or begj, prandaj nuk thonë kot se duhet të kesh mendje begju, ia kthen Dalipi. Ne fshatarët jemi të pa shkollë.

8-Në Bllacë Jashar Zenelit i kish vdekur një djalë i ri, student në Liceun e Shkodrës. Erdhën për ngushëllim nga e gjithë Dibra. Ali Jani nga Topojani hyri në dhomën e burrave dhe tha:

-Kryet shëndoshë katundit dhe një lagje!.

Jashari e kuptoi dhe iu përgjigj si duhet Aliut. Shumë prej të pranishmëve nuk e kuptuan prandaj çuan njëri për të pyetur Rexhep Krosin. "Qofshi shëndoshë ju si katund dhe lagja Manjani ku është nip djali" ka dashur me thënë Ali Jani!

9-Osman (Tup) Leka doli në pension si mësues. Pranë familjes kryente disa shërbime, kulloste lopën..Kishte edhe një kafshë ngarkese, gomar për të siguruar drutë e zjarrit për dimër. Shpesh i takonte për të kaluar rrugës afër zyrave e stallave të kooperativës bujqësore. Kuadrot vendas dhe të ardhurit e njehnin Tupin sepse ai i merrte në shtëpi për kafe, i mbante për drekë a darkë sipas rastit, ishte bujar e mipritës. Një ditë gomari ngordhi. E shikojnë Tupin vetëm me lopë. Mblidhen disa nga kuadrot dhe vendosin të shkojnë tek Tupi e ta "ngushëllojnë" për gomarin. Pas përshëndetjeve të rastit me të gjithë, më i vjetri e pyet:

-Të kemi pa vetëm me lopën, ku e ke gomarin?

-Gomari më ngordhi, përgjigjet Tupi.

-A u mërzite?

- Ditët e para, thotë Tupi u mërzita, po sikur e kalova unë nuk e kisha ditur se gomari im paska pas gjithë ato shokë, kuadro deri në kryesi të kooperativës!

- Na e punove bukur or Tup, ia kthyen të ardhurit.

-Jo, jo, thashë të vërtetën, foli Tupi.

10-Në vitet e demokracisë një ministër i partisë demokratike u caktua deputet në rrethin e Dibrës, nuk ishte dibran. Gjatë fushatës shkoi në Luzni. Në takimet me zgjedhësit i shtruan problemin e farave.

-Zoti ministër, kemi dalë nga fara e misrit, duam farë vendi sepse është më i rezistueshëm kemi toka të varfra e pa ujë.

Kandidati për deputet u premtoi se do ju gjej farë misri vendi. U kthyen në Peshkopi dhe e pyetën ministrin se çfarë problemesh i shtruan në Luzni.

-Me specialistët do të përpiqem se do të sigurojmë farë misri vendi sepse kjo ishte kërkesa kryesore e tyre.

-Mos u lodh zoti ministër. Nuk është problem për luznakët fara e misrit, duan që deputeti

11-Për kryetarin e njërës prej kooperativave bujqësore në Dibër të Poshtme kishin ardhur shumë letra anonime për vjedhje dhe dëmtim të pronës së përbashkët. Hekuran Isai në atë kohë shkon menjëherë, mbledh popullin, lexon letrat dhe kërkon mendimet e pjesëmarrësve në atë takim.

-Kërkoi të më thoni të vërtetën a vjedh kryetari apo jo?

Njeri prej diskutantëve thotë:

Kryetari i kooperativës është kuadër i zgjedhur nga partia, ai nuk vjedh vetë por thesin e mban çelë.

Sekretari pyet një bashkëpuntor se çfarë do me thënë kjo që vetë nuk vjedh po thesin e mban çelë.

-Vetë nuk vjedh po çfarë t'i çosh nga prodhimet e pasuria e kooperativës e merr dhe e fut në thesin e tij.(Ramiz Leka Tiranë qershor 2019).

12-Shefki Lleshi në Zogje ka qenë për rreth pesëdhjetë vjet kryetari i këshillit fshatit. Këshilli jepte leje për ndërtim shtëpish në tokat e përcaktuara si vijë e verdhë . Aty nga viti 1986 Lazim Leka paraqitet për përgjigjen e kërkesës që i kishte bërë këshillit për leje për ndërtimin e shtëpisë së re. Shefkiu e këshillon Lazimin që të shkonte të bisedonte me Sami Lekën dhe vëllezërit e tij a janë ato dakord që të ndërtohej shtëpia aty pasi vija e verdhë ishte në ish tokën e tyre para kolektivizimit. Dikush i thotë kryetarit:

-Pse i sorollat njerëzit, e ke vijën e verdhë, jepi leje.

-Nuk ka gjë , u përgjigj qetësisht Shefkiu, nuk i dihet, ti pyes njëherë ish pronarët. Këtë e kishte praktikuar me të gjithë ata që kishin ndërtuar shtëpi të reja në Zogje. Pas viteve nëntëdhjetë Zogje ishte ndër fshatrat që nuk pati asnjë problem me pronat. (Lazim Leka, Zogje, 1990).

13-Në kohën e mbretërisë fshatarët e Çidhnës me anë të një letre i kërkuan mbretit të hapet kanali që ujët e Setës të dalë në Grykë Nokë e Mustafe. Erdhën dy inxhinierë nga Tirana për të verifikuar problemin. E panë terenin dhe mblodhën popullin. Shaqir Tola u thotë inxhinierëve:

-Na tregoni a del ujët për vaditje apo jo?

-Kanali bëhet, ujët del po të ishte naltmadhënia (Ahmet Zogu) ose Lalë Krosi nga fshati i juej. (Ali Hoxha, gusht 2019)

14-Dibra e Poshtëme në Lidhjen Shqiptare të Prizerenit zgjodhi përfaqësuesin e saj Isuf Beg Karasani. Gryka e Vogël dërgoi Zenel Hoxhën që ti përcillte Isuf Karasanit vendimin për të përfaqësuar atje edhe Grykën e Vogël. Për fat të keq kur shkoi tek Lusha në Arras, Isufi ishte nisur për në Prizren. Lusha vuri në dispozicion një djalë të ri dhe e nisi për të kapur Isufin rrugës, e gjeti në Sllovë dhe i çoi porosinë e Zenel Hoxhës. Shtëpia e Lushës e mbajti atë natë Zenel Hoxhën në konakun e tyre gjithnjë të çelur. Në bisedë e sipër dikush e pyet Zenel Hoxhën:

-Kush qëndron në krye të parisë së Dibrës?

-Në krye të parisë së Dibrës është ai që ka gardhin më të madh, u përgjigj Zeneli!. Pas përcjelljes së Zenelit e pyetën plakun e Lushe se çfarë deshi me thanë Zenel Hoxha?

-Gardhi i Zenel Hoxhës është pasuria, miqtë, shokët, mbështetësit afër. Kur ke pasuri, ke odë, mbledh burrat, luftëtarët etj. (Beqir Mata, "Zenel Hoxha i Gjurasit" Tiranë 2015, faqe 62).

Krenarë me emra artistësh popullorë

FestFolk Klosi 2019, veprimtari e rëndësishme e trashëgimisë shpirtërore



"FestFolk Klosi 2019" është veprimtaria më e rëndësishme e trashëgimisë shpirtërore shqiptare, që na shërben për ruajtjen, mbrojtjen, promovimin dhe popullarizimin e trashëgimisë kulturore e shpirtërore, krijuar në shekuj në gjinitë e këngës, valles, instrumenteve dhe kostumeve popullore". Parësorë për Festivalin Folklorik Kombëtar "FestFolk Klosi" është e do të jetë zhvillimi i kulturës tradicionale, ruajtja e origjinalitetit...

Nga HAMDI HYSUKA*

Kaloi një vit, që Klosi, për herë të parë, në festivalin e parë folklorik, më 16 shtator 2018, ishte qendra e kulturës mbarëkombëtare. Vërtetë qe ngjarje artistike dhe tregues i shpalosjes së vlerave të trashëgimisë kulturore e shpirtërore të komunitetit klosjan.

Dhe përsëri, në ditën e bukur të vjeshtës së dytë, 13 tetor 2019, u organizua Festivali i Dytë Folklorik Kombëtar "FestFolk Klosi 2019"! Në garën e madhe të folklorit erdhën në Klos për të konkuruar grupe artistike, rapsodë, valltarë e instrumentistë nga të gjitha trojet etnike shqiptare: nga Klina, Bulqiza, Istogu, Kukësi, Ferizaj, Kurbini, Malisheva, Shoshaj i Dukagjinit, Tetova, Dibra dhe Rahoveci. Organizator ishte Grupi Folklorik "Petralba". Rreth zhvillimit të festivalit mësuam nga drejtori artistik, instrumentisti i talentuar, z. Ikli Punavija. Sipas tij, qëllimi është të mbrojmë, promovojmë e popullarizojmë në publik vlerat më të mira muzikore, koreografike dhe etnografike të krijuara prej shekujsh në hapësirën mbarëshqiptare. "Për ne të gjithë, -theksoi ai, -ky festival ka dhe qëllimin madhor për të promovuar sa më shumë krijime të reja folklorike të grupeve".

* * *

Folklori ynë muzikor e bën jetën në një ndarje specifike, që lidhet me format e të shprehurit muzikor dhe tipet kryesore të instrumenteve të përdorur., Artistëve të folklorit tradicional popullorë iu uroi mirëseardhjen mikpritësi, kryetari i Bashkisë Klos, z. Ilmi Hoxha, duke theksuar se "FestFolk Klosi 2019" është veprimtaria më e rëndësishme e trashëgimisë shpirtërore shqiptare, që na shërben për ruajtjen, mbrojtjen, promovimin dhe popullarizimin e trashëgimisë kulturore e shpirtërore, krijuar në shekuj në gjinitë e këngës, valles, instrumenteve dhe kostumeve popullore. Me këtë rast kryetari përgëzoi entuziastët e kulturës dhe të traditës sonë popullore për mundin dhe përkushtimin e tyre, si dhe grupet pjesëmarrëse nga të gjitha viset shqiptare.

Sipas studiuesve, festivalet kombëtare, që organizohen në trojet etnike shqiptare, ndihmojnë bashkimin dhe afrimin e popullit shqiptar. Pjesëmarrja e grupeve folklorike nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi dhe shqiptarët e Maqedonisë zgjeron hapësirat gjeografike të folklorit shqiptar dhe sjell vlera të larta në interpretimin e trashëgimisë kulturore tradicionale, duke e kthyer këtë veprimtari të rëndësishme në një festë të folklorit shqiptar".

Festivali ishte festë e gëzuar popullore, me këngë, valle, rite e melodi, të cilat u interpretuan nga bartësit e folkut shqiptar. Pra, specialistë, profesionistë, folkloristë e gjurmues të pasionuar sollën para artdashësve të Klosit krijime folklorike të gjinive të ndryshme për t'i shijuar, ruajtur e përcjellë nga njeri brez te tjetri.

* * *

Për të shpalosur vlerat e trevave të tyre folklorike, së pari në skenë u ngjitën, jashtë konkurimit, të zotët e shtëpisë, artistët e Grupit Folklorik "Petralba", me valle karakteristike brezash, kërcyer nga Pëllumb Elezi, Rexhep Ahmati, Emiljano Elezi, Denis Ahmati, shoqëruan me ciganë Adhurim e Sokol Xhepi dhe në lodër Man Xhepi; melodi karakteristike me çifteli, interpretuar nga Ikli Punavija; këngën "Krah për krah luftoi me burrin", kushtuar heroinës Shote Galica, kënduar nga Verí Beça dhe vallen me motive të Xibrit, kërcyer nga valltaret e reja, Xibër.

Në Klos, nga skena e folklorit të Klinës, Festivalit tradicional gjithëkombëtar, "I këndojmë lirisë", erdhi kënga "Valon i lirë flamuri kombëtar", të cilën e interpretuan Fatmir Berisha e Xhavit Maxharra.

Vazhdoi konkurimin Grupi Folklorik "Gurra e Kurbinit", Kurbin, i cili solli në skenë këngët "Lum kjo ditë që sjell Nëntori", kënduar nga grupi i burrave; "Trámzit e beqarit", nga Terezina Gega dhe "Kërkon qyqja mal mbi mal", kënduar nga Mide Aliu.

Nga rrafshi i Dukagjinit, buzë bjeshkëve, Grupi Folklorik i Istogut, erdhi me këngën e Selman Kadrisë, kënduar nga Ismet Demaj; vallen dyshe të Podgurit, kërcyer nga Sadik Manxharaj (baca) dhe Ismet Demaj, si dhe melodinë me daulle e zyrlë, interpretuar nga Faton Bytyçi dhe Ukë Kamberaj.

Këngëtaret kuksiane Selvije Hajdini Sylaj dhe Beglie Ahmetaj kënduan "Mirë se të gjej, i bukuri Klos", potpuri dasme kuksiane dhe "Një këngë të re këndoj me çifteli". Qendra Kulturore Bulqizë, e Qarkut Dibër, solli në skenë këngë vajkalore, kënduar nga Agim Huna, shoqëruar në çifteli nga Besnik Dema, Bujar Lika, Rrahim Alliu, këngën për sheh Fejzë Bulqizën; melodi instrumentale me çifteli nga Besnik Dema, si dhe valle burrash, kërcyer nga Sinan Alliu e Bujar Çupi.

Këngëtarët Nazmi Hajdari dhe Afrim Krasniqi, nga jugu i Kosovës, komuna Ferizaj, u mirëpritën për interpretimin e këngës "Seç na erdh kjo ditë eksodi". Nga fisi historik i Shoshit, malësia e Dukagjinit, Shoqëria Kulturore "Besa Shosh" kishte këngë majekrahu, akapélo, kënduar nga Gjon Kosteri e Gjelosh Kola; vaje me lahutë, luajtur nga Gjon Kosteri; këngë me çifteli, e kënduar nga Gjelosh Kola e Pjetër Kolmartini; melodi me gjethe, luajtur nga Nikollë Vata dhe putira (këngë burrash), interpretuar nga grupi.

Vazhdoi konkurimin Shoqëria Kulturore Artistike "Zëri i Llapushës" Carallukë, nga Malisheva. Në program kishte valle burimore me çifteli, interpretuar nga grupi i instrumentistëve; melodi baritore me fyell nga Jakup Krasniqi, këngët "Dola me shetit në bahçe", kënduar nga Erestinë Hoti dhe Doruntinë Zogaj, "S'kam kujtue kurrë për jetë", kënduar nga motrat Kaltrinë e Festinë Gashi, "Ditët po kalojnë", nga Elita Krasniqi dhe valle tradicionale e Llapushës, kërcyer nga grupi i vajzave.

Në çdo skenë të kombit dhe jashtë tij, ku janë ngjitur dhe kanë interpretuar folklor me këngë e valle shqipe, Hajri Ismani, Xhemal Abdyrrahmani e Dashmir Saiti, artistë të Shoqërisë Kulturore Artistike "Jehona e malësisë" Tetovë, kanë mahnitur publikun. Në skenën e Klosit ata interpretuan potpuri këngësh me melos të Tetovës. "I dhe kombit të parin mbret", ishte kënga popullore folklorike për Matin, të cilën e interpretoi këngëtari dibran, Bledar Kaca, i Ansamblit Folklorik "Dibra", Peshkopi. Dhe për të mbyllur konkurimin, artistët e komunës së Rahovecit, të Shoqërisë Kulturore Artistike "Anadrini", interpretuan këngët "Larg teje, o nënë", nga Vlora Duraku, "Kreshtat e Kosovës" nga Islam Morina dhe suitë orkestrale të Baki Xhaferrit, shoqëruar nga orkestra.

Me pjesë folklorike u ngjitën në skenë për të përshëndetur festivalin vajzat e shkollës 9-vjeçare Gurrë e Vogël me valle vendçe grash të zonës së Gurrës; këngëtari Halil Aliaj, i Grupit Folklorik "Gurra e Kurbinit" Kurbin, me këngët "Jo gjakmarrje, por pajtim" dhe "Veç bashkimi forca e kombit", si dhe këngëtari matjan, Shkëlqim Farrici, me këngët kushtuar Sali Vatdodës e "N'kamë e tan' Kosova".

* * *

Në Festivalin e Dytë Folklorik Kombëtar "FestFolk Klosi 2019" u paraqitën grupe nga treva të ndryshme shqiptare, programi i të cilave ishte i gërshetuar me këngë e valle burimore dhe melodi instrumentale, kryesisht çifteli e bilbil. Konkurimet u ndoqën nga publiku me mjaft interes, sepse sollën vlera të shumta në drejtim të promovimit të trashëgimisë kulturore shpirtërore shqiptare.

Në krye të jurisë ishte Ali Mulaj, "Mjeshtër i Madh". Sipas tij, "FestFolk Klosi" 2019 është nga aktivitetet kulturore dhe artistike më të mira, që bashkia e Klosit organizoi për të promovuar sa më shumë të jetë e mundur vlera folklorike. Festivali ishte dëshmi e një realitet të ri folklorik, pasi u pa konkurimi i grupeve nga krahina të ndryshme të kombit. Si juri e besuar, e fushës së etnomuzikologjisë, etnografisë dhe kostumeve popullore, për grupet më të mira konkuruese të festivalit dhe për interpretuesit më të mirë individualë u dhanë vlerësime. Çmim të tretë morën rapsodët nga Ferizaj, Nazmi Hajdari e Afrim Krasniqi dhe SHKA "Anadrini" Rahovec, çmim të dytë "Jehona e Malësisë" Tetovë e "Besa Shosh" Dukagjin, ndërsa çmimin e parë e fitoi SHKA "Zëri i Llapushës", Malishevë. Sipas vlerësimit të Jurisë, Rapsodi më i mirë i festivalit ishte Gjon Kosteri nga SHKA "Besa Shosh" Dukagjin; instrumentisti më i mirë Baki Xhaferi, SHKA "Anadrini" Rahovec; Vallja më e mirë ishte e Grupit Folklorik "Selman Kadrija" Istog; Valltari më i mirë Sinan Alliu Bulqizë; Valltarja më e mirë Floranda Bytyçi, SHKA "Zëri i Llapushës" Malishevë; Orkestrina më e mirë e festivalit SHKA "Anadrini" Rahovec; Kostumi autokton i festivalit ishte i Grupit Folklorik, Kurbin.

Ndonëse konkurenca ishte e madhe, ngaqë pjesëmarrësit vinin nga troje të ndryshme etnike shqiptare, SHKA "Zëri i Llapushës" Carallukë bëri diferencën duke u vlerësuar më e kompletuara e festivalit. Ndërsa për vlera të trashëgimisë së pashtershme folklorike dhe interpretim me nivel të lartë artistik, u dhanë çmimi i publikut për Grupin Folklorik nga Kukësi dhe Çmimi i karrierës për Fatmir Berishën, Gjergj Lekën, Nazmi Hajdarin, Gjon Kosterin, Ismet Demajn, Baki Xhaferrin dhe Agustin Cekën, me motivacion: *"Për kontribut shumëvjeçar, nivel të lartë e mjeshtëri artistike në interpretimin e folklorit burimor tradicional ndër vite"*.

Për ruajtjen e trashëgimisë folklorike të trevës së Klosi, kryetari i Grupit Folklorik "Petralba", Ikli Punavija, vlerësoi me mirënjohje valltarin Murat Murati (pas vdekjes), instrumentistin Mehmet Kurti, rapsodin Nezir Neli (pas vdekjes), instrumentistët Veri Koburja e Shaban Ferra, instrumentistin Hasan Ferra (pas vdekjes), valltarët Nazmie Hoxha e Isuf Topalli, si dhe ish-përgjegjësat e kulturës Avni Halili e Sali Shqypi.

Parësorë për Festivalin Folklorik Kombëtar "FestFolk Klosi" është e do të jetë zhvillimi i kulturës tradicionale, ruajtja e origjinalitetit, e thelbit folklorik shqiptar dhe trashëgimi i këtyre vlerave artistike. Organizatorëve të festivalit u afruan mbështetje financiare "Koka & Ergi Energy Stavéç", "Alb Leaa International", Studio "Hasa", "Gjoka Konstruksion", "Ndregjoni", "G. P. G Company", "S. B. M Grup", "Redi Mat", Valbona Kola, Ilmi Hoxha, Asllan Muharremi, si dhe Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike, Tiranë.

* * *

Këngët dhe vallet folklorike bashkuan qytetarë e artistë nga mbarë trevat shqiptare. Përmes tyre morëm mesazhin e qartë, se folklori kalon nga brezi në brez dhe jeton e ruhet i paprekur edhe në ditët tona. Objektiv në të ardhmen për organizatorët e "FestFolk Klosi" mbetet cilësia e festivalit dhe zgjerimi i gjeografisë së grupeve pjesëmarrëse, duke synuar prurjen e vlerave folklorike dhe artistë popullorë nga më shumë treva shqiptare.

**kryetar i Klubit të Shkrimtarëve e Artistëve "Pjetër Budi", Mat.*



recensë

Autori me një gjuhë dhe stil të thjeshtë, por të qartë e të rrjedhshëm, me një stil rigoroz shkencor, ka operuar me faktet dhe dokumentet e marra në arkivat, muzetë, bibliotekat dhe madje edhe me ish-drejtues të formacioneve luftarake, duke ia dalë me sukses të risjellë në mënyrë të plotë formatin dhe përmbajtjen organizative, luftarake dhe drejtuese në zonën e Dibrës.

Vlerat dhe veçoritë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në Dibër

Nga Prof. Asoc. Dr. **BERNARD ZOTAJ**

O MOJ DIBRA, HEROINË

Në kohë që po studioja librin e Sakip Camit "Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare në Dibër", më vjen një video nga një lab, kënga smokthinjote "O moj Dibra, heroinë" kënduar në vitet 1970. U çudita, por dhe u mrekullova që një grup tepër karakteristik i Smokthinës, nga jam dhe vetë, ti këndojë Dibrës heroinë. Kjo këngë më frymëzoi për të hedhur në letër disa mendime që të përforcoja më shumë punën e studiuesit Sakip Cami, për një nga periudhat më të lavdishme dhe më heroike, por siç shprehet dhe gjenerali shekullor Rahman Parllaku, ajo "është një luftë e lavdishme që e renditi popullin shqiptar në krahun e fituesve".

Në përfundim të leximit të këtij libri theksova se dibranët duan të mësojnë dhe ta njohin sa më mirë e deri në fund të vërtetën për Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare në Dibër. Njëkohësisht kjo etapë madhore e historisë, siç ishte antifashizmi shqiptar në Luftën e Dytë Botërore, duhet njohur, studiuar, respektuar dhe nderuar nga të gjithë me madhështinë e saj.

Libri me dokumenta na çon në të vërteta historike të ndodhura në ato kohëra, sepse historia është ajo që ka ndodhur dhe kurrë nuk mund të mendohet si ajo mund të ndodhte me sikur, siç bëhet në këto vite të demokracisë. Historia është realiteti i kohës dhe nuk mund të themi kështu apo ashtu, e që nuk ndodhi, siç e mendojmë sot.

Autori i ka vendosur vetes për detyrë që nëpërmjet historisë të kësaj epoke të ndodhur në Dibër, të mësojmë që të ecim përpara dhe jo të kthehemi pas, duke harxhuar të gjitha energjitë se ishte apo s'ishte luftë civile, u veprua drejt apo shtrembër nga të gjitha forcat politike dhe ushtarake të kohës. Në këtë kontekst të mos harrojmë dhe thënien e akademikut Moikom Zeqo që ka theksuar se "të mos harrojmë se ne shqiptarët e bëjmë historinë, por jo jashtë historisë evropiane dhe botërore. Askush nuk mund të na shfajësojë ose të na justifikojë. Historia ka folur, çështja ka përfunduar!".

Thënë më shkurt dhe qartë se kjo, Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare është një histori e mbyllur me fitimtarë, duam apo nuk duam. Kjo histori na bërtet dhe çirret duke thënë më lexoni dhe më shkruani siç janë dokumentet që fatmirësisht janë të shumta nga "ne", "ata" dhe "atyre" që na u ndodhën pranë në luftë.

ANTIFASHIZMI SHQIPTAR NË LUFTË DUHET RESPEKTUAR

Myslim Peza krijoi qendrën rezistuese dhe Çetën e Parë Antifashiste në Evropë. Ai gjithashtu u bë shtylla kryesore e Konferencës së Pezës, ku morën pjesë dhe figura të tjera popullore si trimi nga Dibra Haxhi Lleshi dhe Baba Faja nga Martaneshi dhe formuan Frontin Nacionalçlirimtar. Po çfarë të bëjmë me antifashizmin e Babë Myslymit dhe të çetës së tij, që bëri pushkë me fashistët italianë, kur Evropa pushtohej prej fashizmit, por çfarë t'i bëjmë edhe Tercilio Kardinalit, i cili nga fashist e bë antifashist dhe ra për antifashizmin.

Në zhurmën e madhe dhe të gjithanëshme që po bëhet nga të gjitha anët kundër antifashizmit shqiptar, për ta urryer dhe bërë bashkëudhëtare me krimin dhe për ta çrrënjosur nga mendjet e popullit këtë vlerë madhore historike, na vjen një pjesë e historisë së Dibrës si kujtesë dhe kushtrim për të gjithë. Ky kor i të tërbuarve po kërkon dhe po ja arrin qëllimit për ta bërë antivlerë të neveritshme, por kjo nuk është as punë shkencore dhe as njohje dhe studim të dokumentave të kohës. Në këtë zhurmë të neveritshme që po bëhen dhe prej disa instrumentave të caktuara shtetërore dhe që nisen jo nga e vërteta historike, por nga e kundërta e kësaj të vërtete të shkruar dhe të dokumentuar.

Po kush e bën këtë, ç'rrugë dhe filozofi ka brenda saj, këtë e shohim si drita e diellit, sepse është e pamundur që të mohohet dhe të denigrohet antifashizmi shqiptar, por nuk mund të shpërbëhet dhe të shkelmohet Antifashizmi Botëror i shek XX. Antifashizmi Shqiptar gjendet i lidhur ngushtë me Antifashizmin Botëror, pjesë e aleancës më të madhe të njohur në historinë e politikës



LUFTA ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE NË DIBËR
SAKIP CAMI

Botimet M&B
ISBN 978-9928-307-05-7
Faqe: 464
Çmimi: 1200 lekë

dhe të luftës. Kjo është një periudhë madhore e historisë dhe Antifashizmi Shqiptar në këtë luftë duhet respektuar prej gjithë popullit shqiptar.

Ndaj dhe historia më e lavdishme e popullit dhe e kombit tonë në shek. XX është Antifashizmi shqiptar. Antifashizmi ishte një shpikje dhe një kulturë e re që njerëzimi në Luftën e Dytë Botërore e bëri të vetën. Ndërsa në Luftën e Parë Botërore nuk kishte antifashizëm, por shembje të perandorive dhe mbretërive dhe lufta për krijimin e një mekanizmi botëror, me bazë idetë e revolucionit francez, të një demokracie dhe lirie për popujt.

Antifashizmi u bë një apel madhor dhe u krijua Aleanca më e madhe e kohërave, në të gjithë shekujt e shoqërisë njerëzore, Aleanca midis SHBA-Anglisë-BS, për të luftuar, rezistuar dhe fituar ndaj shtërngatës nazifashiste. Kushtet historike, bënë që shqiptarët të merrnin pjesë me dinjitet në Aleancën Antifashiste të Aleatëve të Mëdhenj dhe luftuan kundër fashizmit italian dhe nazifashistëve gjermanë.

Kështu që në kushtet e një pushtimi, siç u gjend Shqipëria në Luftën e Dytë Botërore, nuk kishte luftë civile, por luftë të mbarë popullit që u ndesh dhe me bashkëpunëtorët vendas të pushtuesve. Një shembull i thjeshtë: Antifashistët italianë luftuan kundër fashistëve italianë dhe në historiografinë e tyre nuk thuhet për luftë civile. Dhe më tej. Antifashizmi francez, partizanët francezë të udhëhequr nga PKF mbajtën peshë të madhe në luftë. Antifashistët francezë u persekutuan u burgosën dhe u vranë nga Qeveria Kolaboracioniste e gjeneralit Pëten. Lufta vazhdoi, jo vetëm kundër pushtuesve gjermanë, por dhe ndaj tradhtarëve, siç i quante antifashisti De Gol. Kur Franca u çlirua De Goli bëri dënim të kolaboracionistëve francezë, të Pëtenit e disa nga ministrat e tij, të njohur dhe intelektualë me emër. Në historiografinë e Francës nuk e quajnë luftë civile. Tani duhet që edhe Rusvelti dhe Çërçilli të akuzohen se bënë aleancë me Stalinin. Pa këtë treshe, pa këtë Aleancë nuk do kishim Antifashizëm Botëror.

PANORAMË E NDRYSHME NË DIBËR GJATË LUFTËS

Në kreun e parë autori analizon dhe sqaron edhe disa nga veçoritë e LANÇ-it në Dibër dhe në Dibër të Madhe. Interes paraqet letra e ish drejtorit të shkollës teknike amerikane në Tiranë, raportet e huaja për zhvillimet e luftës në Shqipëri (1943-1944), si dhe misionet ushtarake aleate në Shqipëri dhe në Dibër. Vëmendje autori i ka kushtuar misionit britanik ushtarak në Tërnovë tek shtëpia e Bajram Zenelit, misionit amerikan,

Libri me dokumenta na çon në të vërteta historike të ndodhura në ato kohëra, sepse historia është ajo që ka ndodhur dhe kurrë nuk mund të mendohet si ajo mund të ndodhte me sikur, siç bëhet në këto vite të demokracisë. Historia është realiteti i kohës dhe nuk mund të themi kështu apo ashtu, e që nuk ndodhi, siç e mendojmë sot.

sovjetik, jugosllav, ideja për krijimin e shtabit ballkanik, si dhe për shtabin aleat të forcave ajrore për Ballkanin në Bari. Interes paraqesin dhe porositë (urdhërat) e misionit anglez në Dibër.

Vëmendje të veçantë i kushtohet partisë nacional zogiste ose Lëvizjes së Legalitetit që e kishte bërthamën në Dibër. Në mënyrë të detajur përshkruhet pushtimi fashist dhe qëndrimi i dibranëve, jepen kolaboracionistët, bashkëpunëtorët me pushtuesit fashistë dhe nazistë. Me interes janë dhe dokumentet që flasin për celulat komuniste dhe fillimin e lëvizjes komuniste në Dibër, pozicioni i dibranëve dhe Haxhi Lleshi e Konferenca e Pezës. Studiuesi Sakip Camika paraqitur edhe Faik Qukun dhe Ballin Kombëtar në Dibër sipas librit dhe shënimeve të Faikut, "Bashkimin Dibran" dhe krerët e grupet e Dibrës, Parinë e Dibrës që mori pjesë në Konferencën e Zall Herrit në tetor 1943, përpjekjet e kësaj parie në Peshkopi për formimin e qeverisë së përkohshme.

Si Dibra shpëton nga lufta civile, është një përpjekje e veçantë që autori ka arritur dhe ka shpjeguar për këtë dukuri, që sot mjaft studiues dhe politikanë duan që ta pranojnë si një të vërtetë, kur realisht nuk ka qenë luftë civile por luftë për çlirim nga pushtuesit fashist dhe nazist. Në këtë kapitull paraqiten disa dokumente arkivi të Ministrisë së Brendshme dhe përshkruhen shkurt kryeministrat dhe ministrat e brendshëm gjatë pushtimit nazi-fashist 1939-1944.

Është interesant dhe studimi që merr vlera dhe veçori për rolin e ushtarakëve në Luftën Antifashiste Nacionalçlirmtare nga Dibra. Lufta ishte tepër e mpleksur dhe e shpejtë në kohë, ku autori thekson se në konak ishte një dhomë parija dhe një partizanët.

FORMACIONET LUFTARAKE DHE LUFTIMET E ZHVILLUARA NË DIBËR

Në kreun e dytë përshkruhen formacionet luftarake dhe luftimet e zhvilluara në Dibër gjatë Luftës Antifashiste. Autori fillimisht përshkruan forcat ushtarake të armikut (italianë dhe gjermanë), UNÇSH, Balli Kombëtar, Legaliteti dhe qeveritë në Dibër dhe në Dibër të Madhe, ku përparësi marrin repartet e mbrojtjes kombëtare, forcat qeveritare, njësitë partizane, forcat ushtarake të Ballit Kombëtar, forcat ushtarake të Legalitetit dhe forcat armike. Në vëmendje të autorit është dhe L**ëvizja në Dibër, ku përshkruhen shtëpitë dhe bazat e LANÇ-it në Dibër,** Tërnova, fshat bazë i luftës, takime të Haxhi Lleshit e Qazim Prishtinës me Bajram Zenelin e bashkëfshatarët e tij në Tërnovë, vendi dhe roli i këshillave nacionalçlirimtare dhe këshilli antifashist i qarkut Dibër, roli i gruas antifashiste, nusja "partizane" që kaloi përmes nazistëve, roli i fëmijëve dhe kujdesi për robërit e luftës etj.

Me interes paraqiten dhe çetat luftarake, si çeta e parë antifashiste e Dibrës, çeta partizane e Gollobordës, çeta e vetëmbrojtjes së Trebishtit në Gollobordë etj. Vend të dukshëm zënë si çetat nacionaliste dhe çetat partizane. Autori përshkruan dhe formimin e batalionit partizan të Dibrës, shërbimin shëndetësor, spitalet partizane. Me interes janë dhe çështjet që kanë të bëjnë me internimet gjatë vitit 1940 dhe internimet në Itali.

Të ndarë si nënçështje shtjellohen dhe lufta kundër fashistëve italianë dhe nazistëve gjermanë në Dibër. Në çdo epapë përshkruhen të gjithë ngjarjet dhe luftimet e zhvilluara me këto dy forca ushtarake të kohës e që kishin pushtuar territorin e Dibrës dhe Dibrës së Madhe. Vëmendje autori i kushton dhe luftës së njësive të mëdha partizane që bënë në Qarkun e Dibrës. Përparësi autori i ka dhënë dhe formimit të Br. XVIII S me luftëtarë nga Dibra dhe luftimet e zhvilluara prej saj deri në çlirimin e plotë të vendit, por dhe pjesëmarrjen e saj në çlirimin e Prizrenit etj. Vend të dukshëm në libër zë Haxhi Lleshi, Hero i Popullit, gjeneral Dali Ndreu, Nderi i Kombit, Esat Ndreu, komandant i Br. XVIII S, Hamdi Mersim Dema, Nexhat Zija Agolli dhe Qemal Agolli. Më tej në libër jepet e plotë dhe lista e dëshmorëve të Dibrës, si një risi e re e një libri të tillë me vlera historike. Libri është i ilustruar dhe me mjaft foto që e bëjnë më të gjallë historinë e Luftës në Dibër.

Libri "Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare në Dibër" i Sakip Camit është një përpjekje serioze që bëhet për të pasqyruar sa më realisht dhe pranë dokumentave të kohës, gjithë veprimtarinë luftarake dhe jo luftarake të një zone të fuqishme siç është Dibra dhe Dibra e Madhe.

VLERËSIME PËR LIBRIN DHE AUTORIN

Përmes këtij libri autori sjell ndihmesën e tij në trajtimin e plotë dhe mbi baza dokumentare të njërës prej zonave më të veçanta e më të mëdha si Dibra, për kohën kur veproi, duke sjellë njëherësh dhe një ndihmesë të çmuar në fushën e Historisë Ushtarake Shqiptare. Autori është përpjekur dhe i'a ka arritur të rindërtojë të plotë imazhin e kësaj zone luftarake, me veçoritë e veta dalluese si në organizim ashtu edhe në veprimtarinë e dendur luftarake, pa lënë jashtë trajtese edhe rolin e spikatur të saj, si një burim njerëzor për ngritjen e çetave, batalioneve dhe të brigadës sulmuese. Në punim, për herë të parë jepet e tërë skema e veçantë organizative, e plotësuar tashmë dhe me të dhënat për drejtuesit kryesor, si dhe me dukuritë e risitë e veprimtarisë luftarake të njësive që vepruan në Dibër. Madje aty sillen në mënyrë të plotë mjaft të dhëna e statistika përmbi formacionet ekzistuese para krijimit dhe të tjerave që u formuan më pas, gjatë veprimtarisë së luftës.

Autori me një gjuhë dhe stil të thjeshtë, por të qartë e të rrjedhshëm, me një stil rigoroz shkencor, ka operuar me faktet dhe dokumentet e marra në arkivat, muzetë, bibliotekat dhe madje edhe me ish-drejtues të formacioneve luftarake, duke ia dalë me sukses të risjellë në mënyrë të plotë formatin dhe përmbajtjen organizative, luftarake dhe drejtuese në zonën e Dibrës. Njëherëshi, autori, në këtë punim thuajse monografik, kontribon dhe në publikimin e një numri jo të vogël faksimilesh dokumenta autentik që i përkasin kësaj periudhe dhe veprimtarisë së drejtuesve të saj. Këto dhe aparati shkencor i pasur, që shoqërojnë punimin, e bëjnë atë më të besueshëm dhe të argumentuar. Kësisoj, libri jo vetëm sjell vlera njohëse dhe shkencore, por ai mund të shndërrohet si një botim shkencor me vlera studimore. Edhe pse autori operon në një terren disi të lëvruar, trajtesa në një libër e organizimit dhe veprimtarisë luftarake në Dibër, të formacioneve të ndryshme që operuan në terrenin konkret, ka vlera të veçanta. Është meritë e autorit që ka ditur të na i japë këto veçori duke shmangur përsëritjen. Autori jep një imazh të qartë dhe të menduar mirë, të njeh me situatën politike dhe ushtarake të trevës që do të bëhet arenë e veprimtarisë së luftimeve, me pozicionin gjeografik dhe me atë dënduri formacionesh luftarake që vepronin gjatë zhvillimit të luftës. I ndërtuar mbi bazën e një strukture të qartë, libri jep një tabllo të plotë për LANÇ-in në Dibër me të gjithë treguesit e vet. Me interes është informacioni për strukturën e formacioneve, të shtabeve dhe përbërjen e tyre me kuadro me kulturë e përvojë luftarake. Me realizëm trajtohen problemet e organizimit dhe mekanizmit të funksionimit të çetave dhe të batalioneve, në përshtatje me veçoritë e detyrave dhe të veprimtarisë së tyre.

Punën e organizimit të luftës në Dibër autori e shikon me një vizion të gjerë, si në organizimin dhe veprimtarinë luftarake të formacioneve të saj, në ndihmesën për organizimin e pushtetit të Këshillave Nacionalçlirimtare e sidomos në furnizimin me efektiva, armatim e materiale etj. Nëpërmjet këtij studimi evidentohet qartë vlera dhe roli i madh që kanë luajtur këto formacione në Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në Dibër. Materiali shquhet për gjuhë të pastër, për një mendim të rrjedhshëm e të qartë. Vihet re, se ky libër është rrjedhojë e një pune tepër voluminoze, e një studimi të gjërë të literaturës së botuar e arkivave, të cilën autori e ka përdorur e cituar me kriter e korektesë.

80 vjetori i lindjes:
30 nëntor 1939 – 30 nëntor 2019

Nazif Bodini, mësuesi dhe veprimtari i kulturës së brezave

Nga **MEVLUD BUCI**, *studiues-publicist*



Jeta dhe puna e njeriut ngjajnë fort me mineralet e çmuara. Ata sa më fort kohë që të kalojnë nuk treten, por shndërrimin dhe bëhen edhe me të forta. Kështu të ndodh edhe me Nazif Han Bodinin e Selishtës së Katër-Grykëve, njërit prej 9 Maleve të Dibrës. Sinqerisht, kur mora vesh se ky intelektual virtuoz e me talent ka 80 vjetorin, ndjeva krenari e përmallim, por edhe një peshë të rëndë me shpirt e në mendje, sepse s'është e lehtë të shkruash për këtë mjeshtër të palodhur të arsimit e të kulturës. Pata fatin të punoj përkrah tij e të mësoj shumë prej tij, sepse udha e shenjtërimit njerëzor kalon përmes mësimit, punës, përkushtimit e humanizmit. Këto kurrë nuk i munguan Nazifit. Fëmijëria dhe jeta e Nazif Bodinit kanë qenë të vuajtura, të dhimbshme, por edhe të bukura e krenare. Ky trinom fisnikërie meriton të thuhet që në hyrje të këtij shkrimi modest, sepse ky intelektual i talentuar ka ecur përmes zjarrit, vështirësive e luftës klasore, sepse ishte nipi i akademikut (atdhetar nacionalistit të shquar) Lik Abaz Dervishi, i cili u pushkatua padrejtësisht në Arbanë të Tiranës në vitet e pragut të çlirimit. Geni i atdhetarisë Nazif Bodinit buron edhe nga Hoxhë Bodini (Sefer Bodini) i cili së bashku me Hoxhë, me të birin ranë në mejdan të lirisë në Petrino në shtator 1913, në betejat kundër pushtuesve serbë. Nazifi u rrit dhe edukua me kulturën e odës me dashurinë për diturinë, për fjalën, për humorin e mbi të gjitha me dashurinë për traditat. Prindërit e urtë e bujarë, vëllezërit Ibrahimi e Dani, filozofi Haxhi Bodini, dëshmori i kombit Salë Bodini, i nderuari Hysni Bodini, Ahmet, Haziz, Tahir e Ramiz Bodini ngjajnë për Nazifin si krahët e shqipes. Historia e familjes dhe fisit të Nazifit është histori e qëndresës, e bujarisë, histori e fjalës dhe e kulturës.

Gjyshi i Nazifit, Hoxhë Bodini (Seferi) siç i thonin në Dibër të Madhe, Hoxhë Tanushi ishte shok i Hoxhë Vokës e Dervish Himës solli abetaren e Naimit në mejtepin e tij, në kullë, ku u mësoi disa fëmijëve të Selishtës shkrim e këndim. Ishte edhe i lidhur ngushtë me atdhetarin e flaktë Jashar Erebara.

* * *

Nazifi, mësimet e para i mori në vendlindje nga mësuesit Myslim dhe Ramadan Loca, Hysni Bardhi, Ramadan Perhi e Dilaver Gjoka.

Pas përfundimit të arsimit pedagogjik punoi në përkushtim si mësues në Fushë-Alie (Çidhën), Kastriot, Lukan, Kacni, Selishtë. Ka punuar 32 vjet në arsim dhe 7 vjet përgjegjës kulture, organizator i përkushtuar, regjisor, aktor, drejtues i skenës, koreograf etj.

Gjurmët e punës së Nazif Bodinit rrezatojnë në vite e kohëra. Metodist, kërkues, veprimtar e organizator, komunikues me nxënësit e kolegët, intelektual me kulturë të leme, si i thonë, gjithnjë i thjeshtë, i dashur, me humor të mprehtë e të rrallë. Brezat e nxënësve edhe prindërit flasin me respekt e nderim për Nazif Bodinin. Për këtë intelektual me vlera të çmuara e të ndritur të Selishtes, Dibrës e më gjerë shkruhet në librin e të nderuarit Faik Ramadan Bruçi "Fisi Bruçi i Lukanit të Dibrës". *Nipi i Dervishe. Ka punuar gjithë jetën arsimtar në disa fshatra të Dibrës. Sot pensionist. Jeton në Kodër Kamëz. (Faqe 198).*

Për Nazif Bodinin shkruhet edhe te libri "Dritare fisnikërie" (f. 248-249, autori M. B.) tek libri "Katër Grykët e Dibrës" (f. 14 dhe 236 i autorit të nderuar Qazim Prejsi), tek libri "Krenaria" e të talentuarit Hysen Dervishi, (në faqet 456, 457, 458). Ajo që m'u ngulit në mendje ishte fjala e mësuesit dhe nipit të Dervishajve, Nazif Bodini. *"Gëzuar dajë Hysen, më tha. Qofshin me faqe të bardhë edhe fëmijët tuaj, siç je ti dhe pasardhësit e tu", - tha nipi. U emocionova, u djersita, pak fjalë të* mëdha *tha nipi. Ajo fjalë ishte peshë e rëndë, që kërkon mendje të hollë... Sokoli erdhi më fshiu djersët, më puthi në ballë e pastaj tha ca fjalë, të zgjedhura që me ngrohën shpirtin (f. 495) (Me 70 vjetorin e autorit Hysen Dervishi, M.B.)*

Intelektual i fjalës së mençur, mësues, mjeshtër, veprimtar e organizator i kulturës, aktor i talentuar (Cekja i Dibrës), i përkushtuar si përgjegjës kulture, mendjemprehtë, me humor të këndshëm, therës e dashamirës, kurdoherë mirënjohës për shokët, fisin, miqtë, vlerat intelektuale, komunikues e fjalëpeshuar, i lidhur ngushtë me miqtë, me traditat e të parëve. Së bashku me bashkëshorten e nderuar Lirien, bijën e Valdetes (Vates) së Macukullit të Matit të barutit rritën dhe edukuan katër fëmijë, secilin më të mirë se tjetrin: Afërditën, Përparimin, Lefterin dhe Mentorin. Geni i Bodinit dhe nipa të Valdetes së krenarisë matjane e kombëtare. Udhët e dijes e të punës së Nazif Bodinit janë mall të përkushtimit, të mbijetesës përballë vështirësive e persekutimit çnjerëzor me iluzione për "njolla" në biografi, udhë të dashurisë për mësuesinë e kulturën në vendlindje e më gjerë.

Nazif Bodinit të Dibrës i flet kultura intelektuale, zgjuarsia e lindur i flasin provat në mësimdhënie në edukimin e brezave, arti i komunikimit prej mjeshtri të pedagogjisë, shpirti i punës, dashuria e provat për kulturën e popullit, për mësimin dhe edukimin e mësuesve, të cilat sot janë drita e atdhetarisë së Dibrës e të kombit.

Në prag të viteve 70-të Nazif e Hysni Bodini, Besim Ndregjoni, Fadil Ferhati më në krye regjisorin e mësuesin virtuoz Sami Shehu e Kumrie Shehu, morën çmimin e dytë në Republikë në takim në vatrën e humorit në Shkodër, në konkurrimin e estradave. Kushedi sa e sa herë në konkurrimet në zonë të Katër-Grykëve (Selishtë) e në Dibër janë duartrokitur aktorët e lindur për skenë Nazif e Hysni Bodini. Dy kushërinj të talentuar, dy mësues fisnikë e human, dy aktorë të rrallë të viteve 70-të. Edhe sot në rrethet shoqërore me çiltërsi i thonë veteranit të arsimit Nazif Bodini: Cekja i Dibrës.

Shembulli, përkushtimi, shpirti atdhetar, talenti prej mësuesi metodist të kulturës në zonë e mbi të gjitha mjeshtëria prej aktori të lindur, janë dëshmi e punës, përvojës, atdhetarisë, prova të një demokrati të vërtetë, që i shërben vendlindjes, arsimit, kulturës së brezave.

Nazif Bodinit të Dibrës i flet kultura intelektuale, zgjuarsia e lindur i flasin provat në mësimdhënie në edukimin e brezave, arti i komunikimit prej mjeshtri të pedagogjisë, shpirti i punës, dashuria e provat për kulturën e popullit, për mësimin dhe edukimin e mësuesve, të cilat sot janë drita e atdhetarisë së Dibrës e të kombit. E ritheksoj se ndjeva peshë të rëndë kur mora penën të thur këtë shkrim, të thjeshtë sepse për Nazif Bodinin mund të thuren balada, ese, poema e pse jo edhe monografi. Dekoratat më të mëdha të këtij intelektuali të vlerave janë në provat e jetës, të punës, të diturisë, të shëmbëllimit prej mësuesi, veprimtari, organizatori të kulturës, aktorit vital, dekoratat më të mëdha janë nderimi i brezave. Pra, cilido ndjen çudi kur në këtë jetë të shkurtër e provizore, nuk kujtohet para vdekjes i paharruar Sami Frashëri, ideologu, filozofi i Rilindjes i cili thoshte: *"Kur shteron pusi, i dihet vlera ujit"*.

Nazif Bodini, rrezaton me dritë diturie, arsimi e kulture. Një fisnik, një bir i shkrepave të Selishtes (Selishtjanët si gjermanët – autori M.B.).

Me siguri nëse Bashkia Dibër ose e Tiranës dhe Ministria e Arsimit e RSh, po të tregoheshin si shqiponja që shikon mizën mbi bar, do të skuqeshin, do të vepronin, do të nderonin të nderuarin e Dibrës e të kombit mësuesin, veprimtarin, aktorin e organizatorin e kulturës Nazif Bodini. E thjeshta, e bukura, e madhërishmja, është se Nazif Bodinit i flasin provat drita e diturisë, mirësitë e shpirti prej atdhetari e demokrati të vërtetë. Pra, këta janë dekoratat që rrezatojnë, janë ai mineral që thamë në fillim të këtij shkrimi. Me dritën e zemrës e të të vërtetës thurëm vargjet që burojnë nga dritësimi i këtij veterani virtuoz të arsimit të kulturës së brezave:

Gen lirie i Selishtjanëve
Ti je nipi i Dervishjanëve
Nip i Lukanit, nipi i Runjës
Or Bodin – dritë e fortunës

Mësues atdheu – demokrat
Shpirt lirie – hov shtrëngat'
Si valë Murre si valë Drini
N'breza je Nazif Bodini...

* * *

Urime biri i Selishtes së gurit, Selishtës (Katër-Grykëve) të pushkës, pendës e të flamurit! E thonë faktet, koha dhe e vërteta: Nazif Bodini mësuesi dhe veprimtari i kulturës së brezave. Edhe 100 vite të tjera nga sot veterani i arsimit dhe i kulturës!

Tetor 2019

PËRKUJTOHET 76 VJETORI I RËNIES SË DËSHMORIT AHMET CAMI





Me datën 18 tetor 2019 , ora 12.00, në sheshin e shkollës 9 vjeçare "Ahmet Cami" në Gjoricë të Sipërme u zhvillua ceremonia e 76 vjetorit të rënies së dëshmorit Ahmet Cami.

Në këtë ceremoni përkujtimore organizuar në kuadrin e 75 vjetorit të çlirimit të atdheut morën pjesë veteran dhe pasardhësit e veteranëve të LANÇ, nxënësit dhe mësuesit e shkollës "Ahmet Cami" Gjoricë dhe Shkollës "Fasli Cami" Viçisht, familjarë dhe të afërm të dëshmorit Ahmet Cami, drejtues të organizatës së veteranëve të rrethit, të komunës , drejtues të pushtetit vendor, qytetarë dhe banorë të Gjoricës , Shupenzës, Bulqizës, Peshkopisë , Dibrës së Madhe etj.

Morën pjesë gjithashtu kryetari i Bashkisë së Bulqizës Lefter Alla, Zv Prefekti i Qarkut të Dibrës Avni Muliu, Administratori i Njësisë Administrative të Gjoricës Ilir Rama, Kryetari i Komitetit të Veteranëve të LANÇ të Bashkisë së Bulqizës, Xhevat Jella, kryetari i Komitetit të veteranëve të LANÇ të Bashkisë Dibër, Alush Stojku etj.

Veprimtaria u drejtua nga Kryetari i organizatës së veteranëve të rrethit të Bulqizës Xhevat Jella. Drejtori i Shkollës 9 vjeçare "Ahmet Cami" Fatos Muha ja dha fjalën Kryetarit të veteranëve të Bulqizës Xhevat Jella, i cili foli për punën e kësaj organizate dhe për jetën dhe veprën e lavdishme të dëshmorit Ahmet Cami.

Më hollësisht mbi jetën dhe veprimtarinë e dëshmorit Ahmet Cami foli e bija e dëshmorit, Tefta Cami.

Në emër të Bashkisë së Bulqizë dhe të pushtetit vendor foli kryetari i Bashkisë së Bulqizës Lefter Alla, i cili ndër të tjera tha se është i lumtur që ndodhet në këtë ceremoni përkujtimore për të shprehur konsideratat për këtë figurë të shquar të LANÇ të zonës, për komandantin e çetës së Gollobordës, Ahmet Camin.

Bibliotekës së shkollës 9 vjeçare "Ahmet Cami" ju dhuruan libra të autorëve dibranë dhe të Gjoricës mbi jetën e dëshmorit Ahmet Cami dhe të dëshmorëve të tjerë.

Në fund Shkolla 9 vjeçare Gjoricë në bashkëpunim me Qendrën Kulturore të Bulqizës dhanë një koncert artistik me këngë e valle patriotike, ku me interes u ndoq kënga kushtuar dëshmorit Ahmet Cami me tekst e muzikë të Xhevdet Dacit dhe e interpretuar nga Hajri Alimani.

NASLIJE MULIA

profil

Për përkushtimin maksimal ndaj shëndetit të fëmijëve, dr. Filipi është bërë një ndër figurat publike më të adhuruara në qytetin e Peshkopisë.

Dr. Filip Cfarku, *themelues i reanimacionit pediatrik bashkëkohor* **në Spitalin Rajonal të Dibrës**

Nga **RAMAZAN BUCI***



Rastësisht, duke parë një dokumentar mbi Mustafa Qemal Ataturkun, kur historiani tha se prindërit e tij kishin origjinën nga Stebleva, në mënyrë reflektore, mendja më shkoi tek kolegu dhe shoku im i ngushtë, dr. Filip Cfarku, i cili, gjithashtu, është nga ky vend i bukur dhe piktoresk. Një ditë, duke biseduar në telefon me dr. Filipin për personalitetin e spikatur shkencor dhe njerëzor të dr.Qemal Çadrit, për sensibilizimin dhe promovimin e kësaj ikone të mjekësisë dibrane, i cili duhet të ishte dekoruar kohë më parë si "Qytetar Nderi" i Bashkisë së Dibrës, unë e përgëzova sinqerisht për cilësitë e tij intelektuale. Ai flakë për flakë m'u përgjigj me një batutë pikante me konotacion humoristik: "Ti gjithmonë më ke nënvleftësuar mua, por edhe unë bëj ndonjë punë të mirë". Në moment, pasi me një shpejtësi të rrufeshme më shkojnë nëpër mendje tërë ngjarjet dhe historitë me eminente të punës e të jetës dhe iu përgjigja: "Nuk është e vërtetë, përkundrazi, ti bën shumë punë të mira dhe për këtë unë kam menduar të shkruaj një ese për ty."

Këtë shkrim po e bëj si "Ese mbi dr. Filipin", sepse duke qenë më i ri se shokët e mi të tjerë, nuk kam pasur rastin të mbaj ndonjë fjalë në ndonjë event të tij. Gjithashtu, eseja,përveç një soditje kritike artistike, mund të jetë një reflektim i shkurtër, që përputhet me atë të një letre, një artikulli apo tregimi të shkurtër, që në rastin konkret ka karakterin e një eseje joformale, e karakterizuar nga elemente personale, shijet dhe përvojat individuale, konfidenciale, humori dhe stili i këndshëm. Woodi Allen thotë: "Tetëdhjetë për qind e suksesit është të dukesh" Dr. Filipi është e kundërta e kësaj thënie. Atë do ta karakterizonte më së miri thënia e Albert Einstein: "Përpiquni jo të jeni një sukses, por që të jeni një vlerë". Të shkruash për dr.Filipin është e thjeshtë dhe e vështirë njëkohësisht. Është e thjeshtë, sepse aktiviteti i tij jetësor, profesional dhe menaxheria është i gjerë dhe intensiv, por është e vështirë për shkak të karakterit dhe personalitetit të tij kompleks dhe ndoshta unikal në Spitalin Rajonal të Dibrës. Për të njohur karakterin e njeriut duhet një kohë e gjatë, sepse ka njerëz që mbajnë maska dhe në momentin që mbase pa dashje i "shkel në kallo", shumë shpejt ajo maskë griset dhe ti je përballë dikujt që të duket i panjohur. Aq më tepër që jetojmë në një kohë që ka më shumë maska, sesa fytyra të vërteta. Për mbi 30 vjet njohje me dr. Filipin kanë spikatur gjithmonë elemente pozitiv të personalitetit si gjakftohtësia, vetëkontrolli i vazhdueshëm, besimi në vetvete, origjinaliteti, ndjenja e realitetit dhe e humorit të hollë. Dhe personaliteti nuk mund të fshihet.



Dr. Filip Cfarku shquhet për konstruktivitet, kompetencë dhe rezultate të admirueshme. Por krahas punës me pacientët e vegjël dhe asaj drejtuese, ai nuk e ka ndërprerë për asnjë moment dhe punën shkencore, duke marrë pjesë si referues me temat me problematikë në të gjitha sesionet shkencore të zhvilluara për pediatrinë në Tiranë, Peshkopi dhe në Dibër të Madhe, pa përjashtuar programin e Ministrisë së Shëndetësisë për Edukimin në Vazhdim.

Nëse ke të meta, të tjerët do t'i vënë re. Nëse nuk i ke cilësitë pozitive nuk mund t'i shfaqesh në marrëdhënie me të tjerët, t'i ndjejnë ato. Napoleoni ia dedikon gjithë madhështinë dhe joshjen e tij faktit se ai realizoi plotësisht personalitetin e tij. Dr. Filipi e ka fituar një superioritet të tillë moral dhe intelektual dhe kushdo që i afrohet e ndjen këtë dhe mund të mos e harrojë kurrë. Por për një njeri me integritet si dr.Filipi, karakteri dhe personaliteti nuk mund të mos harmonizohen me dijen.

Dr. Filipi mbaron Fakultetin e Mjekësisë si një student ekselent, por jo si disa studentë ekselente të sotshëm, që për të realizuar qëllimin e tyre kompromentojnë pedagogët dhe spekulojnë me të drejtën e autorit nëpërmjet internetit dhe teknologjisë bashkëkohore. Rezultatet e shkëlqyera të tij ishin të lidhura me studimin sistematik pesëvjeçar, përkushtimit në praktikat mësimore spitalore, intuitës profesionale dhe inteligjencës së tij të admirueshme. Pas disa vitesh punë në krahinën e tij dërgohet në specializimin 3 vjeçar për reanimator pediatër në QSUT, të cilin gjithashtu e përfundon me rezultate të shkëlqyera. Por përgatitja teorike sado e lartë që të jetë, është e pavlefshme në qoftë se reflektohet në praktikë, në jetë, në rezultatet e mjekimit dhe parandalimit të sëmundjeve të pacientëve. Prandaj dr. Filipi sapo emërohet shef i reanimacionit të pediatrisë, fillon punën intensivepër themelimin e këtij shërbimi të domosdoshëm në Spitalin Rajonal të Peshkopisë, pasi nr. i fëmijëve të shtruar në periudha epidemish kalonte shifrën 120 dhe rastet e shumta të gjendjeve të rënda ishin shumë problematike.

Dr. Filipi me vendosmërinë e tij, në bashkëpunim me drejtorin e spitalit të asaj kohe, ndërtojnë strukturën dhe mjediset e reanimacionit, sigurojnë pajisjet e duhura si inkubator, instrumentet e nevojshme të manipulimeve mjekësore, emërojnë numrin e duhur të personelit mjekësor të cilat bëjnë trajnimin e posaçëm etj., dhe kështu për herë të parë në Spitalin Rajonal të Dibrës filloi funksionin reanimacioni pediatrik bashkëkohor që drejtohej nga një specialist ekselent, i denjë të punonte në Spitalin Universitar. Kushdo që e kontaktonte dr. Filipin vinte re komunikimin e kulturuar, seriozitetin, përkushtimin në punë, etikën mjekësore me kolegët dhe infermierët dhe kompetencën profesionale. Nuk kishte protokoll dhe manipulim mjekësor që të bëhej në QSUT dhe të mos bëhej nga dr. Filipi, duke përfshirë injeksionet në venën subclavia, drenimin dhe mjekimin e empiemes pleurale etj., që deri atëherë nuk bëheshin.

Në këtë reanimacion mjekoheshin me sukses gjendje shumë të rënda si gjendje të shokut toksik, pneumoni masive, sindromi Waterhouse Frederichsen, sindromi uremik hemolitik, miocarditacut etj., etj... për shkak të të cilave jo rrallë detyrohej të qëndronte non stop në spital 24 - 48 orë. Në atë kohë, për profesorin e nderuar të kardiologjisë në QSUT, Spiro Qirko, qarkullonte një anekdotë që thoshte se ai ishte martuar me kardiologjinë, pasi doli në pension pa u martuar. Por dr.Filipi, pavarësisht ngarkesës së madhe në punë, në kohën e duhur gjeti njeriun e zemrës dhe sot vazhdojnë të rrisin, edukojnë dhe shkollojnë dy fëmijë të mrekullueshëm. Në punën e tij si shef i reanimacionit, përveç energjisë së tij pozitive dhe aftësisë profesionale, spikati dukshëm edhe aftësia drejtuese dhe menaxheriale. Për këtë arsye ai emërohet shef i shërbimit pediatrik dhe për të njëjtën arsye me vonë nëndrejtor teknik i spitalit, pa lënë pas dore punën e reanimatorit.

Në të dyja këto detyra ai shquhet për konstruktivitet, kompetencë dhe rezultate të admirueshme. Por krahas punës me pacientët e vegjël dhe asaj drejtuese, ai nuk e ka ndërprerë për asnjë moment dhe punën shkencore, duke marrë pjesë si referues me temat me problematikë në të gjitha sesionet shkencore të zhvilluara për pediatrinë në Tiranë, Peshkopi dhe në Dibër të Madhe, pa përjashtuar programin e Ministrisë së Shëndetësisë për Edukimin në Vazhdim. Gjithashtu, dr. Filipi ka qenë pedagog i lëndës së Pediatrisë gjatë gjithë kohës që ka funksionuar Shkolla e Infermierisë në qytetin e Peshkopisë. Për përkushtimin maksimal ndaj shëndetit të fëmijëve, që janë bukuria më e madhe që Zoti u ka falur prindërve, për aftësinë, besueshmërinë, ndjeshmërinë, simpatinë për të sëmurin, vërtetësinë dhe integritetin e tij, dr. Filipi është bërë një ndër figurat publike më të adhuruara në qytetin e Peshkopisë.

** Mjek pediatër, Dr.i Shkencave Mjekësore*

Rruga e Arbërit nr. 162
gjenezë

**Kronologja e fisit Murrja,
në Luzni të Dibrës"**

Origjina dhe gjeneza **e fisit Murrja**, në Luzni, të Dibrës

Nga **ARIF MURRJA, XHELADIN MURRJA, ILMI MURRJA**

MONOLOG

Studimi kronologjik i historisë së fisit Murrja ka qenë një ide e kahershme. Indicja ka lindur që kur xhaxhi im, i ndjeri Ibrahim Murrja më fliste me pasion për lavdinë e paraardhësve. Pas shumë orvatjeve në më shumë se dy dekada në mbledhjen e gojëdhënave, të toponimeve, të burimeve folkloriko-historike; dhe pothuajse "i dorëzuar", te mësuesit e tjerë të sojit Murrja, Xheladini dhe Ilmiu, gjeta "trungun dhe degët" e pemës gjenetike të fisit tonë.

Ne startuam me "Origjinën dhe gjenezën e fisit Murrja", si pjesë e parë e studimit me temë: "Kronologja e fisit Murrja, në Luzni të Dibrës". Fjala e urtë e popullit thotë: -Më mirë vonë se kurrë. Ftesa e bashkëpunimit është për këdo dhe cilido. Punë ka shumë dhe rruga është shumë e gjatë. Vend ka për të gjithë dashamirësit dhe studiuesit e historisë së Luznisë e të Dibrës. Bashkimi bën fuqinë! Në shkencë thuhet:-Të dhënat sasiore të çojnë (shpien) në vlerësime cilësore.

I -NJOHJA ME PROBLEMIN

Murrja është fis i dëgjuar në Luzni, Dibër e më gjerë. Për atdhetarët, për dëshmorët dhe për të mençurit e fisit Murrja është folur dikur në mexhelise (oda) e flitet sot në takime informale midis luznakve e dibranve, por shumë pak është shkruar nga studiues të historisë. Mbizotëron e lavdishmja, por fisi ka patur dhe peripeci. Edhe përse ngjarjet e pahijshme nuk janë as, sa gishtërinjtë e njërës dorë, ne do t'i evedintojmë ato, jo vetëm për "syrin e keq", por edhe për t'i "mbyllur gojën" kritikës.

Pika referuese kohore që lidh të panjohurën me të njohurën e fisit Murrja është viti 1882. Në vjeshtën e këtij viti në fshatin Trenë u vra nga ushtarët turq, Kreu i Luznisë, Isuf Murrja (Frashëri, 2012). Pas disa ditësh Dauti me vëllezër, kushërinjë, luznakë e dibranë mori hakun e babait, duke organizuar një luftë të përgjakshme në vendin e quajtur Qenok (midis fshatit Trenë dhe qytetit Peshkopi). Ngjarja beri jehonë! Murrja shkruajti emrin në historinë e Dibrës dhe historinë e Shqipërisë.

Nëpërmjet Isufit orjentohemi lehtësisht para dhe pas tij. Dy brezat paraardhës janë i ati Elezi dhe gjyshi Halili, të dy atdhetarë të shquar të Luznisë. Më përpara studimi vështirësohet, por për të hulumtuar origjinën dhe gjenezën e fisit Murrja jemi bazuar në gojëdhëna, në toponime dhe në tradita zakonore. Periudha pas Isufit është më e lehtë sepse spikasin kushëriri i tij Ahmeti, pesë djemtë e tij me në krye Dautin; spikasin niprit e tij, Myftari I (përfaqësues i Luznisë në Kuvendin e Maleve të Dibrës te Gurra e Mazhicës në vitin 1910) dhe Elezi II të vrarë të dy në luftë me serbët; sipkasin stërnipit e tij Xhetani I, i vrarë në luftë me serbët dhe Veseli I që fitoj të drejtën e "pleqësisë" në Dibër dhe më gjerë. Më vonë spikat Sadik Murrja si një nga "paritë" e Luznisë në kohën e Mbretit Zog.

Objektivi i studimi është gjetja e lidhjes së fisit Murrja me fisin Lika dhe cila është origjina fillestare; ndërsa qëllimi i studimit është evidentimi kronologjik i origjinës (prejardhjes), gjenezës (lindjes si fis më vete), retrospektivës (të kaluarës), të të tashmes dhe sa i moçëm (i vjetër) është fisi Murrja. Pika e dobët e studimit është pamundësia e hulumtimi antroplogjik. Analiza e ngjashmërisë së normave zakonore me vendin e origjinës nga Kastrati, të fisit Murrja dhe fiseve të të njëjtit gjak me Murren është sipërfaqësore. Një studim i tillë kërkon kohën dhe ekspertizën e fushës, ndaj mund të shërbejë si apel për hulumtuesit e rinjë në të ardhmen.

II -BALLAFAQIMI I STUDIMIT ME LITERATURËN

Çdo fis ka një legjendë të caktuar për prejardhjen e vet (Durham 1900). Gojëdhëna apo legjenda është tekst rrëfyes nga goja e popullit, i cili u kushtohen personave ose dukurive që ndodhin apo kanë ndodhur dhe që këta persona apo dukuri kanë lënë gjurmë në jetën e një komunitetit apo shoqërie njerëzore. Në këto tregime dhe ndodhitë e gjithë personazheve apo aftësitë e personave prezantohen si legjenda (fuqi mbi natyrore apo mite) mirëpo lidhen me ndonjë të vërtetë, ç'ka tregon se si njerëzit e kanë ndierë efektin e atij personi apo asaj dukurie (Wikipedia).

Personazheve të legjendave u janë thurur dhe kënduar këngë folklorike nga populli. Folklori është tërësia e krijimeve artistike (gojore, muzikore, vallet etj.), ndërsa rapsodia është këngë popullore legjendare, trimërie, kreshnikësh, që është krijuar nga një rapsod me temë nga ngjarjet e mëdha të jetës (fjalori. shkenca.org.). Për herë të parë folklori dibran është hulumtuar nga Haki Stërmilli (1944 dhe 1966). Më vonë në vitin 1983 Hazis Ndreu ka shkruar "Tregimet alegorike dibrane" (Kolgjegja, 1990); ku, ndër të tjera ka pasqyruar edhe këngën folklorike të Isuf Murres. Parë në kontekstin e këndimit profesional kënga e Isufit është vënë në skenë për herë të parë nga rapsodi Hazis Ndreu, më pas nga artisti i merituar Skënder Cala dhe së fundmi nga këngëtari i shquar Arif Vladi. Për folklorin e fisit Murrja, fshatit Hotesh dhe krahinës Luzni, kanë shkruajtur Hilmi Kolgjegja (1990), Ibrahim Murrja (2015) dhe Emrie Skuka Mera (2018).

Indikatorë që ndihmojnë origjinën dhe lidhjet gjaksore të fisit Murrja janë toponimet. Toponimia është tërësia e emrave, e vendeve, të krahinave, të qyteteve, të fshatrave, të lumenjve, të përrenjve, të maleve, të arave etj. (fjalori. shkenca.org.). Emërtimet Lagja Like, Kodra e Halilit, Ara e Elezit, Kodra e Hasanit, Limane, Ara dhe Kroi i Danit, Kroi i Tafës, Kroi i Murre, Fusha e Skuke, Kroi i Skuke e shumë e shumë të tjera lidhen organikisht me gjenezën e fisit Murrja.

Argumente të tjera shkencorë janë tradita dhe normat zakonore. Tradita është pasuri shpirtërore, pikëpamje, zakone, virtyte etj., që janë formuar historikisht në jetën e një populli dhe që ruhen, trashëgohen e zhvillohen më tej si një thesar i çmuar nga njëri brez në tjetrin (fjalori.shkenca. org). Xhaferr Martini (2003) në librin e tij "Kanuni i Dibrës" në nenin "Martesa" dhe posaçërisht nën-nenin "Gruaja e ve", sjell precedentin e gruas soj nga Murrja i Luznisë. Vajza ishte martuar me Sulën, djalin e Llan Kaloshit në Kandër. Ai vritet me pahirë dhe e la gruan me një cucë të vogël shtatë vjeçe. Autori Martini citon: Nusja e Sulës ishte bijë ke Murrja në Luzni, soj ku kishte le e soj ku kishte ardhë. Djemtë e Llanit thanë se nusen e Sulës e kishin motër e kshtu do ta kishin sa jeta. Po ajo duhej nxjerrë prej shpie se Kaloshët nuk i mbanin gratë e njeni-trjerit (Martini, 2003:125). Ajo u kthye te prindërit dhe nuk pranoi të martohej. Më pas u kthye te Kaloshët për të rritur vjazën. Lan Kaloshi e bani zonjë shpie nusen e Sulës. Ajo rriti jo cucën e vet, po u ba nana e të gjithë fëmijëve të shumtë të Kaloshve (Martini, 2003:126). Gjithashtu Edith Durham në librin e saj "Brenga e Ballkanit" përshkruan mënyra e ndërtimit të shtëpive dhe normat zakonore të jetesës në Kastrat të Malësisë së Madhe. Arkitektura e shtëpive dhe normat zakonore janë të ngjashme dhe të njëjta me paraardhësit e fiseve të një gjaku Murrja, Dedja, Demiri, Neziri, Skuka, Stafa dhe Sula.

III -PYETJET KËRKIMORE

Studimi është fokusuar në katër pyetje. Pyetjet janë:(i) Cila është origjina e fisit Murrja? (ii) Cilat fise në Luzni, janë të një gjaku me fisin Murrja?(iii) Cila është gjeneza e fisit Murrja? (iv) Sa i moçëm (i vjetër) është fisi Murrja në Luzni?

IV -METODOLOGJIA E KËRKIMIT SHKENCOR

Së pari, është bërë analiza deskriptive (përshkruese) e gojëdhënave, e burimeve folkloriko-historike dhe e normave zakonore. Përzgjedhja e banorëve për të "vjelur" burimin gojëdhënor (intervista) është bazuar në metodën e vlerësimit cilësor me fjalë dhe ngjyra. "Filtrimi" i individëve është bazuar tek pasioni, intelekti, besimi dhe arsimimi (Shikoni Tabelën 1.1).

Indikatorët e vlerësimit	Vlërsim i lartë	Vlerësim i mesëm	Vlerësim i ulët
Pasioni	I lartë	I mesëm	I ulët
Intelekti	I lartë	I mesëm	I ulët
Besimi	I lartë	I mesëm	I ulët
Arsimimi	I lartë	I mesëm	I ulët

Tabela 1.1 –Vlerësimi cilësor i intervistuesve (Burimi: Arif Murrja)

Shkurtimisht dimensioni shkencor i secilës: Pasioni është ndjenjë e fuqishme, e thellë dhe e qëndrueshme, që shfaqet me vrull dhe që përcakton sjelljen e veprimtarisë e njeriut; intelekti është aftësia mendore për të arsyetuar e për të gjykuar, është forca e arsyes a e gjykimit; dhe besimi është bindje e fortë se diçka është e vërtetë ose se do të kryhet patjetër; ndjenja e sigurisë për dikë që ka merita e veti të larta, bindje në çiltërsinë, në ndershmërinë e në ndërgjegjen e dikujt (fjalori.shkenca.org).

Së dyti, është bërë evidentimi empirik i toponimeve dhe i normave zakonore.

Së treti, është përcaktuar etaloni i matjes së periudhës së studimit. Njësi e matjes kohore është "brezi biologjik". Fjala brez ka shumë kuptime, por jemi lokalizuar në konceptin biologjik të saj, ku: (i) brezi përfshin "të gjithë njerëzit që lindin dhe jetojnë në të njëjtën kohë"; (ii) brezi është "periudha mesatare", e cila përgjithësisht konsiderohet të jetë rreth tridhjetë vjet, gjatë së cilës fëmijët lindin, bëhen të rritur dhe fillojnë të kenë fëmijë të tyre" dhe (iii) në terminologjinë e farefisnisë, është një term strukturor që përcakton marrëdhënien prind-fëmijë (fjalori.shkenca.org). Duke filluar nga brezi i tanishëm (1991-2020) kemi gjetur origjinën e fisit Murrja.

Së katërti, algjebrikisht jetëgjatësia apo mosha e fisit është llogaritur si shuma e të gjitha brezave nga sot e deri tek origjina. Formula e llogaritjes është:

$$Ag = g_1 + g_2 + g_3 \cdots g_n \quad (1.1)$$

$$A_g = \sum g_n \quad (1.2)$$

$$A_g = n * g \quad (1.3)$$

Ku, $\boldsymbol{A_g}$-është mosha ose jetëgjatësia e fisit; ***g***-brezi biologjik i barabartë me 30 vite dhe ***n***-numëri i brezave.

V -ANALIZA SHKENCORE E STUDIMI

-Analiza e gojëdhënave

Në një shtrirje kohore prej më shumë se dy dekada, kemi intervistuar banorë të Luznisë për të mbledhur gojëdhëna. Banorët e intervistuar janë me dhjetra, por duke u bazuar në "filtrat" e përzgjedhjes (pasioni, intelekti, besimi dhe arsimimi), numrin e gojëdhënave e kemi reduktuar. Banorët e intervistuar janë:

(i) Bashkim Dedja (49 vjeç) nga fshati Katundi i Ri

Duke diskutuar për origjinën e përbashkët, thotë:-Që i vogël babai dhe gjyshi më kanë folur për origjinën e fisit Dedja. Sipas tyre (gjyshit dhe babait) Lik Kastrati është i pari, i fiseve Dedja, Demiri, Neziri, Murrja, Skuka, Stafa dhe Sula. Ai kishte migruar bashkë me vëllain nga Kastrati i Malsisë së Madhe dhe fillimisht ishin ndaluar në Has. Më vonë Lika kishte lëvizuar drejt Dibrës dhe ishte vendosur përfundimisht në Lishan të Epërm. Troja edhe sot quhet Lagja Like. Gjithashtu shton dhe faktin, se i pari i fisit Dedja ka qenë "Dervish" teolog bektashi.Gojëdhëna është trashëguar nga stërgjyshi dhe katragjyshi.

(ii) Ilmi Murrja (59 vjeç) nga fshati Lishan i Epërm (bashkautor)

Sipas gojëdhënavë babai dëshmonte se i pari fisit ka qenë Lik Kastrati nga fisi i dëgjuar në Malësinë e Madhe në Shkodër, ndërkohë ruante në memorje legjendën vendase për martesën e Skuk Likës. Thuhet se Skuk Lika i rënë në gjak (hasmëri) kishte dal në pazar për të shitur një mushkë (kafshë pune). Kishte hyrë në pazar me një person nga Katër-Grykët, saktësisht nga Qaf-Murra, i cili i thotë që nuk kam lira për të të dhënë, por kam një çikë për martesë, ku dhe unë jam në gjak e të bëhemi miq. Pasi mori mushkën kaluan një apo dy vite dhe miku nuk u duk. Atëherë Skuk Lika mblodhi të afërmit e tij dhe vajti të marrë çikën (nusen e tij) me forcë. U nisën natën dhe rrethuan vendin.

Në mëngjesë cuca doli në mal për të kullotur bagëtitë. Në brez mbante për mbrojtje një llojë shpate që quhej "klleç". Tentuan t'i afroheshin por qentë nuk i linin. Çika u thirri qenëve që të pushonin dhe i pyeti se cilët ishin. Për momentin ato heshtën dhe baresha i pyeti përsëri, -mos jeni ato të mushkës. I pari i tyre u përgjigj: -Po ne jemi. Në atë moment ajo kërkon kumbarën, i cili konsiderohej si vëllai i saj në fshatin e burrit. Pasi i prezantuan kumbarën, baresha u ndërron drejtimin bagëtive duke i kthyer në shtëpi dhe ju thotë ecni para, se unë do vij më vëllain (kumbarën). Cuca e Qaf-Murre e martuar me Skuk Likën në Luzni thirrej me emrin Murrja. Ajo lindi dy djem Halilin dhe Osmanin. Ishte "ulkonjë" për punë, shkonte me kal për dru, punonte tokën me qe, mbillte, prashiste e mblidhte të mbjellat etj. Edhe kur prashiste ajo mundej të ushqente djemtë me qumështin e gjirit. Për shkak të famës së saj djemtë trashëguan mbiemrin Murrja.

(iii) Ibrahim Murrja (1937-2015) nga fshati Hotesh

Babai i Skuk Likës kishte ardhur nga Hasi. Skuka mori për grua të dytë, një cucë nën gjak nga Qaf-Murra, mbesa e fisit Vladit në Lurë, që ishte shumë i dëgjuar për të drejtën zakonore në Dibër e Mirditë. Ajo lindi dy voca Halilin dhe Osmanin. Thirrej Murrja për shkak të origjinës dhe ishte "ulkonjë". Djemtë nuk i ndante në asnjë moment nga vetja e saj, sa që i mbante edhe mbi ngarkesën e druve, të krandeve (shkrapave), të bereqetit (prodhimeve bujqësore) dhe arrinte t'i ushqente me qumështin e gjirit. Kështu Halili dhe Osmani morën mbiemrin Murrja. Halili për shak të një ngatërrese me të ëmën u zhvendos në Hotesh. Vendi ku ai ndërtoi shtëpinë edhe sot quhet Kodra e Halilit.

(iv) Musa Murrja (1928-2008) nga fshati Selane

Është njëri nga djemtë e të shquarit Vesel Murrja, i cili kreu me sukses misionin e "Plakut" të trashëguar nga i ati. I ndjeri Musa Murrja trashëgonte cilësitë e të atit, shumë i qetë dhe fliste shumë pak ose siç thotë populli "pak dhe sak". Sipas tij, cuca nga Qaf-Murra lindi dy djem Halilin dhe Osmanin. Halili u lidh me qeverinë e kohës, ndërsa Osmani qëndroi në Lishan të Epërm. Më vonë Halili u vendos në Hotesh dhe troja, ku ai është vendosur edhe sot quhet Kodra e Halilit. Të gjitha i kishte dëgjuar nga i ati, Veseli, të cilit do t'i kushtohet një artikull i veçantë.

(v) Nuri Murrja (75 vjeç) nga fshati Selane

Sipas tij origjina e fisit është nga Hasi (E. Skuka, 2018:321).

(vi) Sali Demiri nga fshati Lishan i Epërm

Që kur isha në shkollë të mesme ai më tregonte për origjinën e përbashkët të fiseve tona.

(vii) Maliq Skuka (mbi 100 vjeç) nga fshati Hotesh

I lindur para vitit 1900, i cili jetoj mbi 100 vjeç, thoshte: -Origjina e fisit është nga Kastrati i Shkodrës (E. Skuka, 2018:321).

(viii) Skënder Murrja (68 vjeç) nga fshati Hotesh

Duke diskutuar për fisin Murrja, pranon se ka dëgjuar versionin e qëndrimit për pak kohë të paraardhësit të parë në Has dhe të ardhjes e vendosjes përfundimtare në fashtin Lishan i Epërm. Gjithashtu ka dëgjuar nga paraardhësit se mbiemri është origjina e cucës nga Qaf-Murra e martuar me një Lika nga Lishani i Epërm, e cila ka lindur dy djem Halilin dhe Osmanin.

(ix) Xheladin Murrja (71 vjeç) nga fshati Selane (bashkautor)

Duke punuar për studimin, deklaron pothuajse të gjitha gojëdhënat e mësipërme dhe ka të memorizuar informacionin e plotë të pemës gjentike të linjës së Halilit në Hotesh. Gjithashtu ka "konservuar" në mënyrë të shkëlqyer shumë ngjarjeve të fisit Murrja nga i ati Jahja, që janë të panjohura për studiuesit dhe do t'i preantojmë në vijmësi.

V_o: Në lidhje me vlerësimi e arsimimit "i ulët ose i mesëm" sqarojmë se për periudhën ku zhvendosemi nuk ka patur mundësi studimi.

-Analiza e normave zakonore

Në traditën e Dibrës edhe përse kalojnë me dhjetra breza, pasardhësit e të njëjtit fis nuk martohen me njëri-tjetrin. Të qenurit të të njëjtit gjak Lika, të fiseve Dedja, Demiri, Murrja, Neziri, Skuka, Stafa dhe Sula e vërteton fakti i mos martesave apo mos miqësive midis tyre.

Origjina e fisit Murrja dhe e fiseve vëllezër Dedja, Demiri, Neziri, Skuka, Stafa, Sula është nga fisi i dëgjuar Kastrati i Malsisë së Madhe në Shkodër.

Emër Mbiemër	Viti i lindjes	Psioni	Intelekti	Besimi	Arsimimi
Bashkim Dedja	1970-	I lartë	I lartë	I lartë	I lartë
Ilmi Murrja	1960-	I lartë	I lartë	I lartë	I lartë
Emrie Skuka	1957-	I lartë	I lartë	I lartë	I lartë
Skënder Murrja	1952-	I lartë	I lartë	I lartë	I lartë
Xheladin Murrja	1949-	I lartë	I lartë	I lartë	I mesëm
Nuri Murrja	1943-	I lartë	I lartë	I lartë	I ulët
Ibrahim Murrja	1937-2016	I lartë	I lartë	I lartë	I mesëm
Sali Demiri		I lartë	I lartë	I lartë	I mesëm
Musa Murrja	1928-2008	I lartë	I lartë	I lartë	I ulët
Maliq Skuka	1900-2000	I lartë	I lartë	I lartë	I ulët

Tabela 1.2 -Vlerësimi cilësor i të intervistuarve (Burimi: Arif Murrja)

Të qenurit "vllallik" të fiseve Murrja e Skuka e vërteton ekspansioni i tyre gjeografik në fshatin Hotesh. Përse Murrja me Skukën? Logjika e thjeshtë është vllazëria e tyre. Vllaznia është evidente edhe sot. Ato ftohen apo thirren në ceremonitë e tyre të gëzimit apo të hidhërimit si vllazni.

Përveç gojdhënës, hamendësimin e origjinës së fisit Murrja nga fisi dhe fshati me të njëjtin emër Kastrat e bazojmë në traditat dhe normat zakonore të ngjashme. Analiza fukusohet te ndërtimi i shtëpive dhe te normat kanunore të sjelljes. Edith Durhami kur shkruan për Hotin, Grudën, Kastratin, Shkrelin dhe Kelmentin citon: "Shtëpitë, janë prej guri me çati tejgullash. Kati i poshtëm është ahur. Dhoma e ndenjes lartë ka një shkallë të jashtme prej guri ose dërrase. Shtëpia ka pak dritare të vogla. Kjo arkitekturë konstatohet tek të gjitha kullat e fiseve Dedja, Demiri, Murrja, Neziri, Skuka, Stafa e Sula. Argumenti tjetër është ngjashmëria e normave kanunore, si për shembull: gruaja nuk përgjigjet për gjakmarrjen, përjashtuar rastin kur ajo don të përfshihet; martesat janë në dorë të kryefamiljarit; fëmijët mund të fejohen që foshnje apo pa lindur; vetëm vajza që nuk martohet trashëgojnë tokën; gruaja blihet; anagazhimi me shumë punë i gruas etj. (Durham, 1991:113-125).

-Analiza e toponimisë

Empirikisht kemi konstatuar dy burime toponimike. Toponimi i parë lidhet me Lik Kastratin dhe toponimi i dytë lidhet me Halil Murren. Vendi apo troja ku është vendosur Lik Kastrati në fshatin Lishan i Epërm, në Luzni edhe sot quhet Lagja Like (Shikoni Fig. 1.1). Në këtë lagje jetojnë aktualisht pasardhës të fiseve Dedja, Demiri, Neziri, Murrja, Skuka, Stafa dhe Sula.



Figura 1.1 -Lagja Like (topnim) në fshatin Lishan i Epërm, Luzni (Burimi: Foto e realizuar nga Ilmi Murrja)

Nga fshati Lishan i Epërm, disa nga pasardhësit e fisit Dedja janë zhvedosur në fshatin Katundi i Ri, disa të fisit Demiri janë zhvendosur në fshatin Arap të Poshtëm dhe disa të fiseve Murrja e Skuka janë zhvendosur në fshatin Hotesh e më vonë në fshatin Selane. Vendi ku është stacionar Halil Murrja edhe sot quhet Kodra e Halilit (Shikoni Fig. 1.2).



Figura 1.2 -Kodra e Halilit (toponim) në fshatin Hotesh, Luzni (Burimi: Foto e realizuar nga Labinot Murrja)

-Analiza historike

Hulumtimi historik mbi origjinën fillestare të fisit Murrja nga fisi Kastrati në Malësinë e Madhe është i pamundur. Por edhe vet fisi Kastrati, si të gjitha fiset e tjera, kanë hyrë në testamentin e shkencës historike nëpërmjet gojëdhënave apo legjendave. Në regjistrat veneciane të vitit 1403, gjejmë të përmendur (Capo) kryetar Aleks Kastrati, në krye të listës të shpërblyesve nga Venediku. Emri Kastrat shënohet edhe në vitet 1416-1417 në kadastrat e Venedikut, si dhe në hartat e Portës së Lartë, mbas pushtimit osman në vitin 1485. Një dokument tjetër shënon se Kastrati kishte 800 frymë në vitin 1628. Meqë Kastrati ka qenë fis i madh dhe shumë i dëgjuara në Malsinë e Shkodrës, gjykojmë se ka patur "uri" dhe "etje"për t'u zgjeruar. Duke u bazuar në "teorinë e lojës" logjikisht mendojmë se ikja e vëllezërve Kastrati, ku njëri ndalon në Has dhe tjetri shtegton për t'u vendosur në Luzni të Dibrës është arsyeja e ekspansionit gjeografik. Faktin e shtegtimit të tijë e mbështesim në ekistencën e sotme të degëzimit Kastrati në Has.

VI –DISKUTIMI SHKENCOR I STUDIMIT

Pas trajtimit metodik shkencor të gojdhënave, të burimeve folkloriko-historike, të normave zakonore, e të toponimeve; ju prezantojmë tërësinë e mendimeve dhe pikëpamjeve në përgjigje të pyetjeve kërkimore të ngritura në fillim të studimit.

Pyetja 1: Cila është origjina e fisit Murrja?

Të parët e fisit Murrja, janë fisi Lika. I pari i këtij fisi quhej Lik Kastrati, i ardhur nga fisi dhe fshati me të njëjtin emër, Kastrat i Malsisë së Madhe, në Shkodër. Lik Kastrati ka migruar (ikur) nga vendlindja bashkë me vëllain, i cili ka preferuar të ndalohej në Has, ndërsa ai ka ardhur dhe është vendosur në fshatin Lishan i Epërm në Luzni të Dibrës (Shikoni Fig. 1.3).




Figura 1.3 –Origjina, shtegtimi dhe vendosja në fshatin Lishan i Epërm në Luzni të Dibrës (Burimi: Arif Murrja)

Pyetja 2: Cilat fise në Luzni, janë të një gjaku me fisin Murrja?

Për arsye të ekstensionit gjeografik apo të traditës së kohës, pasardhësit trashëgonin si mbiemër, emrin e babait. Sipas kësaj logjike djemtë e Lik Kastratit trashëguan mbiemrin Lika. Ata ishin Ded Lika, Demir Lika, Nezir Lika, Skuk Lika, Staf Lika dhe Sul Lika (renditja është alfabetike). Sot troja (vendi) ku është vendosur Lik Kastrati quhet lagja Like. Duke ndjekur logjikën e trashëgimit të atësisë si mbiemër lindën fiset Dedja, Demiri, Neziri, Skuka, Stafa dhe Sula. Edhe Murrja është fis vëlla me fiset Dedja, Demiri, Neziri, Skuka, Stafa dhe Sula, por lindja e tij është shumë e veçantë dhe mund të jetë unike (Shikoni Fig. 1.4).




Figura 1.4 –Organigrama e gjenezës dhe vllazërisë së fisit Murrja (Burimi: Arif Murrja, Xheladin Murrja, Ilmi Murrja)




Figura 1.6–Organigrama e vllazërisë Skuka-Murrja (Burimi: Arif Murrja)




Figura 1.7 –Evidentimi i brezave të fisit Murrja (Burimi: Arif Murrja)

Deri në dekadën e fundit të shek. XX, kemi patur migrime sporadike të banorëve të këtyre fiseve në Peshkopi, Bulqizë dhe Tiranë. Pas viteve '90 të shekullit të kaluar shumë banorë të fiseve Dedja, Demiri Murrja, Neziri, Skuka, Stafa dhe Sula kanë migruar dhe janë vendosur në Tiranë dhe Durrës. Në tre dekadat e fundit banorë të këtyre fiseve kanë emigruar dhe janë vendosur në Greqi dhe Itali.

Pyetja 3: Cila është gjeneza e fisit Murrja?

Një ndër gjashtë djemtë e Lik Kastratit (Shikoni Fig. 1.4) është Skuk Lika. Ai ka qenë i martuar me dy gra. Bashkëshortja e dytë e tij, ka qenë një cucë (vajzë) nga Qaf-Murra, e cila është marrë nën gjakë (në hasmëri). Në traditën e kohës, cuca (vajza) kur martohej dhe manifestonte personalitet, zgjuarsi, sjellje sociale etj.; thirrej me emrin e fshatit apo të trevës nga vinte. Për shembull: nëse vinte nga Selishta (fshat në Katër Grykët e Dibrës) thirrej Selishte; nëse vinte nga Lura thirrej Lurake; nëse vinte nga Reçi thirrej Reçjane; nëse vinte nga Çidhna thirrej Çillnake; nëse vinte nga Dardha thirrej Dardhnjane etj.

Zgjuarsia dhe fuqia e gruas së Kuk Likës nga Qaf-Murra bëri që ajo të thirrej me emrin Murrja. Ajo lindi dy voca (djem): Halilin dhe Osmanin. Për shkak të famës së saj, Halili dhe Osmani trashëguan mbiemrin Murrja, ndërsa Mani, Ademi, Rizani dhe Baftjari nga martesa e me gruan e parë trashëguan mbiemrin Skuka (Shikoni Fig. 1.6). Osmani me disa nga vllezërit Skuka qëndroi në fshatin Lishan i Epërm, ndërsa Halili me disa nga vllezërit Skuka u zhvendos në fshatin Hotesh.

Pyetja 4: Sa i moçëm është fisi Murrja në Luzni?

Meqë fisi Murrja është shumë i madh, identifikimi "i barqeve", "i zjarreve" apo "i shtëpive" është bërë sipas emrave të personave që kanë patur sjellje më të mira dhe më pozitive në komunitet. Kështu pasardhësit e sotëm identifikohen si pinjollë të "shtëpisë, barkut apo zjarrit" të Elezit, të Hasanit, të Ahmetit dhe të Tafës. Për të gjetur numrin e brezave do të paraqesim shkurtimisht një pjesë të pemës gjenetike të fisit Murrja, por duke u fokusuar tek "barku" i Tafës.

Në pemën gjenetike të mësipërme numërohen 10 breza biologjikë (Shikoni Fig. 1.7). Pra, kemi brezin biologjik g = 30 dhe numërin e brezave n = 10. Atëherë duke zëvëndësuar të dhënat në formulën 1.3, kemi:

Fisi Murrja së bashku me fiset Dedja, Demiri, Neziri, Skuka, Stafa dhe Sula janë prej 300 vitesh në Luzni. Origjina e tyre e përbashkët është fisi Kastrati në Malësinë e Shkodrës. Viti ku jemi 2019 minus 300 vjetë është e barabartë me 1721, që do të thotë, se i pari këtyre fiseve ka ardhur në fshatin Lishan i Epërm rreth viteve 1720-1750.

V –PËRFUNDIME

Origjina e fisit Murrja dhe e fiseve vëllezër Dedja, Demiri, Neziri, Skuka, Stafa, Sula është nga fisi i dëgjuar Kastrati i Malsisë së Madhe në Shkodër. I pari, i tyre është Lik Kastrati. Ai ka ardhur në fshatin Lishan i Epërm të Luznisë në Dibër rreth viteve 1720-1750 ose rreth 300 vite më parë. Ai pati gjashtë djemë Dedën, Demirin, Nezirin, Skukën, Stafën, Sulën, ku pasardhësit e tyre trashëguan atësinë për mbiemër. Kështu lindën fiset Dedja, Demiri, Neziri, Skuka, Stafa dhe Sula. Edhe fisi Murrja është i një gjaku, por lindja e tij është krejt e veçantë apo unike.

Një nga gjashtë djemtë e Lik Kastratit, Skuk Lika u martua me dy gra. Me gruan e parë lindi Manin, Ademin, Rizanin dhe Baftjarin, të cilët trashëguan emrin e babait si mbiemër. Gruaja e dytë ishte një cucë nga Qaf-Murra. Sipas legjendës vendase ajo ishte "ulkonjë" dhe thirrej Murrja. Ajo lindi dy djem Halilin dhe Osmanin, të cilët për shkak të famës së të ëmës trashëguan emrin e saj për mbiemër. Këtu fillon gjeneza e fisit Murrja. Halili u zhvendos në fshatin Hotesh, i cili pati pesë djemë (Elezin, Hasanin, Hysenin Tafën dhe Limanin), të cilët u shtuan shumë dhe më vonë pasardhësit u zgjeruan edhe në fshatin Selane. Linja e Halilit në Hotesh dhe Selane numëron mbi 100 shtëpi. Osmani pati tre djemë (Tahirin, Sinanin dhe Rrahmanin), të cilët qëndruan në fashtin e lindjes Lishan i Epërm. "Barku" i Osmanit nuk është shtuar shumë dhe mot e sot numërohen rreth 15 shtëpi.

Rete PAS - një mundësi për të hyre në sherbimet shëndetësore, në një nga qendrat mjekësore më të mira në Firenze, Itali.

Rete PAS

QENDRA TE SPECIALIZUARA MJEKSORE
Pubbliche Assistenze Sanità

Një program i rezervuar dhe i personalizuar **për të gjithë qytetarët shqiptarë**

Një mundësi për të hyrë në shërbimet shëndetësore, në një nga qendrat mjekësore më të mira në Firenze, Itali.

Rete Pas (Humanitas) një qendër e specializuar mjekësore në Firenze.

Një rrjet ambulatorial i përbërë nga **11 qendra n**ë territorin e Firences, ku mesatarisht numërohen deri **20.000 pacientë** në muaj.

SHËRBIM I SHPEJTË PA KOHË PRITJE.

Rete Pas ofron shërbime shëndetësore në të gjitha disiplinat e specializuara diagnostikuese dhe rehabilituese, me tarifa të përballueshme për të gjithë, me një ekip mjekësh italianë me aftësi të larta.



NDËR SPECIALITETET QË OFROHEN JANË:

Në fushën e diagnostikimit:
- radiologji,
- rezonancë magnetike, tac -



- mamografi dhe tomosintezë,
- ekografi

Me përdorimin e pajisjeve të avancuar për rindërtimin e imazheve volumetrike 3D.

NDËR SPECIALITETET E TJERA:

- kardiologji -kirurgji
- angiologji -alergologji
- hematologji -dermatologji
- nefrologji -pneumologji
- gjinekologji -urologji
- okulistike -otorinolaringologji
- stomatologji -neurologji
- psikiatri

Gjatë kësaj kohe të gjithë pacientët që kanë nevojë për një shërbim të shpejtë mjekësor, ne ju mundësojmë ardhjen pranë spitaleve tona në Firenze.

Duke organizuar akomodimin gjatë qëndrimit tuaj në Itali, asistencë gjatë kontrollove mjekësore si dhe mundësinë e përkthimit në komunikimin me mjekët në gjuhën shqipe.

Qendra shëndetësore PAS garanton një seri avantazhesh për pacientët që zgjedhin shërbimet tona:

1. Një kujdes më i mirë sanitar me çmime të përballueshme për pacientin.

2. Rrjeti ambulatorial është i shpërndarë në11 qendra të specializuara për të ofruar një shërbim më të shpejtë.

3. Mbi 200 profesionistë të kujdesit shëndetësor si mjekët specialistë, infermierët, fizioterapistët etj., me aftësi të larta profesionale, janë në shërbimin tuaj në çdo kohë.

4. Vizita dhe kontrolle në të gjitha disiplinat e specializuara diagnostikuese dhe rehabilituese.

5. Pajisjet dhe aparaturat e teknologjisë së fundit për rezultate të sakta dhe pa kohë pritje.

6. Konsulencë mjekësore e specializuar dhe rehabilitacion në qendrat më cilësore të Firenzes.

QENDRA TE SPECIALIZUARA MJEKSORE FIRENZE -ITALIA-



Për informacione më të detajuara dhe prenotime mund të na kontaktoni:

+393280019580 — **Rete PAS Albania**

069 53 000 53 — **age.biba@gmail.com**

cyan magenta yelloë black